



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M  
K.P.P. 131/2021

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

|               |         |
|---------------|---------|
| Jonaïd Myzyri | Kryetar |
| Vilma Zhupaj  | Anëtar  |
| Lindita Skeja | Anëtar  |
| Merita Zeqaj  | Anëtar  |

Në mbledhjen e datës 19.03.2021 shqyrtoi ankesën me:

**Objekt:** Modifikimi i dokumenteve të procedurës së prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me nr. REF-85003-01-27-2021, me objekt, “*F.V pajisje Mjekësore për Maternitetin e Beratit*” me fond limit 50,212,610 lekë (pa TVSh), parashikuar për t’u zhvilluar në datën 08.03.2021 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Spitalit Rajonal Berat.

**Ankimues:** “Biometric Albania” ShPK  
Adresa: Rr “Vllazen Huta”, Pallati Ri “Vila Park” Tiranë

**Autoriteti Kontraktor:** Drejtoria e Spitalit Rajonal Berat  
Lagjja Kushtrim Berat

**Baza Ligjore:** Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

## **Vëren:**

### **I**

#### *Vlerësimi paraprak*

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimes, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka prima facie interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimes.

### **II**

#### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 28.01.2021 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me nr. REF-85003-01-27-2021, me objekt, “*F.V pajisje Mjekësore për Maternitetin e Beratit*” me fond limit 50,212,610 lekë (pa TVSH), parashikuar për t’u zhvilluar në datën 08.03.2021 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Spitalit Rajonal Berat.

II.2. Në datën 03.02.2021 operatori ekonomik ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor në mënyrë të përmbledhur me argumentet si më poshtë:

- Në datën 28.01.2021 kompania jonë është njohur në sistemin elektronik të prokurimit me procedurën e shpallur nga autoriteti kontraktor Spitali Rajonal Berat, me objekt: “*F.V pajisje hotelerie dhe mjekësore për maternitetin e Beratit*” - REF-84998-01-27-2021 LOT. 1 “*FV pajisje Mjekësore për Maternitetin e Beratit*” - REF-85003-01-27-2021. Dhe pas shqyrtimit të DST, Bazuar ne LPP Neni 63 pika 1/1.1

#### ***Të drejtat e personit të interesuar***

1.Çdo person, që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin.

1.1 Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës. Ndaj vendimit përfundimtar të autoritetit kontraktor mund të bëhet ankim në Komisionin e Prokurimit Publik, në përputhje me pikën 6 e në vijim të këtij neni.

Si dhe ne Nenin 1, pika 2 (d) dhe Nenin 23, Pika 1,2,3,5

Paraqesim pretendimet dhe kërkesat tona në lidhje me disa specifikime teknike të artikujve si me poshte të cilat pengojne në menyre të hapur konkurrencen dhe krijojnë diskriminim dhe pabarazi në pjesëmarrje.

Keto specifikime janë hartuar në kundërshtim me Ligjin dhe Rregullat e Prokurimit Publik duke drejuar haptazi në prodhues të vecante dhe pajisje unike dhe rrjedhimisht duke percaktuar distributorin e vetëm të këtyre prodhuesve në Shqipëri, si dhe fituesin e kësaj procedure prokurimi në kundërshtim flagrante me ligjet në fuqi.

Ju vëmë në dukje se specifikimet e kërkuara janë përpiluar në një formë abuzuese dhe duke u prezantuar si fotokopje të katalogeve të modeleve të caktuara, ku paraqiten numrat konkretë të kufizuar pa dhënë mundësinë e alternativave.

Shpresojmë dhe urojmë që keto kërkesa të mos jenë hartuar në mënyrë tendencioze duke favorizuar një operator ekonomik të vetëm dhe duke mbyllur garën në kundërshtim të plotë me Ligjin dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

Më poshtë po ju paraqesim pikat dhe faktet në lidhje me pretendimin tonë:

1. Në shtojcën 10, Specifikime Teknike, Lot1- F.V pajisje Mjekësore për Maternitetin e Beratit në lidhje me artikullin Nr. 1 **Tavolinë Operatore-Obsertikale dhe gjinekologjike** kërkohen:

- Pajisja të jetë e mbështetur në 4 rrota dhe me mbështetje statike gjatë ndërhyrjeve
- Krevati të mbajë peshë të paktën 300 kg
- Lëvizjet anësore majtas-djathtas të paktën 35 gradë

Ju vëmë në dukje se prodhues të ndryshëm ofrojnë opsione të ndryshme të suportit mbështetës të

tavolinës operatore, siç është mbështetja statike ose suporti me rrota. Rrjedhimisht plotësimi i njëres prej kërkesave është i mjaftueshëm për sa i përket funksionalitetit të pajisjes dhe lëvizjes së saj. Nëse tavolina operatore është e pajisur me rrota me frena, atëherë stafi mjekësor mund ta lëvizë lehtësisht atë kur është e nevojshme si dhe ta vendosë në pozicion statik me anë të frenave gjatë ndërhyrjeve. Gjithashtu kapaciteti mbajtës 300kg është një tjetër kriter jo i nevojshëm dhe kufizues, pasi dihet që pesha e pacientit së bashku me aksesoret që mund të montohen në tavolinë, nuk mund të arrije në këto vlera. Për më tepër tavolina operatore e kërkuar është për qëllime obstetrike-gjinekologjike dhe jo ortopedike, rast në të cilin, sasia e moduleve shtesë dhe aksesoreve që mund të montohen në tavolinë është më e madhe.

Lëvizja anësore laterale të paktën 35 gradë është një tjetër kriter kufizues, pasi diferenca me +5 gradë nuk ka asnjë ndikim në procedurat obstetrike gjinekologjike dhe pozicionimi lateral në një kënd  $\pm 30$  gradë është mëse i mjaftueshëm edhe gjatë komplikacioneve që mund të shkaktohen nga presioni i lartë.

Për të mos kufizuar garën dhe për të krijuar mundësinë e ofertimit të produkteve ekuivalente pa cënuar funksionalitetin e pajisjes **kërkojmë që këto specifikime të ndryshohen si më poshtë:**

**Pajisja të jetë e mbështetur në rrota me frena ose me mbështetje statike gjatë ndërhyrjeve**

**Materiali i konstruktit të jetë inoks ose aliazh alumin**

**Krevati të mbajë peshë të paktën 270 kg**

**Lëvizjet anësore majtas-djathtas të paktën 25-35 gradë**

## **2. Në shtojcën 10, Specifikime Teknike Lot 1-F.V pajisje Mjekësore për Maternitetin e Beratit në lidhje me artikullin Nr.2 Makinë Anestezie (Set) kërkohen:**

-Sistem me 3 gaze mjekësore: O<sub>2</sub>, N<sub>2</sub>O dhe Ajër me auto kalibrim

-Aparati duhet të suportoje hyrjet Ajër/O<sub>2</sub> dhe N<sub>2</sub>O 250-650 kPa dhe të suportoje standardet AGA DISS NIST, etj.

-Ekran me prekje LED dhe knob

-PEEP: 0-50 cmH<sub>2</sub>O

-Presioni i Inspirimi 0-120 cm H<sub>2</sub>O

-Aparati duhet të përdorë sistem qarkullimi me reflektor volume

-Valvola të emergjencës APL frymëmarrje e rastësishme deri në 80 cmH<sub>2</sub>O dhe për oksigjenin O<sub>2</sub> të paktën 0-10 l/min

-Volumi i respirimit për minutë: i larti 0.5-60 l/min dhe i ulet 0.01- 40l/min afërsisht

-Alarm APNEA: 5-45s dhe kur është i fikur. Alarmi për APNEA kur nuk ka frymëmarrje për 120s

-Kontroll në kohë reale i qarkut të frymëmarrjes, prani të ventilatorit alternativ me reflektor volume

-Koha e mbushjes së vaporizatorit afërsisht 4 ml/s

Ju vëmë në dukje se këto specifikime janë hartuar në kundërshtim të hapur me LPP dhe VKM, pasi ato janë realizuar në bazë të modelit të aparatit të anestezisë Flow-I, të prodhuesit Maquet(Getinge Group) (katalogu bashkëlidhur), gjë e cila favorizon në mënyrë të hapur

distributorin e kësaj kompanie. Ndër të tjera, përveç specifikimeve numerike unike janë përdorur edhe terma dhe teknologji të patentuara të prodhuesit Getinge të cilat e bëjnë të pamundur ofrimin e produkteve nga prodhues të tjerë prestigjiozë. Për më tepër kërkesat e mësipërme nuk kanë asnjë vlerë klinike apo funksionale për pajisjen, si për shembull: autokalibrimi i gazeve mjekësore i cili nuk ka asnjë vlerë teknike apo klinike, por është thjeshtë karakteristikë kufizuese e prodhuesit të sipërpërmendur. Presioni i inspirimit 0-120 cmH<sub>2</sub>O, PEEP 0-50cmH<sub>2</sub>O si dhe valvola e emergjencës APL deri në 80cmH<sub>2</sub>O, gjithashtu janë kërkuar në një diapazon të cilat nuk ka asnjë rendesi klinike pasi gjatë ventilimit manual, apo ventilimit automatik presioni maksimal në rrugët e frymëmarrjes nuk kalon 40-50 cmH<sub>2</sub>O. Gjithashtu çelësi Knob është një ndërfaqe e cila përdoret më së shumti në rastet kur pajisja nuk disponon një ndërfaqe tjetër ekuivalente për operatorin. Pajisjet e teknologjisë së fundit (vit prodhimi 2019-2021) kanë tashmë si ndërfaqe kryesore vetë ekranin e tyre i cili është me funksion "touch screen" (me prekje). Në këtë ekran paraqiten të gjithë parametrat monitorues apo kontrollues/komandues nëpërmjet të cilëve operatori navigon në menunë e pajisjes duke kontrolluar apo konfiguruar çdo parametër apo funksion të saj. Në bazë të Nenit 23, pika 3 (b) ku specifikimet teknike duhet t'u referohen kërkesave në terma funksionalë, kur një gjë e tillë kërkon t'u referohesh standardeve kombëtare ose ndërkombëtare, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale, del qartë se nëse pajisja kontrollohet totalisht nëpërmjet ekranit me prekje, i cili kërkohet në këtë procedurë, ajo nuk ka nevojë për një çelës knob. Alarmi Apnea kur nuk ka frymëmarrje për 120 s, është një tjetër kufizim lidhur me këtë prodhues si dhe mbushja e vaporizatorit 4ml/s është gjithashtu karakteristikë e vaporizatorëve elektronike që ka aparati Flow-i i prodhuesit Getinge.

Gjithashtu teknologjia me refraktor volumi është një patentë e kompanisë Getinge ku në vetë katalogun e saj citohet: "Our patented Volume Reflector is a smart rebreathing system".

Duke qenë në kundërshtim të hapur me Nenin 23, pika 5 e Ligjit të Prokurimit Publik **kërkojmë që disa specifikime të HIQEN dhe të tjerat të ndryshohen si më poshtë, në diapazone dhe në vlera logjike për sa i përket performancës dhe qëllimit funksional të pajisjes:**

Sistem me 3 gaze mjekësore: O<sub>2</sub>, N<sub>2</sub>O dhe Ajër

Aparati duhet të suportojë hyrjet Ajër/O<sub>2</sub> dhe N<sub>2</sub>O 280–600 kPa dhe të suportojë standardet AGA DISS NIST, etj.

Ekran me prekje LED ose me knob

PEEP: 0-30 cmH<sub>2</sub>O

Presioni i Inspirimit: 0–60 cmH<sub>2</sub>O

Valvola t emergjencs APL frymëmarrje e rastësishme deri në 60 cmH<sub>2</sub>O dhe për oksigjenin O<sub>2</sub> të paktën 0-10 l/min

Volumi i respirimit për minute: i larti 0.5-30 l/min dhe i ulët 0.1-40 l/min afërsisht

Alarm APNEA: 5 - 30s dhe kur është i fikur.

### **3. Në shtojcën 10, Specifikime Teknike Lot 1 - F.V pajisje Mjekësore për Maternitetin e Beratit në lidhje me artikullin Nr. 3 Llambë Operatore, kërkohen:**

-Ndricimi për secilën kokë: të paktën 130,000 lux dhe të arrijë te paktën 160,000 lux

- Të jetë e pajisur me sensor proksimal për kontrollin automatik të dritës në ndryshim të thellësisë
- Diametri maksimal i fushës jo më pak se 30 cm
- Ngjyra temperaturës të paktën 3600 - 4800 K e rregullueshme me hapa

Këto specifikime janë hartuar duke u nisur nga modele të veçanta të llambave operatore. Për më tepër kërkesat e mësipërme nuk kanë asnjë vlerë klinike apo funksionale për pajisjen, ndaj për të mos kufizuar garën dhe për të krijuar mundësinë e ofertimit të produkteve ekuivalente ose më të avancuara kërkojmë që **këto specifikime të ndryshohen si më poshtë, në diapazone dhe në vlera logjike për sa i përket performancës dhe qëllimit funksional të pajisjes:**

**Ndriçimi për secilën kokë: të paktën 140,000-160,000 lux**

**Të mundësojë kontrollin automatik të dritës në ndryshim të thellësisë**

**Diametri maksimal i fushës jo më pak se 26 cm**

**Ngjyra temperaturës të paktën 4500-5000 K**

4. Në shtojcën 10, Specifikime Teknike Lot 1 - F.V pajisje Mjekësore për Maternitetin e Beratit në lidhje me artikullin **Nr. 4 Llambë Mobile**, kërkojmë:

- Lartësi e rregullueshme afërsisht 70 - 160cm
- Diametri i fushës së dritës së përqendruar të paktën 30 cm
- Temperatura e ngjyrës të kontrolluara elektronikisht të paktën nga 3700K deri 4700K
- Diametri i satelitit jo më pak se 35 cm

Në mënyrë që të krijohet mundësia e ofrimit të produkteve alternative të njëvlershme ose më të avancuara kërkojmë që këto specifikime të paraqiten me diapazon më të gjerë dhe të ndryshohen në:

Lartësi e rregullueshme afërsisht 127 - 160cm

Diametri i fushës së dritës së përqendruar të paktën 15-20 cm

Temperatura e ngjyrës të kontrolluara elektronikisht të paktën nga 4000K deri 4500K

Diametri i satelitit jo më pak se 19-25 cm

5. Në shtojcën 10, Specifikime Teknike Lot 1 - F.V pajisje Mjekësore për Maternitetin e Beratit në lidhje me artikullin **Nr. 5 Llambë Ekzaminimi**, kërkojmë:

- Lartësi e rregullueshme afërsisht 70-160cm
- Temperatura e ngjyrës të kontrolluara elektronikisht të paktën nga 3700K deri 4700K
- Intensiteti të paktën 50,000 lux

Në mënyrë që të krijohet mundësia e ofrimit të produkteve alternative të njëvlershme ose më të avancuara kërkojmë që këto specifikime të paraqiten me diapazon më të gjerë dhe të ndryshohen në:

**Lartësi e rregullueshme afërsisht 127 - 160cm**

**Temperatura e ngjyrës të kontrolluara elektronikisht të paktën nga 4000K deri 4500K**

**Intensiteti të paktën 35,000-50,000 lux**

**6. Në shtojcën 10, Specifikime Teknike Lot 1 - F.V pajisje Mjekësore për Maternitetin e Beratit në lidhje me artikullin Nr. 10 AED external me monitor, kërkohen:**

- Tipi i ekranit ST-NLT ngjyrim TFT
- Nr. i gjurmimit 6 formë valësh
- ECG Lidhje Kabull me 3, 6 dhe 10 elektroda
- Numri i kanaleve të EKG: 2 (maksimum, me 6 ose 10 elektroda të shfaqura në ekran), 12 (maksimum, me 10 elektroda ose dritare me 12 drejtime)
- Shkalla e paraqitjes së ritmit të zemrës: 15 në 220 bpm
- Duhet të ketë alarme si dhe sinjale vizuale: Gjendje kritike me sinjal të kuq, gjendje që duhet pasur kujdes me sinjalizim të verdhë, nevojë konsultimi me ngjyrë të kaltër.

Së pari, ju vëmë në dukje se specifikimet për këtë artikull janë hartuar duke u marrë copy-paste nga modeli i defibrilatorit Cardioline TEC-8300 i prodhuesit Nihon Kohden (katalogu bashkëlidhur), duke kufizuar konkurrencën e hapur dhe duke bërë të pamundur ofertimin e produkteve alternative, në kundërshtim të plotë me LPP dhe VKM. Për më tepër hartimi i specifikimeve nuk është ndërtuar në baze të parametrave që kanë vlerë klinike për jetën e pacientit, por në kërkesa të cilat nuk kanë lidhje me funksionalitetin dhe performancën e pajisjes. Në mënyrë që të mos favorizohet vetëm një operator i caktuar, për të mundësuar një garë të hapur e korrekte dhe në mënyrë që të krijohet mundësia e ofrimit të produkteve alternative të njëvlershme ose më të avancuara kërkojmë që këto specifikime të paraqiten me diapazon më të gjerë dhe të ndryshohen në:

Tipi i ekranit me ngjyra TFT

**Nr. i gjurmimit 4 formë valësh**

**ECG Lidhje Kabull me 3, 6 dhe 10 elektroda ose 3/5/12 elektroda**

**Numri i kanaleve të EKG: 2 (maksimum, me 5-6 ose 10-12 elektroda të shfaqura në ekran), 12 (maksimum, me 10-12 elektroda të shfaqura në ekran)**

**Shkalla e paraqitjes së ritmit të zemrës në modalitet pacing: 30 në 200 bpm**

**Duhet të ketë alarme si dhe sinjale vizuale: Gjendje kritike me sinjal të kuq, gjendje që duhet pasur kujdes me sinjalizim të verdhë.**

**7. Në shtojcën 10, Specifikime Teknike Lot 1 - F.V pajisje Mjekësore për Maternitetin e Beratit në lidhje me artikullin Nr. 16 Shiringë Infuzioni elektrike, kërkohen:**

-Saktësia +1% me një minimum shiringash 100

Të operojë në presion 250-900 mmHg në hapa 50 mm Hg ose në hapa 25 mmHg për presion 50-250 mmHg

Së pari, ju vëmë në dukje se specifikimet për këtë artikull janë hartuar duke u marrë copy-paste nga modeli Agilia SP i prodhuesit Fresenius KABI (katalogu bashkëlidhur), duke kufizuar konkurrencën e hapur dhe duke bërë të pamundur ofertimin e produkteve alternative, në kundërshtim të plotë me LPP dhe VKM.

Për më tepër hartimi i specifikimeve nuk është ndërtuar në bazë të parametrave që kanë vërtet rëndësi klinike për jetën e pacientit, por në kërkesa të cilat nuk kanë lidhje me funksionalitetin dhe performancën e pajisjes.

Në mënyrë që të mos favorizohet vetëm një operator i caktuar, për të mundësuar një garë të hapur e korrekte dhe në mënyrë që të krijohet mundësia e ofrimit të produkteve alternative të njëvlershme ose më të avancuara kërkojmë që këto specifikime të paraqiten me diapazon më të gjerë dhe të ndryshohen në:

**Saktësia +2% me një minimum shiringash 50**

**Të operojë në presion 80-900 mmHg në 10-11 nivele**

**8. Në shtojcën 10, Specifikime Teknike Lot 1 - F.V pajisje Mjekësore për Maternitetin e Beratit në lidhje me artikullin Nr. 18 Pompë infuzioni, kërkojnë:**

-Koha e infuzionit: 1 s - 165 orë e 59 minuta

-KVO e rregullueshme 1 - 20.0 ml/orë

Ju vëmë përsëri në dukje se specifikimet për këtë artikull janë hartuar duke u marrë copy-paste nga modeli Agilia VP MC, gjithashtu i prodhuesit Fresenius KABI (katalogu bashkëlidhur), duke kufizuar konkurrencën e hapur dhe duke bërë të pamundur ofertimin e produkteve alternative, në kundërshtim të plotë me LPP dhe VKM. Për më tepër hartimi i specifikimeve nuk është ndërtuar në bazë të parametrave që kanë vërtetë rëndësi klinike për jetën e pacientit, por në kërkesa të cilat nuk kanë lidhje me funksionalitetin dhe performancën e pajisjes siç është koha e infuzionit deri në 166 orë apo KVO deri 20ml/orë, parametra të cilët i plotëson vetëm modeli i sipërpërmendur i prodhuesit Fresenius Kabi.

Në mënyrë që të mos favorizohet vetëm një operator i caktuar, për të mundësuar një garë të hapur e korrekte dhe në mënyrë që të krijohet mundësia e ofrimit të produkteve alternative të njëvlershme ose më të avancuara kërkojmë që këto specifikime të paraqiten me diapazon më të gjerë dhe të ndryshohen në:

**Koha e infuzionit: 1 s-99 orë e 59 minuta**

**KVO e rregullueshme 1 - 5.0 ml/orë**

Në specifikimet e këtij artikulli janë shtuar gjithashtu kërkesat e dy artikujve të tjerë të cilët nuk kanë lidhje me këtë produkt. Meqenëse ky duhet të jetë një lapsus, lutemi të bëhen ndryshimet përkatëse në formulim.

**9. Në shtojcën 10, Specifikime Teknike Lot 1 - F.V pajisje Mjekësore për Maternitetin e Beratit në lidhje me artikullin Nr. 20 Pajisje për monitorimin e parametrave vital**

**neonat, kërkojnë:**

-Ekran i sheshtë TFT/LCD/LED me prekje min 12 inch me mundësi afishimi të paktën 15 të formave të valës.

-Monitori duhet të ketë mundësi të bllokimit të komandimit me prekje dhe të ofrojë mundësi kontrolli ndërmjet butonave fizik

-ECG (3/6/10 lidhje)

-Të përshtatet me standardet ISO 9919: 2005, ISO 80601-2-61:2011



-Interval i ulët 0 deri 148

-Alarmi Apnea : Fikur, 5 deri 40 s në 5 hapa

- Tipi i matjes: sistolik, Interval dhe mesatar: Sistolik: 40 deri 280 mmHg; Diastolik: 10 to 235 mmHg; (MAP): 10 deri 280 mmHg;

-Neonate: Sistolik: 30 deri 140 mmHg; Diastolic: 10 deri 110 mmHg; (MAP): 10 deri 140 mmHg

-Pediatrik: Systolic 40 deri 280 mmHg, Diastolic: 10 deri 235 mmHg, MAP: 10 deri 280 mmHg

Së pari, ju vëmë në dukje se specifikimet për këtë artikull janë hartuar sipas modelit Life ScopeVS Series 3763, i prodhuesit Nihon Kohden, duke kufizuar konkurrencën e hapur dhe duke bërë të pamundur ofertimin e produkteve alternative, në kundërshtim të plotë me LPP dhe VKM.

Për më tepër hartimi i specifikimeve nuk është ndërtuar në bazë të parametrave që kanë vërtetë rëndësi klinike për jetën e pacientit, por në kërkesa dhe numra fikse të cilët i takojnë modelit të sipërpërmendur .

Këto specifikime nuk janë mbështetur në asnjë përvojë të mëparshme, siç janë procedura prokurimi të ngjashme të organizuara nga Ministria e Shëndetësisë apo Banka Botërore, por janë përcaktuar të tilla duke kërkuar pajisje që për më tepër nuk janë instaluar në asnjë nga klinikat universitare apo në departamentet e kardiokirurgjisë/hemodinamikeës, Në një kohë që kërkohet standardizimi dhe njehsimi i pajisjeve të instaluara në spitalet rajonale, mënyra e hartimit të këtyre specifikimeve, duke mos u mbështetur në asnjë përvojë të mëparshme, bie ndesh me këto standarde. Ju vëmë në dukje pikat si më poshtë:

Për një monitor të kërkuar me madhësi ekrani 12 inc, nuk është i nevojshëm pasqyrimi i formave valore deri ne 15. Kjo është një vlerë kufizuese dhe i përket vetëm modelit të sipërpërmendur.

Për më tepër për monitorimin e parametrave vitale pediatrike apo neonat, 8 forma valore janë mëse të mjaftueshme për një ekran të madhësisë 12 inc.

ISO 9919: 2005 dhe ISO 80601-2-61:2011 janë standarde të njëvlershme, ndaj mjafton te kërkohet njëri prej tyre.

Intervali i ulët i respirimit është kërkuar në një diapazon të krahasueshëm me nivelin e lartë, ndaj mendojmë se është lapsus.

Gjithashtu "kontrolli me butona fizike" është një ndërfaqe e cila përdoret më së shumti në rastet kur pajisja nuk disponon një ndërfaqe tjetër ekuivalente për operatorin.

Pajisjet e teknologjisë së fundit (vit prodhimi 2019-2021) kanë tashme si ndërfaqe kryesore vetë ekranin e tyre i cili është me funksion "touch screen" (me prekje). Në këtë ekran paraqiten të gjithë parametrat monitorues apo kontrollues/komandues nëpërmjet të cilëve operatori navigon në menu-në e pajisjes duke kontrolluar apo konfiguruar çdo parametër apo funksion të saj.

Në bazë të Nenit 23, pika 3 b) ku specifikimet teknike duhet t'iu referohen kërkesave në terma funksionale, kur një gjë e tillë kërkon t'u referohesh standardeve kombëtare ose ndërkombëtare, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale, del qartë se nëse pajisja kontrollohet totalisht nëpërmjet ekranit me prekje, i cili kërkohet në këtë procedurë, nuk ka nevojë për butona fizike.

Në mënyrë që me përpilimin e specifikimeve të mësipërme të mos favorizohet vetëm një operator i caktuar, për të mundësuar një garë të hapur e korrekte dhe në mënyrë që të krijohet mundësia e ofrimit të produkteve alternative të njëvlershme ose me të avancuara kërkojmë që **këto specifikime**

**të ndryshohen si më poshtë, në diapazone dhe në vlera-logjike për sa i përket performancës dhe qëllimit funksional të pajisjes:**

**Ekran i sheshtë TFT/LCD/LED me prekje min 12 inch me mundësi afishimi të paktën 8 të formave të valës**

**Monitori duhet të ketë mundësinë e bllokimit të komandimit me prekje ose të ofrojë mundësi kontrolli ndërmjet butonave fizik**

**ECG (3/6/10 lidhje) ose (3/5/12 lidhje)**

**Të përshtatet me standardet ISO 9919: 2005 ose ISO 80601-2-61:2011**

**Interval i ulët 0 deri 20**

**Alarmi Apnea : Fikur, 10 deri 40 s në 5 hapa**

**Tipi i matjes: sistolik, Interval dhe mesatar: Sistolik: 40 deri 280 mmHg; Diastolik: 10 to 235 mmHg; (MAP): 15 deri 260 mmHg;**

**Neonate: Sistolik: 30 deri 140 mmHg; Diastolic: 10 deri 110 mmHg; (MAP): 15 deri 125 mmHg**

**Pediatrik: Systolic 40 deri 240 mmHg, Diastolic: 10 deri 200 mmHg, MAP: 15 deri 215 mmHg**

**10. Në shtojcën 10, Specifikime Teknike Lot 1 - F.V pajisje Mjekësore për Maternitetin e Beratit në lidhje me artikullin Nr. 21 Radiante, kërkohet:**

**-Në modalitet Manual Intensiteti i energjisë ngrohëse duhet të rregullohet manualisht nga operatori në të paktën 50 nivele energjie nga 0-100%.**

**Në mënyre që të krijohet mundësia e ofrimit të produkteve alternative të njëvlershme ose me të avancuara kërkojmë që ky specifikim të ndryshohet ne:**

**Në modalitet Manual Intensiteti i energjisë ngrohëse duhet të rregullohet manualisht nga operatori në të paktën 20 nivele energjie nga 0-100%.**

**11. Në shtojcën 10, Specifikime Teknike Lot 1 - F.V pajisje Mjekësore për Maternitetin e Beratit në lidhje me artikullin Nr. 22 Aparat fototerapie (llambë fototerapie), kërkohen:**

**-Të ketë të paktën 20 LED dhe fuqia jo më shumë se 20w**

**-Sistemi LED të ofrojë jetëgjatësi të paktën 35,000 orë pune**

**-Rrezatimi i sistemit LED të ketë gjatësi vale 450 nm (w/cm /nm) në fushë 54 - 56cm**

**-Fusha e rrezatimit në 440 - 460 nm (uw/cm /nm) të mbulojë lartësinë 43 - 45 cm**

**Së pari, ju vëmë në dukje se specifikimet për këtë artikull janë hartuar në baze të modelit BiliblueLight, i prodhuesit Lowenstein Medical (katalogu bashkëlidhur), duke favorizuar po te njëjtin distributor dhe duke kufizuar konkurrencën e hapur dhe bërë të pamundur ofertimin e produkteve alternative, në kundërshtim të plotë me LPP dhe VKM.**

Gjithashtu përpilimi i tyre është bërë në formë lapsusi, pasi njësia e matjes së rrezatimit nuk shprehet në centimetra, ashtu sikurse është vendosur në vlerat e mësipërme. Në mënyrë që të mos favorizohet vetëm një operator i caktuar, për të mundësuar një garë të hapur e korrekte dhe në mënyrë që të krijohet mundësia e ofrimit të produkteve alternative të njëvlershme ose më të avancuara **kërkojmë që këto specifikime të korrigjohen dhe ndryshohen si më poshtë, në diapazone dhe në vlera logjike për sa i përket performancës dhe qëllimit funksional të pajisjes:**

**Të ketë të paktën 20 LED dhe fuqi 20-50 W**

**Sistemi LED të ofrojë jetëgjatësi të paktën 20,000 orë pune**

**Fusha e rrezatimit në 450 - 470 nm [40 - 100 W/cm /nm]**

12. Në shtojcën 10, Specifikime Teknike Lot 1 - F.V pajisje Mjekësore për Maternitetin e Beratit në lidhje me artikullin **Nr. 27 Inkubator Bebe**, kërkohet:

-Kontroll i lagështisë: 40-95% në 1% Inkrementim

Në mënyrë që të krijohet mundësia e ofrimit të produkteve alternative të njëvlershme ose më të avancuara **kërkojmë që ky specifikim të ndryshohet në:**

**Kontroll i lagështisë: 40-90% në 1% Inkrementim**

13. Në shtojcën 10, Specifikime Teknike Lot 1 - F.V pajisje Mjekësore për Maternitetin e Beratit në lidhje me artikullin **Nr. 28 Blanket fototerapie**, kërkohet:

-Diapazoni i rrezatimit optik brenda diapazonit: 430-490nm.

Siç dihet rrezatimi optik ku arrihet absorbimi maksimal i bilirubinës gjate trajtimit të foshnjave të porsalindura në këtë lloj pajisje është 458nm. Pra është mëse e mjaftueshme që diapazoni i ofruar të përfshijë këtë vlerë.

Në mënyrë që të krijohet mundësia e ofrimit të produkteve alternative të njëvlershme ose më të avancuara **kërkojmë që ky specifikim të ndryshohet në:**

**Diapazoni i rrezatimit optik brenda diapazonit: 450-470nm**

Gjithashtu theksojmë se në KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT(për lotin 1), 2.3 Kapaciteti teknik, pika 5.Operatori ekonomik duhet të paraqesë Certifikata konformiteti CE ose FDA sipas direktivës (MDD ose MDR) 93/42 EEC, të vlefshme, ose ekuivalent, për artikujt e ofruar, sipas kategorizimit të tyre.

Kërkohen certifikata konformiteti sipas direktivës së pajisjeve mjekësore për të gjithë artikujt e Lotit 1, ndërkohë që disa prej tyre si për shembull, Stol me 1 shkallë, stol kirurgjikal, nuk kategorizohen si pajisje mjekësore, dhe rrjedhimisht nuk janë të pajisura me deklaratë konformiteti CE.

**Kërkojmë që ky kriter të modifikohet në:**

**Operatori ekonomik duhet të paraqesë Certifikata konformiteti CE ose FDA sipas direktivës (MDD ose MDR) 93/42 EEC, të vlefshme, ose ekuivalent, për artikujt e ofruar aty ku është e aplikueshme, sipas kategorizimit të tyre.**

*Si përfundim, kërkojmë të modifikohen specifikimet teknike në përputhje me sugjerimet e përcaktuara më sipër në respektim, në frymë dhe përmbajtje të LPP dhe VKM.*

II.3. Me shkresën nr. 549/1 prot datë 09.02.2021 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorin ekonomik ankimues lidhur me pranimin e pjesshëm të ankesës në mënyrë të përmbledhur duke argumentuar se:

“Referuar pretendimeve me shkrim të ankimuesit në mënyrë të përmbledhur u pretendua:

**Pretendimi i parë** “Në shtojcën 10, Specifikime Teknike, Lot1- F.V pajisje Mjekësore për Maternitetin e Beratit në lidhje me artikullin Nr. 1 Tavolinë Operatore-Obstetrike dhe gjinekologjike kërkohej:

- Pajisja të jetë e mbështetur në 4 rrota dhe me mbështetje statike gjatë ndërhyrjeve
- Krevati të mbajë peshë të paktën 300 kg
- Lëvizjet anësore majtas-djathtas të paktën 35 gradë

*Ju vëmë në dukje se prodhues të ndryshëm ofrojnë opsione të ndryshme të suportit mbështetës të tavolinës operatore, siç është mbështetja statike ose suporti me rrota. Rrjedhimisht plotësimi i njëres prej kërkesave është i mjaftueshëm për sa i përket funksionalitetit të pajisjes dhe lëvizjes së saj. Nëse tavolina operatore është e pajisur me rrota me frena, atëherë stafi mjekësor mund ta lëvizë lehtësisht atë kur është e nevojshme si dhe ta vendosë në pozicion statik me anë të frenave gjatë ndërhyrjeve. Gjithashtu kapaciteti mbajtës 300kg është një tjetër kriter jo i nevojshëm dhe kufizues, pasi dihet që pesha e pacientit së bashku me aksesoret që mund të montohen në tavolinë, nuk mund të arrihet në këto vlera. Për më tepër tavolina operatore e kërkuar është për qëllime obstetrike-gjinekologjike dhe jo ortopedike, rast në të cilin, sasia e moduleve shtesë dhe aksesoreve që mund të montohen në tavolinë është më e madhe.*

*Lëvizja anësore laterale të paktën 35 gradë është një tjetër kriter kufizues, pasi diferenca me +5 gradë nuk ka asnjë ndikim në procedurat obstetrike gjinekologjike dhe pozicionimi lateral në një kënd  $\pm 30$  gradë është mëse i mjaftueshëm edhe gjatë komplikacioneve që mund të shkaktohen nga presioni i lartë.*

*Për të mos kufizuar garën dhe për të krijuar mundësinë e ofertimit të produkteve ekuivalente pa cënuar funksionalitetin e pajisjes kërkojmë që këto specifikime të ndryshohen si më poshtë:*

**Pajisja të jetë e mbështetur në rrota me frena ose me mbështetje statike gjatë ndërhyrjeve**

**Materiali i konstruktit të jetë inoks ose aliazh alumin**

**Krevati të mbajë peshë të paktën 270 kg**

**Lëvizjet anësore majtas-djathtas të paktën 25-35 gradë**

*Lidhur me këtë pretendim të shoqërisë “Biometric” theksojmë se:*

- Ne lidhje me piken "Pajisja të jete e mbeshtetur ne 4 rrota dhe me mbeshtetje statike gjate nderhyrjeve". ky eshte nje kriter i domosdoshem i kerkuar nga mjeket per tavolinen operatore, e cila duhet t'i ofroje stafit mjekësor lehtësinë për ta levizur kur është e nevojshme dhe ta vendose

ate ne pozicion statik gjate nderhyrjeve. Ky kriter ofrohet nga te gjithë prodhuesit dhe nuk eshte aspak kriter perjashtues. Per kete arsye pretendimi juaj nuk qendron.

- Në lidhje me pikën “Materiali i konstruktit të jetë inoks dhe aliazh alumini” pretendimi juaj qëndron dhe AK do ta marrë parasysh për modifikimin e specifikimit duke e bërë “materiali i konstruktit të jetë inoks ose aliazh alumini”

- Në lidhje me pikën "Krevati të mbajë peshë të paktën 300 kg". Tavolina operatore përveç konfigurimit standard merr dhe konfigurime të tjera në varësi të nevojave të veçanta të pacientit. Kapaciteti mbajtës i tavolinës nuk i referohet vetëm peshës së pacientit por edhe aksesoreve shtesë të tavolinës si suporte te ndryshme, pllaka e zgjatjes etj. prandaj ky kapacitet eshte i nevojshëm. Prodhues të ndryshëm e ofrojnë këtë specifikim dhe nuk eshte një kriter i panevojshëm. Për këtë arsye pretendimi juaj nuk qëndron.

- Në lidhje me pikën “Lëvizjet anësore majtas-djathtas të paktën 35 gradë”: Në lidhje me këtë specifikim lëvizjet anësore janë shumë të rëndësishme në procedurat obstetrike-gjinekologjike. Lëvizjet anësore në të paktën 35 gradë i lehtësojnë pacientet komplikacionet që mund të vijnë Bëhet 32 gradë.

**Pretendimi i dytë:** “Në shtojcën 10, Specifikime Teknike Lot 1-F.V pajisje Mjekësore për Maternitetin e Beratit në lidhje me artikullin Nr.2 Makinë Anestezie (Set) kërkohen:

-Sistem me 3 gaze mjekësore: O<sub>2</sub>, N<sub>2</sub>O dhe Ajër me auto kalibrim

-Aparati duhet të suportoje hyrjet Ajër/O<sub>2</sub> dhe N<sub>2</sub>O 250-650 kPa dhe të suportoje standardet AGA DISS NIST, etj.

-Ekran me prekje LED dhe knob

-PEEP: 0-50 cmH<sub>2</sub>O

-Presioni i Inspirimi 0-120 cm H<sub>2</sub>O

-Aparati duhet të përdorë sistem qarkullimi me reflektor volume

-Valvola të emergjencës APL frymëmarrje e rastësishme deri në 80 cmH<sub>2</sub>O dhe për oksigjenin O<sub>2</sub> të paktën 0-10 l/min

-Volumi i respirimit për minutë: i larti 0.5-60 l/min dhe i ulët 0.01- 40l/min afërsisht

-Alarm APNEA: 5-45s dhe kur është i fikur. Alarmi për APNEA kur nuk ka frymëmarrje për 120s

-Kontroll në kohë reale i qarkut të frymëmarrjes, prani të ventilatorit alternativ me reflektor volume

-Koha e mbushjes së vaporizatorit afërsisht 4 ml/s

Ju vëmë në dukje se këto specifikime janë hartuar në kundërshtim të hapur me LPP dhe VKM, pasi ato janë realizuar në bazë të modelit të aparatit të anestezisë Flow-I, të prodhuesit Maquet (Getinge Group) (katalogu bashkëlidhur), gjë e cila favorizon në mënyrë të hapur distributorin e kësaj kompanie. Ndër të tjera, përveç specifikimeve numerike unike janë përdorur edhe terma dhe teknologji të patentuara të prodhuesit Getinge të cilat e bëjnë të pamundur ofrimin e produkteve nga prodhues të tjerë prestigjiozë. Për më tepër kërkesat e mësipërme nuk kanë asnjë vlerë klinike

apo funksionale për pajisjen, si për shembull: autokalibrimi i gazeve mjekësore i cili nuk ka asnjë vlerë teknike apo klinike, por është thjeshtë karakteristikë kufizuese e prodhuesit të sipërpërmendur. Presioni i inspirimit 0-120 cmH<sub>2</sub>O, PEEP 0-50cmH<sub>2</sub>O si dhe valvola e emergjencës APL deri në 80cmH<sub>2</sub>O, gjithashtu janë kërkuar në një diapazon të cilat nuk ka asnjë rendesi klinike pasi gjatë ventilimit manual, apo ventilimit automatik presioni maksimal në rrugët e frymëmarrjes nuk kalon 40-50 cmH<sub>2</sub>O. Gjithashtu çelësi Knob është një ndërfaqe e cila përdoret më së shumti në rastet kur pajisja nuk disponon një ndërfaqe tjetër ekuivalente për operatorin. Pajisjet e teknologjisë së fundit (vit prodhimi 2019-2021) kanë tashmë si ndërfaqe kryesore vetëekranin e tyre i cili është me funksion "touch screen" (me prekje). Në këtë ekran paraqiten të gjithë parametrat monitorues apo kontrollues/komandues nëpërmjet të cilëve operatori navigon në menu-në e pajisjes duke kontrolluar apo konfiguruar çdo parametër apo funksion të saj. Në bazë të Nenit 23, pika 3 (b) ku specifikimet teknike duhet t'iu referohen kërkesave në terma funksionale, kur një gjë e tillë kërkon t'u referohesh standardeve kombëtare ose ndërkombëtare, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale, del qartë se nëse pajisja kontrollohet totalisht nëpërmjet ekranit me prekje, i cili kërkohet në këtë procedurë, ajo nuk ka nevojë për një çelës knob. Alarmi Apnea kur nuk ka frymëmarrje për 120 s, është një tjetër kufizim lidhur me këtë prodhues si dhe mbushja e vaporizatorit 4ml/s është gjithashtu karakteristikë e vaporizatorëve elektronikë që ka aparati Flow-i i prodhuesit Getinge.

Gjithashtu teknologjia me refraktor volumi është një patente e kompanisë Getinge ku në vetë katalogun e saj citohet: *"Our patented Volume Reflector is a smart rebreathing system"*.

Duke qenë në kundërshtim të hapur me Nenin 23, pika 5 e Ligjit të Prokurimit **Publik kërkojmë që disa specifikime të HIQEN dhe të tjerat të ndryshohen si më poshtë, në diapazone dhe në vlera logjike për sa i përket performancës dhe qëllimit funksional të pajisjes:**

Sistem me 3 gaze mjekësore: O<sub>2</sub>, N<sub>2</sub>O dhe Ajër

Aparati duhet të suportoje hyrjet Ajër/O<sub>2</sub> dhe N<sub>2</sub>O 280–600 kPa dhe të suportoje standardet AGA DISS NIST, etj.

Ekran me prekje LED ose me knob

PEEP: 0-30 cmH<sub>2</sub>O

Presioni i Inspirimit: 0–60 cmH<sub>2</sub>O

Valvola të emergjencës APL frymëmarrje e rastësishme deri në 60 cmH<sub>2</sub>O dhe për oksigjenin O<sub>2</sub> të paktën 0-10 l/min

Volumi i respirimit për minutë: i larti 0.5-30 l/min dhe i ulët 0.1-40 V/min afërsisht

Alarm APNEA: 5 - 30s dhe kur është i fikur.

Lidhur me këtë pretendim të shoqërisë Biometric theksojmë se:

- Lidhur me pikën "Sistem me 3 gaze mjekësore: O<sub>2</sub>, N<sub>2</sub>O dhe Ajër me autokalibrim" sqarojmë OE se autokalibrimi ka një funksion shume te rendesishem qe ndihmon reanimatorin qe te mos fokusohet ne kalibrimin e raporteve midis gazrave (O<sub>2</sub>, No<sub>2</sub>, etj.),por personi pergjegjes te kete nen kujdes gjendjen shendetesore te pacientit gjate nderhyrjes. Pretendimi i OE qe ky specifikim gjendet vetem ne produktet e kompanise Getinge eshte i pabazuar pasi specifikime te tilla

ofrohen edhe kompani te tjera prodhuese, te cilet kane te instaluar ne tregun vendas kete produkt si: Draeger, General Electric Healthcare, Mindray,etj. Pretendimi nuk qendron.

- Lidhur me pikën “Aparati duhet te suportojë hyrjet Ajer/O<sub>2</sub> dhe N<sub>2</sub>O 250-650 kPa dhe te suportojë standardet AGA DISS NIST, etj.” theksojmë se OE kërkon modifikim të kësaj pike por nuk ka një sqarim se cili është elementi jo i duhur për këtë pikë. AK ka vendosur specifikimin në përpjesëtim me natyrën e kontratës ndaj kërkesa e OE për të ndryshuar një specifikim pa patur një arsye nuk qëndron.
- Në lidhje me pikën “Ekran me prekje LED dhe me knob” sqarojmë OE se Knob-i është një nga opsionet që e ofrojnë pothuajse të gjithë prodhuesit e makinave të anestezisë dhe nuk është një kriter përjashtues, por nga ana funksionale nuk e cënon pajisjen në vetvete. Për këtë arsye pretendimi juaj pranohet dhe bëhet “Ekran me prekje LED ose me knob”.
- Në lidhje me pikën “PEEP: 0-50 cmH<sub>2</sub>O” theksojmë qe vete OE ankimues eshte i qarte qe presioni maksimal ne rruget e frymemarrjes eshte 40-50 cm nderkohë që kërkon që të ndryshohet specifikimi dhe të bëhet PEEP 0-30 cmH<sub>2</sub>O. Kjo eshte nje kerkesa kontradiktore dhe per kete arsye pretendimi juaj nuk qendron.
- Ne lidhje me piken “Presioni i inspirimit 0-120 cm H<sub>2</sub>O” ky eshte nje parameter qe lidhet ngushte me volumin tidal sidomos gjate modaliteteve te ventilimit me ane te volumit. Nje nivel i larte i presionit te inspirimit rrit dhe nivelin e volumit tidal, pra jane ne përpjesëtim te drejte duke ndihmuar keshtu ne rritjen e shkarkimit te dioksidit te karbonit nga qarku i pacientit. Presioni i larte i inspirimit rrit dhe presionin mesatar te rrugeve te frymemarrjes duke permiresuar oksigjenimin. Pergjysmimi i ketij parametri nuk favorizon qellimin qe ka kjo pajisje por e perkeqeson ate. Pretendimi juaj nuk qendron.
- Ne lidhje me piken "Aparati duhet te perdore sistem qarkullimi me reflektor volume", per te stimuluar pjesemarrjen e OE, kjo pike behet: “Aparati duhet te perdore sistem qarkullimi me reflektor volume ose ekuivalente”.
- Ne lidhje me piken, "Valvola te emergjences APL frymemarrje e rastesishme deri ne 80 cm H<sub>2</sub>O dhe per oksigjenin O<sub>2</sub> te pakten 0-10 1/min" theksojmë se valvola APL perdoret gjate ventilimit manual ose spontan, kjo eshte nje valvul qe kontrollon presionin e gazeve ne qark gjate ketyre menyrave te ventilimit dhe percakton nivelin e gazeve "te perdorura" qe shkarkohen nga qarku. Kufizimi i ketij diapazoni do ta bente me te veshtire kontrollin e presionit ne keto modalitete dhe per kete arsye pretendimi juaj nuk qendron.
- Ne lidhje me piken "Volumi i respirimit per minute: i larti 0.5-60 min dhe i ulet 0.01–40 1/min" afersisht keto nivele volumi ofrohen pothuajse nga te gjithë prodhuesit e makinave te anestezise, per kete arsye pretendimi juaj nuk qendron.
- Ne lidhje me piken "Alarm APNEA: 5-45s dhe kur eshte i fikur. Alarmi per APNEA kur nuk ka frymemarrje per 120s" pretendimi juaj qendron dhe ndryshohet si me poshtë: Alarm APNEA: 5-45s dhe kur eshte i fikur.
- Ne lidhje me piken "Kontroll ne kohe reale i qarkut te frymemarrjes, prani te ventilatorit alternativ me reflektor volume" per te stimuluar pjesemarrjen e OE pretendimi juaj pranohet pjeserisht dhe behet: “Kontroll ne kohe reale i qarkut te frymemarrjes, prani te ventilatorit alternativ me reflektor volume ose ekuivalente”.
- Ne lidhje me piken "Koha e mbushjes se vaporizatorit afersisht 4 ml/s". Ju sqarojme qe te

*gjithe vaproizatorët modern të teknologjisë së fundit e kanë këtë mundësi. Duke qenë se ka edhe prodhues të tjerë si Draeger, General Electric Healthcare, Mindray, etj që ofrojnë këtë*

*lloj mbushjeje, pretendimi juaj nuk qëndron.*

**Pretendimi i tretë:** “ *Në shtojcën 10, Specifikime Teknike Lot 1 - F.V pajisje Mjekësore për Maternitetin e Beratit në lidhje me artikullin Nr. 3 Llambë Operatore, kërkojnë:*

- Ndriçimi për secilën kokë: të paktën 130,000 lux dhe të arrijë të paktën 160,000 lux*
- Të jetë e pajisur me sensor proksimal për kontrollin automatik të dritës në ndryshim të thellësisë*
- Diametri maksimal i fushës jo më pak se 30 cm*
- Ngjyra e temperaturës të paktën 3600 - 4800 K e rregullueshme me hapa*

*Këto specifikime janë hartuar duke u nisur nga modele të veçanta të llambave operatore. Për më tepër kërkesat e mësipërme nuk kanë asnjë vlerë klinike apo funksionale për pajisjen, ndaj për të mos kufizuar garën dhe për të krijuar mundësinë e ofertomi të produkteve ekuivalente ose më të avancuara kërkojmë që këto specifikime të ndryshohen si më poshtë, në diapazone dhe në vlera logjike për sa i përket performancës dhe qëllimit funksional të pajisjes:*

*Ndriçimi për secilën kokë: të paktën 140,000-160,000 lux  
Të mundësojë kontrollin automatik të dritës në ndryshim të thellësisë  
Diametri maksimal i fushës jo më pak se 26 cm  
Ngjyra temperaturës të paktën 4500-5000 K”*

*Lidhur me këtë pretendim të shoqërisë theksojmë se:*

*- Në lidhje me pikën “ ndriçimi për secilën kokë të paktën 130.000 lux dhe të arrijë të paktën 160,000 lux” ndriçimi është elementi kryesor i një llambe operatore dhe AK ka vendosur një diapazon të gjerë pikërisht për të stimuluar pjesëmarrjen e shumë OE. Duke patur parasysh se ndërhyrjet obstetrike /gjinekologjike janë me kavitete të mëdha dhe të thella depërtimi i dritës është shumë thelbësor. Këto nivele ndriçimi ofrohen pothuajse nga të gjithë prodhuesit serioz të llambave operatore. Për këtë arsye pretendimi juaj nuk qëndron.*

*- Në lidhje me pikën “ Të jetë e pajisur me sensor proksimal për kontrollin automatik të dritës në ndryshim të thellësisë” theksojmë se kontrolli automatik i dritës i lehtëson punë stafit mjekësor duke i ofruar funksione automatike të cilat nëse nuk do të ishin prezente do të duhej që këto funksione të kryhen në mënyrë manuale të cilat duan më shumë kohë duke ndërprerë ndërhyrjen dhe detyron doktorin të merret me rregullimin e dritës. Theksojmë se kjo teknologji është e re, bashkëkohore dhe e ofrojnë shumë prodhues të ndryshëm. Për këtë arsye pretendimi juaj nuk qëndron.*

*- Në lidhje me pikën “Diametri maksimal i fushës jo më pak se 30 cm” sqarojmë se ndërhyrjet obstetrike/gjinekologjike janë me kavitete të mëdha dhe të thella dhe kjo fushë ndriçimi është minimum për rastet e lindjeve dikorionike dhe stafit mjekësor mund ti duhet të ndriçojë sipërfaqe të mëdha prandaj është një specifikim i nevojshëm. Ky është një specifikim që ofrohet nga*



pothuajse të gjithë prodhuesit dhe nuk përbën kriter përjashtues për OE, për këtë arsye pretendimi juaj nuk qëndron.

- Në lidhje me pikën “ Ngjyra e temperaturës të paktën 3600-4800 K e rregullueshme me hapa ” sqarojmë OE se ky diapazon ngjyrash i ofron stafit mjekësor të përshtasë ngjyrën e dritës në varësi të ndërhyrjes që po kryejnë dhe në varësi të vaskularizimit të aktivitetit duke nxjerrë në pah edhe gjakderdhjet spontane. Ngushtimi i diapazonit siç kërkohet nga ankimuesi nuk favorizon elementet shtesë që nxjerr ndryshimi i temperaturës së ndriçimit për këtë arsye pretendimi juaj nuk qëndron.

**Pretendimi i katërt:** “Në shtojcën 10, Specifikime Teknike Lot 1 - F.V pajisje Mjekësore për Maternitetin e Beratit në lidhje me artikullin Nr. 4 Llambë Mobile, kërkohen:

-Lartësi e rregullueshme afërsisht 70 - 160cm

-Diametri i fushës së dritës së përqendruar të paktën 30 cm

-Temperatura e ngjyrës të kontrolluara elektronikisht të paktën nga 3700K deri 4700K

-Diametri i satelitit jo më pak se 35 cm

Në mënyrë që të krijohet mundësia e ofrimit të produkteve alternative të njëvlershme ose më të avancuara kërkojmë që këto specifikime të paraqiten me diapazon më të gjerë dhe të ndryshohen në:

Lartësi e rregullueshme afërsisht 127 - 160cm

Diametri i fushës së dritës së përqendruar të paktën 15-20 cm

Temperatura e ngjyrës të kontrolluara elektronikisht të paktën nga 4000K deri 4500K

Diametri i satelitit jo më pak se 19-25 cm.

Lidhur me këtë pretendim të shoqërisë Biometric theksojmë se:

- Në lidhje me pikën “ Lartësi e rregullueshme afërsisht 70-160 cm ” sqarojmë OE se kërkohet një lartësi e rregullueshme afërsisht 70 cm ndërkohë që OE pretendon të ofrojë një pajisje më të avancuar në performancë dhe qëllim funksional dhe ndërkohë kërkon zvogëlimin e lartësisë 127-160cm që përkthehet në 33 cm pra afërsisht sa gjysma e lartësisë së kërkuar për këtë arsye pretendimi juaj nuk qëndron.
- Në lidhje me pikën “ Diametri i fushës së dritës së përqendruar të paktën 30 cm ” sqarojmë edhe njëherë që ndërhyrje obstetrike/gjinekologjike janë me kavitete të mëdha dhe të thella dhe kjo fushë ndriçimi është minimum për rastet e lindjeve dikorionike. Ky është një specifikim që ofrohet pothuajse nga të gjithë prodhuesit dhe nuk përbën kriter përjashtues për OE për këtë arsye pretendimi juaj nuk qëndron. Pretendimi i OE nuk qëndron.
- Në lidhje me pikën “temperature e ngjyrës së kontrolluar elektronikisht të paktën nga 3700 K deri 4700 K ” është sqaruar më lart se ky diapazon i gjerë ngjyrash i ofron stafit mjekësor të përshtasë ngjyrën e dritës në varësi të ndërhyrjes që po kryejnë dhe në varësi të vaskularizimit të kavitetit duke nxjerrë në pah edhe gjakderdhjet spontane. Ngushtimi i diapazonit siç kërkohet nga ankimuesi nuk favorizon elementet shtesë që nxjerr ndryshimi i temperaturës së ndriçimit për këtë arsye pretendimi juaj nuk qëndron.
- Në lidhje me pikën “diametri i satelitit jo më pak se 35 cm’ theksojmë se kërkohet një llambë me diametër të tillë në mënyrë që të ofrojë një ndriçim më të mirë për shkak se mund të akomodojë brenda më shumë drita të vogla LED. Por nëse një llambë me diametër më të vogël plotëson

specifikimet e tjera të kërkuara diametri nuk e cënon funksionin e saj kështu që kërkesa juaj pranohet pjesërisht dhe bëhet si më poshtë: Diametri i satelitit jo më pak se 25 cm.

**Pretendimi i pestë:** “ Në shtojcën 10, Specifikime Teknike Lot 1 - F.V pajisje Mjekësore për Maternitetin e Beratit ne lidhje me artikullin Nr. 5 Llambë Ekzaminimi, kërkohen:

-Lartësi e rregullueshme afërsisht 70-160cm

Temperatura e ngjyrës të kontrolluara elektronikisht të paktën nga 3700K deri 4700K

-Intensiteti të paktën 50,000 lux

Në mënyre që të krijohet mundësia e ofrimit të produkteve alternative të njëvlershme ose më të avancuara kërkojmë që këto specifikime të paraqiten me diapazon më të gjerë dhe të ndryshohen në:

Lartësi e rregullueshme afërsisht 127 - 160cm

Temperatura e ngjyrës të kontrolluara elektronikisht të paktën nga 4000K deri 4500K

Intensiteti të paktën 35,000-50,000 lux”

Lidhur me këtë pretendim të shoqërisë Biometric theksojmë se:

- Në lidhje me pikën “Lartësi e rregullueshme afërsisht 70-160 cm” kërkohet një lartësi e rregullueshme 90 cm ndërkohë që OE pretendon të ofrojë pajisje më të avancuar dhe ndërkohë kërkon zvogëlimin e lartësisë 127-160 cm që përkthehet në 33 cm pra afërsisht sa 1/3 e lartësisë së kërkuar për këtë arsye pretendimi juaj nuk qëndron.

- Në lidhje me pikën “ Temperatura e ngjyrës të kontrolluara elektronikisht të paktën nga 3700K deri 4700 K” është sqaruar më sipër: ky diapazon i gjerë ngjyrash i ofron stafit mjekësor të përshtatë ngjyrën e dritës në varësi të ndërhyrjes që po kryejnë dhe në varësi të vaskularizimit të kavitetit duke nxjerrë në pah edhe gjakderdhjet spontane. Ngushtimi i diapazonit siç kërkohet nga ankimuesi nuk favorizon elementët shtesë që nxjerr ndryshimi i temperaturës së ndriçimit për këtë arsye pretendimi juaj nuk qëndron.

- Në lidhje me pikën “Intensiteti të paktën 50.000 lux” theksojmë se intensiteti është një faktor kryesor në llambat e ekzaminimit. Ekzaminimi është faza e pare ku përcaktohet edhe diagnoza për pacientin dhe është shumë e rëndësishme që kjo diagnozë të jetë e saktë. Duke ulur intensitetin e ndriçimit shtohen shanset për të gabuar dhe për këtë arsye pretendimi juaj nuk qëndron.

**Pretendimi i gjashtë:** “Në shtojcën 10, Specifikime Teknike Lot 1 - F.V pajisje Mjekësore për Maternitetin e Beratit ne lidhje me artikullin Nr. 10 AED external me monitor, kërkohen:

-Tipi i ekranit ST-NLT ngjyrim TFT

-Nr. i gjurmimit 6 formë valësh

-ECG Lidhje Kabull me 3, 6 dhe 10 elektroda

-Numri i kanaleve te EKG: 2 (maksimum, me 6 ose 10 elektroda të shfaqura ne ekran), 12 (maksimum, me 10 elektroda ose dritare me 12 drejtime)

-Shkalla e paraqitjes së ritmit të zemrës: 15 ne 220 bpm

*-Duhet të ketë alarme si dhe sinjale vizuale: Gjendje kritike me sinjal të kuq, gjendje që duhet pasur kujdes me sinjalizim të verdhë, nevojë konsultimi me ngjyrë të kaltër.*

*Së pari, ju vëmë në dukje se specifikimet për këtë artikull janë hartuar duke u marrë copy-paste nga modeli i defibrilatorit Cardiolife TEC-8300 i prodhuesit Nihon Kohden (katalogu bashkëlidhur), duke kufizuar konkurrencën e hapur dhe duke bërë të pamundur ofertimin e produkteve alternative, në kundërshtim të plotë me LPP dhe VKM. Për më tepër hartimi i specifikimeve nuk është ndërtuar në baze të parametrave që kanë vërtet rëndësi klinike për jetën e pacientit, por në kërkesa të cilat nuk kanë lidhje me funksionalitetin dhe performancën e pajisjes.*

*Në mënyrë që të mos favorizohet vetëm një operator i caktuar, për të mundësuar një garë të hapur e korrekte dhe në mënyrë që të krijohet mundësia e ofrimit të produkteve alternative të njëvlershme ose më të avancuara kërkojmë që këto specifikime të paraqiten me diapazon më të gjerë dhe të ndryshohen në:*

*Tipi i ekranit me ngjyra TFT*

*Nr. i gjurmimit 4 formë valësh*

*ECG Lidhje Kabull me 3, 6 dhe 10 elektroda ose 3/5/12 elektroda*

*Numri i kanaleve të EKG: 2 (maksimum, me 5-6 ose 10-12 elektroda të shfaqura ne ekran),*

*12 (maksimum, me 10-12 elektroda të shfaqura në ekran)*

*Shkalla e paraqitjes së ritmit të zemrës në modalitet pacing: 30 në 200 bpm*

*Duhet të ketë alarme si dhe sinjale vizuale: Gjendje kritike me sinjal të kuq, gjendje që duhet pasur kujdes me sinjalizim të verdhë.*

*Lidhur me këtë pretendim të shoqërisë Biometric theksojmë se:*

- Në lidhje me pikën “Tipi i ekranit ST-NLT ngjyrim TFT” sqarojmë OE se kjo është një teknologji e fundit e cila kërkon një ekran me dritë natyrale e tipit TFT. Në thelb ekrani mbetet i tipit TFT por kjo është thjeshtë një nga teknologjitë e ndërtimit. Duke qenë se nuk cënohet funksioni i pajisjes specifikimi bëhet: Tipi i ekranit ST-NLT ngjyrim TFT/LCD/LED ose ekuivalent.*
- Ne lidhje me pikën " Nr. i gjurmimit 6 forme valesh" theksojmë se forme valet janë shume te rendesishme ne monitorimin e parametrave vitale te pacientit, ato luajne nje rol kyc ne percaktimin e sakte te gjendjes se pacientit, sidomos ne rastet kur pacienti ka nevojë per defibrilim. Ky eshte nje specifikim qe ofrohet nga shume prodhues te ndryshem dhe nuk perben kriter perjashtues per OE. Per kete arsye pretendimi juaj nuk qendron.*
- Në lidhje me pikën “ECG lidhje kabull 3,6 dhe 10 elektroda” pretendimi juaj pranohet pasi një numër më i madh elektrodash ndihmon në përcaktimin e saktë të ritmit kardiak dhe bëhet si më poshtë: Numri i kanaleve të EKG: 2 (maksimumi me 5-6 ose 10-12 elektroda të shfaqura në ekran) 12 (maksimumi, me 10-12 elektroda të shfaqura në ekran ose dritare me 12 drejtime”.*
- Në lidhje me pikën “Shkalla e paraqitjes së ritmit të zemrës: 15 në 220 bpm”, theksojmë se ritmi i zemrës është një nga parametrat kryesorë në përcaktimin e gjendjes së pacientit, për këtë arsye duhet një diapazon sa më i gjërë matjeje, ky është një specifikim që ofrohet nga shume prodhues te ndryshem dhe nuk perben kriter perjashtues per OE. Per kete arsye pretendimi juaj nuk qendron.*

- Në lidhje me pikën “Duhet të ketë alarme si dhe sinjale vizuale: Gjendje kritike me sinjal të kuq, gjendje që duhet pasur kujdes me sinjalizim të verdhë, nevojë konsultimi me ngjyrë të kaltër” theksojmë se ofrimi i tre ngjyrave të ndryshme për të bërë diferencimin e nivelit të alarmit është shumë i rëndësishëm në këtë mënyrë stafi mjekësor mund të bëjë diferencimin e alarmit dhe nga distanca sidomos kur është në funksion monitori. Ky lloj sinjalizimi vizual është elementar për pajisje të riskut dhe plotëson minimumin e standardeve të pajisjeve mjekësore. Për këtë arsye pretendimi juaj nuk qëndron.

**Pretendimi i shtatë:** Në shtojcën 10, Specifikime Teknike Lot 1 - F.V pajisje Mjekësore për Maternitetin e

Beratit në lidhje me artikullin Nr. 16 Shiringë Infuzioni elektrike, kërkohen:

-Saktësia +1% me një minimum shiringash 100

Të operojë në presion 250-900 mmHg në hapa 50 mm Hg ose në hapa 25 mmHg për presion 50-250 mmHg

Së pari, ju vëmë në dukje se specifikimet për këtë artikull janë hartuar duke u marrë copy-paste nga modeli Agilia SP i prodhuesit Fresenius KABI (katalogu bashkëlidhur), duke kufizuar konkurrencën e hapur dhe duke bere te pamundur ofertimin e produkteve alternative, ne kundërshtim te plote me LPP dhe VKM.

Për më tepër hartimi i specifikimeve nuk është ndërtuar në bazë të parametrave që kanë vërtet rëndësi klinike për jetën e pacientit, por në kërkesa të cilat nuk kanë lidhje me funksionalitetin dhe performancën e pajisjes.

Në mënyrë që të mos favorizohet vetëm një operator i caktuar, për të mundësuar një garë të hapur e korrekte dhe në mënyrë që të krijohet mundësia e ofrimit të produkteve alternative të njëvlershme ose më të avancuara kërkojmë që këto specifikime të paraqiten me diapazon më të gjerë dhe të ndryshohen në:

Saktësia +2% me një minimum shiringash 50

Të operojë në presion 80-900 mm Hg ne 10-11 nivele.”

Lidhur me këtë pretendim të shoqërisë Biometric theksojmë se:

- Ne lidhje me piken "Saktesia +1% me nje minimum shiringash 100", saktesia eshte faktori kryesor te shiringa per t'i dhene pacientit dozen e duhur gjate infuzionit. Per kete arsye pretendimi juaj nuk qendron.
- Ne lidhje me piken "Te operoje ne presion 250-900 mmHg ne hapa 50 mm Hg ose ne hapa 25 mHg per presion 50-250 mmiig", sqarojme se nje diapazon me i gjere do te ndihmonte ne zgjerimin e funksionalitetit te shringes, per kete arsye pretendimi juaj qendron dhe behet si me poshte: “Te operoje ne presion 80-900 mmHg ne hapa 25 ose 50 mm Hg”.

**Pretendimi i tetë:** Në shtojcën 10, Specifikime Teknike Lot 1 - F.V pajisje Mjekësore për Maternitetin e Beratit ne lidhje me artikullin Nr. 18 Pompë infuzioni, kërkohen:

-Koha e infuzionit: 1 s - 165 orë e 59 minuta

-KVO e rregullueshme 1 - 20.0 ml/orë

Ju vëmë përsëri në dukje se specifikimet për këtë artikull janë hartuar duke u marrë copy-paste nga modeli Agilia VP MC, gjithashtu i prodhuesit Fresenius KABI (katalogu bashkëlidhur), duke kufizuar konkurrencën e hapur dhe duke bërë të pamundur ofertimin e produkteve alternative, në kundërshtim të plotë me LPP dhe VKM. Për më tepër hartimi i specifikimeve nuk është ndërtuar në bazë të parametrave që kanë vërtetë rëndësi klinike për jetën e pacientit, por në kërkesa të cilat nuk kanë lidhje me funksionalitetin dhe performancën e pajisjes siç është koha e infuzionit deri në 166 orë apo KVO deri 20ml/orë, parametra të cilët i plotëson vetëm modeli i sipërpërmendur i prodhuesit Fresenius Kabi.

Në mënyrë që të mos favorizohet vetëm një operator i caktuar, për të mundësuar një garë të hapur e korrekte dhe në mënyrë që të krijohet mundësia e ofrimit të produkteve alternative të njëvlershme ose më të avancuara kërkojmë që këto specifikime të paraqiten me diapazon me të gjerë dhe  $t = ndryshohen\ n = :$

Koha e infuzionit: 1 s-99 orë e 59 minuta

KVO e rregullueshme 1 - 5.0 ml/orë.

Lidhur me këtë pretendim të shoqërisë Biometric theksojmë se:

- Ne lidhje me piken, "Koha e infuzionit: 1 s - 165 ore e 59 minuta", theksojmë se koha e infuzionit ka rëndësi kur ka paciente që kanë nevojë për trajtim afatgjatë. Kjo i mundëson stafit mjekësor një administrim me të mirë të ilaceve dhe të kohës së mjekimit. Për këtë arsye pretendimi juaj nuk qëndron.
- Ne lidhje me piken "KVO e rregullueshme 1 - 20. 0 ml/orë", theksojmë se KVO është një parameter shumë i rëndësishëm që bën të mundur që ena e intubuar të mbahet e hapur sidomos në trajtimet e gjata dhe që kanë nevojë për administrim mjekimesh të mevonshme të njëpasnjëshme. Zvogëlimi i nivelit maksimal nuk do të sillte asnjë përfitim për stafin mjekësor por do të vështirësonte punën duke rritur mundësinë për të pasur bllokime gjatë infuzionit për këtë arsye pretendimi juaj nuk qëndron.

**Pretendimi i nëntë:** Në shtojcën 10, Specifikime Teknike Lot 1 - F.V pajisje Mjekësore për Maternitetin e Beratit në lidhje me artikullin Nr. 20 Pajisje për monitorimin e parametrave vital neonet, kërkojmë:

-Ekran i sheshtë TFT/LCD/LED me prekje min 12 inch me mundësi afishimi të paktën 15 të formave të valës.

-Monitori duhet të ketë mundësi të bllokimit të komandimit me prekje dhe të ofroj mundësi kontrolli ndërmjet butonave fizik

-ECG (3/6/10 lidhje)

-Të përshtatet me standardet ISO 9919: 2005, ISO 80601-2-61:2011

-Interval i ulët 0 deri 148

-Alarmi Apnea : Fikur, 5 deri 40 s në 5 hapa

- Tipi i matjes: sistolik, Interval dhe mesatar: Sistolik: 40 deri 280 mmHg; Diastolik: 10 to 235 mmHg; (MAP): 10 deri 280 mmHg;

-Neonate: Sistolik: 30 deri 140 mmHg; Diastolic: 10 deri 110 mmHg; (MAP): 10 deri 140 mmHg

*-Pediatrik: Systolic 40 deri 280 mmHg, Diastolic: 10 deri 235 mmHg, MAP: 10 deri 280 mmHg*

*Së pari, ju vëmë në dukje se specifikimet për këtë artikull janë hartuar sipas modelit Life ScopeVS Series 3763, i prodhuesit Nihon Kohden, duke kufizuar konkurrencën e hapur dhe duke bërë të pamundur ofertimin e produkteve alternative, në kundërshtim të plotë me LPP dhe VKM.*

*Për më tepër hartimi i specifikimeve nuk është ndërtuar në bazë të parametrave që kanë vërtetë rëndësi klinike për jetën e pacientit, por në kërkesa dhe numra fikse të cilët i takojnë modelit të sipërpërmendur .*

*Këto specifikime nuk janë mbështetur në asnjë përvojë të mëparshme, siç janë procedura prokurimi të ngjashme të organizuara nga Ministria e Shëndetësisë apo Banka Botërore, por janë përcaktuar të tilla duke kërkuar pajisje që për më tepër nuk janë instaluar në asnjë nga klinikat universitare apo në departamentet e kardiokirurgjisë/hemodinamikeës, Në një kohë që kërkohet standardizimi dhe njehsimi i pajisjeve të instaluara në spitalet rajonale, mënyra e hartimit të këtyre specifikimeve, duke mos u mbështetur në asnjë përvojë të mëparshme, bie ndesh me këto standarde. Ju vëmë në dukje pikat si më poshtë:*

*Për një monitor të kërkuar me madhësi ekrani 12 inc, nuk është i nevojshëm pasqyrimi i formave valore deri ne 15. Kjo është një vlerë kufizuese dhe i përket vetëm modelit të sipërpërmendur.*

*Për më tepër për monitorimin e parametrave vitale pediatrike apo neonat, 8 forma valore janë mëse të mjaftueshme për një ekran të madhësisë 12 inc.*

*ISO 9919: 2005 dhe ISO 80601-2-61:2011 janë standarde të njëvlershme, ndaj mjafton te kërkohet njëri prej tyre.*

*Intervali i ulët i respirimit është kërkuar në një diapazon të krahasueshëm me nivelin e lartë, ndaj mendojmë se është lapsus.*

*Gjithashtu "kontrolli me butona fizike" është një ndërfaqe e cila përdoret më së shumti në rastet kur pajisja nuk disponon një ndërfaqe tjetër ekuivalente për operatorin.*

*Pajisjet e teknologjisë së fundit (vit prodhimi 2019-2021) kanë tashme si ndërfaqe kryesore vetë ekranin e tyre i cili është me funksion "touch screen" (me prekje). Në këtë ekran paraqiten të gjithë parametrat monitorues apo kontrollues/komandues nëpërmjet të cilëve operatori navigon në menu-në e pajisjes duke kontrolluar apo konfiguruar çdo parametër apo funksion të saj.*

*Në bazë të Nenit 23, pika 3 b) ku specifikimet teknike duhet t'iu referohen kërkesave në terma funksionale, kur një gjë e tillë kërkon t'u referohesh standardeve kombëtare ose ndërkombëtare, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale, del qartë se nëse pajisja kontrollohet totalisht nëpërmjet ekranit me prekje, i cili kërkohet në këtë procedurë, nuk ka nevojë për butona fizike.*

*Në mënyrë që me përpilimin e specifikimeve të mësipërme të mos favorizohet vetëm një operator i caktuar, për të mundësuar një garë të hapur e korrekte dhe në mënyrë që të krijohet mundësia e ofrimit të produkteve alternative të njëvlershme ose me të avancuara kërkojmë që **këto specifikime të ndryshohen si më poshtë, në diapazone dhe në vlera logjike për sa i përket performancës dhe qëllimit funksional të pajisjes:***

***Ekran i sheshtë TFT/LCD/LED me prekje min 12 inch me mundësi afishimi të paktën 8 të formave të valës***

***Monitori duhet të ketë mundësi e bllokimit të komandimit me prekje ose të ofrojë mundësi***

**kontrolli ndërmjet butonave fizik**

**ECG (3/6/10 lidhje) ose (3/5/12 lidhje)**

**Të përshtatet me standardet ISO 9919: 2005 ose ISO 80601-2-61:2011**

**Interval ulët 0 deri 20**

**Alarmi Apnea : Fikur, 10 deri 40 s ne 5 hapa**

**Tipi i matjes: sistolik, Interval dhe mesatar: Sistolik: 40 deri 280 mmHg; Diastolik: 10 to 235 mmHg; (MAP): 15 deri 260 mmHg;**

**Neonate: Sistolik: 30 deri 140 mmHg; Diastolic: 10 deri 110 mmHg; (MAP): 15 deri 125 mmHg**

**Pediatrik: Systolic 40 deri 240 mmHg, Diastolic: 10 deri 200 mmHg, MAP: 15 deri 215 mmHg”.**

*Lidhur me këtë pretendim të shoqërisë Biometric theksojmë se:*

- *Ne lidhje me piken "Ekran i sheshte TFT/LCD/LED me prekje min 12 inch me mundesi afishimi te pakten 15 te formave te vales" sqarojme OE ekranin i kerkuar eshte min 12 inch, pra nuk e perjashton mundesine per te ofruar nje ekran me te madh, per sa kohe monitori i ofron keto parametra ai ofron dhe mundesine e afishimit te tyre, per kete arsye pretendimi juaj nuk qendron.*
- *Ne lidhje me piken "Monitori duhet te kete mundesine e bllokimit te komandimit me prekje dhe te ofroje mundesi kontrolli ndermjet butonave fizik”, theksojme se ky eshte nje opsion qe mundeson bllokimin e kontrollit me prekje ne menyre qe te shmanget nje komande e pavullnetshme nga personeli mbeshtetes. Monitori i kerkuar eshte me ekran me prekje sipas teknologjise se fundit, dhe me butona fizike, pra ka dy lloj nderfaqesh perdorimi, per kete arsye pretendimi juaj nuk qendron.*
- *Në lidhje me pikën “ECG(3/6/10 lidhje)” pretendimi juaj pranohet pasi një numër më i madh elektrodash ndihmon në përcaktimin e saktë të ritmit kardiak dhe bëhet si më poshtë: ECG 93610 lidhje) ose ( 3/512 lidhje)”*
  - *Në lidhje me pikën “Të përshtatet me standardet ISO 9919:2005, ISO 80601-2-61:2011” pretendimi juaj qëndron dhe kjo pikë ndryshon dhe bëhet si më poshtë: Të përshtatet me standarde ISO 9919:2005 ose ISO 80601-2-61:2011.*
  - *Në lidhje me pikën “Interval i ulët 0 deri 148” theksojmë se intervali është i nivelit i ulët i njoftimit dhe specifikimi ofrohet nga shume prodhues te monitoreve, per kete arsye pretendimi juaj nuk qendron.*
  - *Ne lidhje me piken "Alarmi Apnea: Fikur, 10 deri 40 s ne 5 hapa”, theksojmë se OE kërkon modifikim të kësaj pike por nuk ka një sqarim se cili është është elementi jo i duhur për këtë pikë. AK ka vendosur specifikimin në përpjesëtim me natyrën e kontratës ndaj pretendimi i OE për të ndryshuar një specifikim pa patur një arsye nuk qëndron.*
  - *Ne lidhje me piken "Tipi i matjes: sistolik, Interval dhe mesatar: Sistolik: 40 deri 280 mmHg; Diastolik: 10 to 235 mmHg; (MAP): 10 deri 280 mmHg”, theksojmë se OE kërkon modifikim të kësaj pike por nuk ka një sqarim se cili është është elementi jo i duhur për këtë pikë. AK ka vendosur specifikimin në përpjestim me natyrën e kontratës ndaj kërkesa e OE për të ndryshuar një specifikim pa patur një arsye nuk qëndron.*

- Ne lidhje me piken "Neonate: Sistolik: 30 deri 140 mmHg; Diastolic: 10 deri 110 mmHg; (MAP): 10 deri 140 mmHg" theksojmë se OE kërkon modifikim të kësaj pike por nuk ka një sqarim se cili është elementi jo i duhur për këtë pikë. AK ka vendosur specifikimin në përpjesëtim me natyrën e kontratës ndaj kërkesa e OE për të ndryshuar një specifikim pa patur një arsye nuk qëndron.
- Ne lidhje me piken "Pediatrik: Systolic 40 deri 280 mmHg, Diastolic: 10 deri 235 mmHg, MAP: 10 deri 280 mmHg", theksojmë se OE kërkon modifikim të kësaj pike por nuk ka një sqarim se cili është elementi jo i duhur për këtë pikë. AK ka vendosur specifikimin në përpjesëtim me natyrën e kontratës ndaj kërkesa e OE për të ndryshuar një specifikim pa patur një arsye nuk qëndron.

**Pretendimi i dhjetë:** “Në shtojcën 10, Specifikime Teknike Lot 1 - F.V pajisje Mjekësore për Maternitetin e Beratit ne lidhje me artikullin Nr. 21 Radiante, kërkohet:

Në modalitet Manual Intensiteti i energjisë ngrohëse duhet të rregullohet manualisht nga operatori në të paktën 50 nivele energjie nga 0-100%.

Në menyre që të krijohet mundësia e ofrimit të produkteve alternative të njëvlershme ose me të avancuara kërkojmë që ky specifikim të ndryshohet në:

Në modalitet Manual Intensiteti i energjisë ngrohëse duhet të rregullohet manualisht nga operatori në të paktën 20 nivele energjie nga 0-100%.

Lidhur me këtë pretendim të shoqërisë Biometric theksojmë se:

Në lidhje me pikën “Në modalitet Manual Intensiteti i energjisë ngrohëse duhet të rregullohet manualisht nga operatori në të paktën 50 nivele energjie nga 0-100%” OE pretendon që kërkon të ofroj produkte të njëvlershme ose të avancuara por kjo bie ndesh me kërkesën për ndryshimin e specifikimeve pasi kërkohet ulja e numrit të niveleve të energjisë e cila përkthehet në një pajisje më pak të avancuar. Për këtë arsye pretendimi juaj nuk qëndron.

**Pretendimi i njëmbëdhjetë:** “Në shtojcën 10, Specifikime Teknike Lot 1 - F.V pajisje Mjekësore për Maternitetin e Beratit në lidhje me artikullin Nr. 22 Aparat fototerapie (llambë fototerapie), kërkohen:

-Të ketë të paktën 20 LED dhe fuqia jo më shumë se 20 W

-Sistemi LED të ofroj jetëgjatësi të paktën 35,000 orë pune

-Rrezatimi i sistemit LED të ketë gjatësi vale 450 nm (W/cm /nm) në fushë 54 - 56cm

-Fusha e rrezatimit ne 440 - 460 nm (uW/cm /nm) të mbulojë lartësinë 43 - 45 cm

Së pari, ju vëmë në dukje se specifikimet për këtë artikull janë hartuar në baze të modelit BiliblueLight, i prodhuesit Lowenstein Medical (katalogu bashkëlidhur), duke kufizuar konkurrencën e hapur dhe duke bërë të pamundur ofertimin e produkteve alternative,në kundërshtim të plotë me LPP dhe VKM.



Kërkojmë që këto specifikime të korrigjohen dhe ndryshohen si më poshtë, në diapazone dhe në vlera logjike për sa i përket performancës dhe qëllimit funksional të pajisjes:

Të ketë të paktën 20 LED dhe fuqi 20-50 W

Sistemi LED të ofrojë jetëgjatësi të paktën 20,000 orë pune

Fusha e rrezatimit në 450 - 470 nm [40 - 100 W/cm /nm]

Lidhur me këtë pretendim të shoqërisë Biometric theksojmë se:

- Ne lidhje me piken "Te kete te pakten 20 LED dhe fuqia jo me shume se 20W", sqarojme qe eshte nje lapsus dhe behet: "Te kete te pakten 20 LED dhe fuqia jo me shume se 20W".
- Ne lidhje me piken "Sistemi LED të ofroje jetegjatesi te pakten 35,000 ore pune", theksojme se oret e punes jane te rendesishme te llamba, duke ditur qe dhe jetegjatesia e llampes LED tregon njekohesisht edhe cilesine e tyre, ky eshte nje specifikim qe ofrohet nga shume prodhues te ndryshem dhe nuk perben kriter perjashtues per OE. Per kete arsye pretendimi juaj nuk qendron.
- Në lidhje me pikën " Fusha e rrezatimit në 440-460 nm (uW/cm /nm) të mbulojë lartësinë 43 - 45 cm" kërkesa juaj nuk e cënon funksionimin e pajisjes por e zgjeron diapazonin duke ofruar dhe më mire për këtë arsye pretendimi juaj pranohet dhe bëhet: Fusha e rrezatimit në 440-460 [40 - 100 W/cm /nm].

**Pretendimi i dymbëdhjetë:** "Në shtojcën 10, Specifikime Teknike Lot 1 - F.V pajisje Mjekësore për Maternitetin e Beratit në lidhje me artikullin Nr. 27 Inkubator Bebe, kërkohet:

-Kontroll i lagështisë: 40-95% në 1% Inkrementim

Në mënyrë që të krijohet mundësia e ofrimit të produkteve alternative të njëvlershme ose më të avancuara kërkojmë që ky specifikim të ndryshohet në:

Kontroll i lagështisë: 40-90% në 1% Inkrementim".

Lidhur me këtë pretendim të shoqërisë Biometric theksojmë se:

- Në lidhje me pikën "Kontrolli i lagështisë: 40-95% në 1% inkrementin" theksojmë se një diferencë prej 5% është e pranueshme dhe nuk cënon funksionalitetin e pajisjes. Pretendimi juaj pranohet dhe bëhet si më poshtë: " Kontrolli i lagështisë 40-90% në 1% inkrementim.
- KSHA gjykon se përmbushja e kritereve ekonomike teknike e profesionale në rastin konkret është një detyrim që buron nga ligji i cili në mënyrë taksative kërkon përmbushjen e tyre nga të gjithë operatorët ekonomik.

**Pretendimi i trembëdhjetë:** "Në shtojcën 10, Specifikime Teknike Lot 1 - F.V pajisje Mjekësore për Maternitetin e Beratit në lidhje me artikullin Nr. 28 Blanket fototerapie, kërkohet:

- Diapazoni i rrezatimit optik brenda diapazonit: 430-490 nm.

Sic dihet rrezatimi optik ku arrihet absorbimi maksimal i bilirubines gjate trajtimit të foshnjave të porsalindura në këtë lloj pajisje është 458nm. Pra është mëse e mjaftueshme që diapazoni i ofruar të përfshijë këtë vlerë.

Në mënyrë që të krijohet mundësia e ofrimit të produkteve alternative të njëvlershme ose më të avancuara kërkojmë që ky specifikim të ndryshohet në:

Diapazoni i rrezatimit optik brenda diapazonit: 450-470nm.

Lidhur me këtë pretendim të shoqërisë Biometric theksojmë se:

- Lidhur me pretendimin e sipërcituar gjykojmë se është një pretendim i pabazuar, pasi kërkesa që operatori kërkon të modifikohet përfshihet në specifikimin e vendosur nga Autoriteti Kontraktor. Përsëri në këtë pike që specifikimet e vendosura janë gjithëpërfshirëse dhe absolutisht nuk çenojnë asnjë operator ekonomik. Pretendimi i OE nuk qëndron.

**Pretendimi i katërmëdhjetë:** Gjithashtu theksojmë se në kriteret e veçanta të kualifikimit (për lotin 1), 2.3 Kapaciteti teknik, pika 5 Operatori duhet të paraqesë certifikatë konformiteti CE ose FDA sipas Direktivës (MMD ose MDR) 93/42 EEC, të vlefshme ose ekuivalente për artikujt e ofruar sipas kategorizimit të tyre.

Kërkohen certifikata konformiteti sipas direktivës së pajisjeve mjekësore për të gjithë artikujt e Lotit 1, ndërkohë që disa prej tyre si për shembull, Stol me 1 shkallë, stol kirurgjikal nuk kategorizohen si pajisje mjekësore, dhe rrjedhimisht nuk janë të pajisura me deklaratë konformiteti CE.

Kërkojmë që ky kriter të modifikohet në:

Operatori ekonomik duhet të paraqesë Certifikata konformiteti CE ose FDA sipas direktivës (MDD ose MDR) 93/42 EEC, të vlefshme, ose ekuivalente, për artikujt e ofruar aty ku është e aplikueshme, sipas kategorizimit të tyre.

Lidhur me këtë pretendim të shoqërisë Biometric theksojmë se:

- Lidhur me këtë pike sqarojmë se pretendimi i OE pranohet. Ky kriter të modifikohet si më poshtë:
- Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikata konformiteti CE ose FDA sipas direktivës ( MDD ose MDR) 93/42 EEC të vlefshme ose ekuivalente për artikujt e ofruar aty ku është e aplikueshme sipas kategorizimit të tyre.

II.3. Në datën 15.02.2021 operatori ekonomik “Biometric Albania” sh.pk ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik duke pretenduar se; “[...]Me poshtë po rendisim pikat dhe faktet në lidhje me pretendimin tone, te cilat nuk jane marre parasysh nga Autoriteti Kontraktor Spitali Rajonal Berat:

**1. Ne shtojcen** 10, Specifikime Teknike, Lot 1 - F.V pajisje Mjekesore për Maternitetin e Beratit ne lidhje me artikullin Nr. 1 Tavoline Operatore-Obsertikale dhe gjinekologjike kerkohen:

-Pajisja te jete e mbeshtetur ne 4 rrota dhe me mbeshtetje statike gjate nderhyrjeve

-Krevati te mbaje peshe te pakten 300 kg

-Levizjet anesore majtas-djathtas te pakten 35 gradë

Ju veme ne dukje se prodhues te ndryshem ofrojne opsione te ndryshme te suportit mbeshtetes te

tavoline operatore, sic eshte mbeshtetja statike ose suporti me rrota. Rrjedhimisht plotesimi i njerës prej kerkesave eshte i mjaftueshem persa i perket funksionalitetit te pajisjes dhe levizjes se saj.

Nese tavolina operatore eshte e pajisur me rrota me frena, atehere stafi mjekesor mund ta levize lehtesisht ate kur eshte e nevojshme si dhe ta vendose ne pozicion statik me ane te frenave gjate nderhyrjeve. Gjithashtu kapaciteti mbajtes 300kg eshte nje tjeter kriter jo i nevojshem dhe kufizues, pasi dihet qe pesha e pacientit se bashku me aksesoret qe mund te montohen ne tavoline, nuk mund te arrije ne keto vlera. Per me teper tavolina operatore e kerkuar eshte per qellime obstetrike-gjinekologjike dhe jo ortopedike, rast ne te cilin, sasia e moduleve shtese dhe aksesoreve qe mund te montohen ne tavoline eshte me e madhe.

Levizja anesore laterale te pakten 35 grade eshte nje tjeter kriter kufizues, pasi diferenca me  $\pm 5$  grade nuk ka asnje ndikim ne procedurat obstetrike gjinekologjike dhe pozicionimi lateral ne nje kend  $\pm 30$  grade eshte mese i mjaftueshem edhe gjate komplikacioneve qe mund te shkaktohen nga presioni i larte.

Per te mos kufizuar garen dhe per te krijuar mundesine e ofertimit te produkteve ekuivalente pa cenuar funksionalitetin e pajisjes **kerkojme qe keto specifikime te ndryshohen si me poshte:**

**Pajisja te jete e mbeshtetur ne rrota me frena ose me mbeshtetje statike gjate nderhyrjeve**

**Krevati te mbaje peshe te pakten 270 kg**

**Levizjet anesore majtas-djathtas te pakten 30 grad**

2. Ne shtojcen 10, Specifikime Teknike Lot 1 - F.V paisje Mjekesore per Maternitetin e Beratit ne lidhje me artikullin Nr. 2 Makine Anestezie (Set) kerkohen:

-Sistem me 3 gaze mjekesore: O<sub>2</sub>, N<sub>2</sub>O dhe Ajer me auto-kalibrim

- Aparati duhet te suportoje hyrjet Ajer/O<sub>2</sub> dhe N<sub>2</sub>O 250-650 kPa dhe te suportoje standardet AGA

DISS NIST, etj

-PEEP: 0-50 cmH<sub>2</sub>O

-Presioni i Inspirimit: 0-120 cmH<sub>2</sub>O

-Aparati duhet te perdore sistem qarkullimi me reflektor volume

-Valvola te emergjences APL frymemarrje e rastesishme deri ne 80 cmH<sub>2</sub>O dhe per oksigjenin O<sub>2</sub> te pakten 0-10 l/min

-Alarm APNEA: 5 - 45s dhe kur eshte i fikur.

-Kontroll ne kohe reale i qarkut te frymarrjes, prani te ventilatorit alternativ me reflektor volume

-Koha e mbushjes se vaporizatorit afersisht 4 ml/s

Ju veme ne dukje se keto specifikime jane hartuar ne kundersizim te hapur me LPP dhe VKM, pasi ato jane realizuar ne baze te modelit te aparatit te anestezise Flow-I, te prodhuesit Maquet (Getinge Group) (katalogu bashkelidhur), gje e cila favorizon ne menyre te hapur distributorin e kesaj kompanie. Nder te tjera, pervec specifikimeve numerike unike jane perdorur edhe terma dhe teknologji te patentuara te prodhuesit Getinge te cilat e bejne te pamundur ofrimin e produkteve nga prodhues te tjere prestigjoze.

Per me teper kerkesat e mesiperme nuk kane asnje vlere klinike apo funksionale per pajisjen, sic edhe rendisim ne vijim:

Autokalibrimi i gazeve mjekesore eshte thjesht karakteristike kufizuese e prodhuesit te siperpermendur. Theksojme se asnje nga prodhuesit e pretenduar nga AK nuk e disponon karakteristiken e autokalibrit te gazeve.

Per kete arsye kerkojme qe ky specifikim TE HIQET.

Gjithashtu diapazoni i presionit te gazeve hyrese 250-650 kPa, disponohet vetem nga ky prodhues, pasi shume kompani te tjera prodhuese si GE, Mindray, Draeger, Medec Benelux e kane kete diapazon 280-600 kPa.

**PEEP 0-50cmH<sub>2</sub>O**

Kerkesa jone per kete pike nuk eshte aspak kontradiktore sic edhe shprehet AK, pasi parametri i presionit PEEP nuk ka te beje me presionin maksimal inspirim-ekspirim ne rruget e frymemarrjes. PEEP (Positive End Expiratory Pressure) eshte presioni alveolar ne mushkeri qe mbetet ne fund te nje ekspirimi, per te shmangur kolapsin e tyre. Ky presion konsiston ne vlera normale 1-5 cmH<sub>2</sub>O, dhe ne varesi te gjendjes apo parametrave te pacientit mund te arrije ne vlera te vendosura nga anesteziisti deri ne 25 cmH<sub>2</sub>O, por asnjehere mbi 30 cmH<sub>2</sub>O.

Ju veme ne dukje se pervec prodhuesit Maquet, asnje prodhues i pajisjeve te anesteze nuk e ka kete parameter ne vlere maksimale mbi 30 cmH<sub>2</sub>O, pasi mbi kete diapazon ai nuk ka asnje vlere klinike, bashkelidhur disa pjese nga kataloget e prodhuesve te mesiperm te mirenjohur).

**Presioni i inspirimit 0-120 cmH<sub>2</sub>O**

Sipas pretendimit te AK, ky eshte nje parameter qe lidhet ngushte me volumin tidal sidomos gjate modaliteteve te ventilimit me ane te volumit. Parametri i vendosur i presionit te respirimit eshte nje parameter i cili ka te beje me ventilimin ne modalitet PCV (Pressure Control) dhe jo VCV (Volume Control).

Ju veme ne dukje se vete modeli Flow-i i Maquet Getinge, e ka kete diapazon ne lidhje me modalitetet e kontrolluara me ane te Presionit, dhe jo me ane te Volumit sic pretendohet nga AK. Sipas logjikes se AK qe pergjysmimi i ketij parametri perkeqeson qellimin e pajisjes, le te kuptoje qe prodhues prestigjioze te aparateve te anesteze si GE, Draeger, Mindray, Medec Benelux etj, (tek te cilet diapazoni i presionit te inspirimit eshte jo me shume se 5-60 cmH<sub>2</sub>O), prodhojne pajisje te cilat vene ne rrezik jeten e pacientit, gje e cila eshte jashte cdo arsyetimi teknik apo logjik. (bashkelidhur disa pjese nga kataloget e prodhuesve te mesiperm te mirenjohur).

Valvola e emergjences APL deri ne 80cmH<sub>2</sub>O, gjithashtu eshte kerkuar ne nje diapazon i cili nuk ka asnje rendesi klinike pasi gjate ventilimit manual, apo ventilimit automatik, presioni maksimal ne rruget e frymemarrjes nuk kalon 40-50 cmH<sub>2</sub>O.

Shume prodhues e kane kete parameter deri ne 60 cmH<sub>2</sub>O, dhe vlera 80cmH<sub>2</sub>O e plotesuar vetem nga modeli i Maquet eshte nje kriter kufizues.

Mbushja e vaporizatorit 4ml/s eshte gjithashtu karakteristike e vaporizatoreve elektronike qe ka aparati Flow-i i prodhuesit Maquet (Getinge).

Perderisa kerkesa nuk eshte per vaporizatore elektronike, ata mund te mbushen manualisht.

Rrjedhimisht kerkesa e mbushjes se tyre me nje shpejtesi te caktuar nuk qendron.

Per kete arsye kerkojme qe ky specifikim TE HIQET.

Gjithashtu teknologjia me reflektor volumi eshte nje patente e kompanise Getinge ku ne vete katalogun e saj citohet: "Our patented Volume Reflector is a smart rebreathing system".

AK e ka pranuar kete pretendim, duke shtuar frazen "ose ekuivalent", por nderkohe kjo lloj teknologjie sic eshte reflektori i volumit ne pajisjen e Maquet, nuk ka nje teknologji ekuivalente persa i perket pajisjeve te anestezise, rrjedhimisht asnje prodhues nuk mund te ofroje te njevlershmen e saj.

**Per kete arsye kerkojme qe ky specifikim TE HIQET.**

Kujtojme se specifikimet e mesiperme jane pranuar te ndryshohen ne proceduren e AK S.U. "Shefqet Ndroqi" (pasqyruar ne vendimin e KPP 165/2020) ku eshte kerkuar e njejta pajisje, pasi ato jane karakteristike vetem e modelit Flow-i.

**Duke qene ne kundërshtim te hapur me Nenin 23, pika 5 e Ligjit te Prokurimit Publik kerkojme qe te kryhen modifikimet si me poshte, ne diapazone dhe ne vlera logjike per sa i perket performances**

dhe qellimit funksional te pajisjes:

**Sistem me 3 gaze mjekesore: O<sub>2</sub>, N<sub>2</sub>O dhe Ajer**

**Aparati duhet te suportojte hyrjet Ajer/O<sub>2</sub> dhe N<sub>2</sub>O 280–600 kPa dhe te suportojte standardet AGA DISS NIST, etj**

**PEEP: 0–30 cmH<sub>2</sub>O**

**Presioni i Inspirimit: 5-60 cmH<sub>2</sub>O**

**Valvola te emergjences APL frymemarrje e rastesishme deri ne 60 cmH<sub>2</sub>O dhe per oksigjenin O<sub>2</sub> te pakten 0–10 Vmin**

3. Ne shtojcen 10, Specifikime Teknike Lot 1 - F.V pajisje Mjekesore për Maternitetin e Beratit lidhje me artikullin Nr. 4 Llambe Mobile,

-Lartesi e rregullueshme afersisht 70 - 160cm

Ne menyre qe te krijohet mundesia e ofrimit te produkteve alternative te njevlershme kerkojme qe ky specifikim te ndryshohet si me poshte, pa percaktuar kufijte minimale dhe maksimale, por duke i dhene rendesi diapazonit te levizjes dhe rregullimit te lartesisë:

Lartesi e rregullueshme ne diapazon levizjeje afersisht 50-70cm

4. Ne shtojcen 10, Specifikime Teknike Lot 1 - F.V pajisje Mjekesore për Maternitetin e Beratit ne lidhje me artikullin Nr. 5 Llambe Ekzaminimi, kerkohen:

-Lartesi e rregullueshme afersisht 70-160cm

Ne menyre qe te krijohet mundesia e ofrimit te produkteve alternative te njevlershme kerkojme qe ky specifikim te ndryshohet si me poshte, pa percaktuar kufijte minimale dhe maksimale, por duke i dhene rendesi diapazonit te levizjes dhe rregullimit te lartesisë:

Lartesi e rregullueshme ne diapazon levizjeje afersisht 50-70cm

5. Ne shtojcen 10, Specifikime Teknike Lot 1 - F.V pajisje Mjekesore për Maternitetin e Beratit ne lidhje me artikullin Nr. 10 AED external me monitor, kerkohen:

-Nr. i gjurmimit 6 forme valesh

-Shkalla e paraqitjes se ritmit te zemres: 15 ne 220 bpm

Se pari, ju veme ne dukje se specifikimet per kete artikull jane hartuar duke u marre copy-paste nga modeli i defibrilatorit Cardiolife TEC-8300 i prodhuesit Nihon Kohden (katalogu bashkelidhur), duke kufizuar konkurrencen e hapur dhe duke bere te pamundur ofertimin e produkteve alternative, ne kundërshtim te plote me LPP dhe VKM.

Per me teper hartimi i specifikimeve nuk eshte ndertuar ne baze te parametrave qe kane vertet rendesi klinike per jeten e pacientit, por ne kërkesa te cilat nuk kane lidhje te drejtperdrejte me funksionalitetin dhe performancen e pajisjes.

Nr. i gjurmimit 6 forme valesh

Ju veme ne dukje se ky kriter plotesohet vetem nga modeli i siperpermendur per sa i perket nje pajisjeje sic eshte Defibrilatori. Ne kete pike AK nuk po kerkon nje monitor pacienti, ne te cilin eshte e nevojshme te shfaqen ne menyre te njekohshme nje numer i madh formash valore.

Parametrat me te rendesishem dhe jetike qe mund te shfaqen ne forme grafiku (forme valore) dhe per kohe reale ne nje pajisje urgjence si defibrilatori, jane ECG dhe SpO2, dhe me kërkesen ne DST per monitorim te 3 lidhjeve ECG, 4 forma valore jane mese te mjaftueshme per keto parametra.

Shkalla e paraqitjes se ritmit te zemres: 15 ne 220 bpm

Sugjerojme qe ky specifikim te kerkohet ne nje diapazon me te gjere, pa cenuar funksionalitetin e pajisjes.

Kujtojme se specifikimet e mesiperme jane pranuar te ndryshohen ne proceduren e AK S.U. "Shefqet Ndroqi" (pasqyruar ne vendimin e KPP 165/2020) ku eshte kerkuar e njejta pajisje, pasi ato jane karakteristike vetem e modelit Cardiolife TEC-8300.

Ne menyre qe te mos favorizohet vetem nje operator i caktuar, per te mundesuar nje gare te hapur e korrekte dhe ne menyre qe te krijohet mundesia e ofrimit te produkteve alternative te njevlershme ose me te avancuara kerkojme qe keto specifikime te modifikohen si me poshte:

Nr. i gjurmimit 4 forme valesh

Shkalla e paraqitjes se ritmit te zemres: 20 ne 250 bpm

6. Ne shtojcen 10, Specifikime Teknike Lot 1 - F.V pajisje Mjekesore për Maternitetin e Beratit ne lidhje me artikullin Nr. 16 Shiringe Infuzioni elektrike, kerkohen:

**-Saktesia +1% me nje minimum shiringash 100**

**-Te operoje ne presion 250-900 mmHg ne hapa 50 mm Hg ose ne hapa 25 mmHg per presion 50-250**

**mmHg**

Se pari, ju veme ne dukje se specifikimet per kete artikull jane hartuar duke u marre copy-paste nga modeli Agilia SP i prodhuesit Fresenius KABI (katalogu bashkelidhur), duke kufizuar konkurrencen e hapur dhe duke bere te pamundur ofertimin e produkteve alternative, ne kundërshtim te plote me LPP dhe VKM. Saktesia 31% me nje minimum shiringash 100 eshte nje karakteristike e plotesuar vetem nga prodhuesi i siperpermendur. Shume prodhues te mirenjohur te shiringave elektrike si Carefusion, BD, B-Braun,

Smiths Medical, Sinohero, Mindray etj, e kane kete sakesi jo me shume se 2%. Diferenca me 1% nuk sjell asnje perfitim klinik, por eshte thjesht nje kriter kufizues i modelit Agilia SP.

Gjithashtu hapi i parametrimit te presionit 25mmHg apo 50mmHg, eshte perseri karakteristike e vetem ketij prodhuesi. I rendesishem eshte diapazoni i operimit te presionit, ashtu sic eshte pranuar edhe nga AK, ndersa nivelet e hapave jane variabel sipas modeleve dhe prodhuesve te ndryshem. Per kete arsye, ne menyre qe te mos favorizohet vetem nje operator i caktuar, per te mundesuar nje gare te hapur e korrekte dhe ne menyre qe te krijohet mundesia e ofrimit te produkteve alternative te njevlershme ose me te avancuara kerkojme qe keto specifikime te paraqiten me diapazon me te gjere **dhe te ndryshohen ne:**

**Sakesia jo me pak se +2% me nje minimum shiringash 50**

**Te operoje ne presion 80-900 mmHg ne 10-11 nivele, ose ne hapa 50-80 mmHg**

7. Ne shtojcen 10, Specifikime Teknike Lot 1 - F.V pajisje Mjekesore për Maternitetin e Beratit ne lidhje me artikullin Nr. 18 Pompe infuzioni, kerkohen:

-Koha e infuzionit: 15-165 ore e 59 minuta

-KVO e rregullueshme 1 – 20.0 ml/ore

Ju veme perseri ne dukje se specifikimet per kete artikull jane hartuar duke u marre copy-paste nga modeli Agilia VP MC, gjithashtu i prodhuesit Fresenius KABI (katalogu bashkelidhur), duke kufizuar konkurrencen e hapur dhe duke bere te pamundur ofertimin e produkteve alternative, ne kundërshtim te plote me LPP dhe VKM.

Per me teper hartimi i specifikimeve nuk eshte ndertuar ne baze te parametrave qe kane vertet rendesi klinike per jeten e pacientit, por ne kerkesa te cilat nuk kane lidhje me funksionalitetin dhe performancen e pajisjes sic eshte koha e infuzionit deri ne 166 ore, apo KVO deri 20ml/ore, parametra te cilet i ploteson vetem modeli i siperpermendur i prodhuesit Fresenius Kabi.

Per parametrin e KVO, AK pretendon qe zvogelimi i tij do te veshtiresonte punen e stafit duke rritur mundesine per te patur bllokime gjate infuzionit, nderkohe qe te njejtin parameter ne artikullin Shiringe Infuzioni elektrike e ka kerkuar ne diapazon 0.1-5.0ml/h. Ky parameter i cili ben te mundur mbajtjen hapur te venes, ka te njejtin funksion tek te dy llojet e pajisjeve dhe shume prodhues prestigjioze si Carefusion, BD, B-Braun, Mindray etj, e disponojne ate ne vlera jo me shume se 5ml/h.

Ne menyre qe te mos favorizohet vetem **nje operator i caktuar, per te mundesuar nje gare te hapur e korrekte dhe ne menyre qe te krijohet mundesia e ofrimit te produkteve alternative te njevlershme ose me te avancuara kerkojme qe keto specifikime te jene me gjithëperfshirese dhe te ndryshohen ne: Koha e infuzionit: 1s-99 ore e 59 minuta**

**KVO e rregullueshme 1 - 5.0 ml/ore**

8. Ne shtojcen 10, Specifikime Teknike Lot 1 - F.V pajisje Mjekesore për Maternitetin e Beratit ne lidhje me artikullin Nr. 20 Pajisje per monitorimin e parametrave vital neonat, kerkohen:

-Ekran i sheshte TFT/LCD/LED me prekje min 12 inch me mundesi afishimi te pakten 15 te formave te vales

- Monitori duhet te kete mundesine e bllokimit te komandimit me prekje dhe te ofroje mundesi kontrolli ndermjet butonave fizik
- Interval ulet 0 deri 148
- Alarmi Apnea : Fikur, 5 deri 40 s ne 5 hapa
- Tipi i matjes: sistolik, Interval dhe mesatar: Sistolik: 40 deri 280 mmHg; Diastolik: 10 to 235 mmHg; (MAP): 10 deri 280 mmHg,
- Neonate: Sistolik: 30 deri 140 mmHg, Diastolic: 10 deri 110 mmHg; (MAP): 10 deri 140 mmHg
- Pediatrik: Systolic 40 deri 280 mmHg, Diastolic: 10 deri 235 mmHg, MAP: 10 deri 280 mmHg

Se pari, ju veme ne dukje se specifikimet per kete artikull jane hartuar sipas modelit Life Scope VS Series 3763, i prodhuesit Nihon Kohden, duke kufizuar konkurrencen e hapur dhe duke bere te pamundur ofertimin e produkteve alternative, ne kundërshtim te plote me LPP dhe VKM.

Per me teper hartimi i specifikimeve nuk eshte ndertuar ne baze te parametrave qe kane vertet rendesi klinike per jeten e pacientit, por ne kërkesa dhe numra fikse te cilet i takojne modelit te siperpermendur. Keto specifikime nuk jane mbeshtetur ne asnje pervoje te meparshme, sic jane procedura prokurimi te ngjashme te organizuara nga Ministria e Shendetesise apo Banka Boterore, por jane percaktuar te tilla duke kerkuar pajisje qe per me teper nuk jane instaluar ne asnje nga klinikat universitare apo ne departamentet e kardiokirurgjise/hemodinamikes.

Ne nje kohe qe kerkohet standardizimi dhe njehsimi i pajisjeve te instaluara ne spitalet rajonale, menyra e hartimit te ketyre specifikimeve, duke mos u mbeshtetur ne asnje pervoje te meparshme, bie ndesh me keto standarde.

Ju veme ne dukje pikat si me poshte:

Per nje monitor te kerkuar me madhesi ekrani 12 inc, nuk eshte i nevojshem pasqyrimi i formave valore deri ne 15. Kjo eshte nje vlere kufizuese dhe i perket vetem modelit te siperpermendur. Per me teper per monitorimin e parametrave vitale pediatrike apo neonat, 8 forma valore jane mese te mjaftueshme per nje ekran te madhesise 12 inc. AK pretendon se kërkesa per monitor minimalisht 12 inc nuk e perjashton mundesine e ofrimit te nje monitori me te madh, por nderkohe theksojme se i vetmi prodhues dhe model i cili ofron 15 forma valore ne nje ekran 12 inc eshte ai i Nihon Kohden, duke krijuar ne kete menyre diskriminim dhe nje gare te pabarabarte ne kosto dhe kërkesa me te gjithe ofertuesit (prodhuesit) e tjere, te cilet duhet te ofrojne nje monitor me ekran me te madh per te arritur numrin e formave valore te kerkuara.

Per kete arsye kerkojme qe format valore te shfaqura ne ekran te kerkohen ne proporcion me madhesine ekranit te ofruar.

Gjithashtu Intervali i ulet i respirimit eshte kerkuar ne nje diapazon te krahasueshem me nivelin e larte, ndaj mendojme se eshte lapsus, ndaj sugjerojme te ndryshohet si me poshte.

Alarmi Apnea : Fikur, 5 deri 40 s ne 5 hapa

Tipi i matjes: sistolik, Interval dhe mesatar: Sistolik: 40 deri 280 mmHg; Diastolik: 10 to 235 mmHg;

(MAP): 10 deri 280 mmHg;

Neonate: Sistolik: 30 deri 140 mmHg; Diastolic: 10 deri 110 mmHg; (MAP): 10 deri 140 mmHg

Pediatrik: Systolic 40 deri 280 mmHg, Diastolic: 10 deri 235 mmHg, MAP: 10 deri 280 mmHg



Duke qene se intervalet e ketyre parametrave plotesohen vetem nga modeli i siperpermendur i monitorit te Nihon Kohden, kerkojme qe ato te modifikohen si me poshte, per te qene ne nje diapazon me gjithetheperfshires, pa cenuar funksionalitetin dhe rendesine klinike te pajisjes, pasi keto diferenca te vogla minimale sherbejne vetem per kufizim gare dhe nuk ndikojne aspak ne performancen e pajisjes.

Gjithashtu "kontrolli me butona fizike" eshte nje nderfaqe e cila perdoret me se shumti ne rastet kur pajisja nuk disponon nje nderfaqe tjeter ekuivalente per operatorin.

Pajisjet e teknologjise se fundit (vit prodhimi 2019-2021) kane tashme si nderfaqe kryesore vete ekranin e tyre i cili eshte me funksion "touch screen" (me prekje). Ne kete ekran paraqiten te gjitha parametrat monitorues apo kontrollues/komandues nepermjet te cileve operatori navigon ne menu-ne e pajisjes duke kontrolluar apo konfiguruar cdo parameter apo funksion te saj.

Vete AK e ka pranuar ndryshimin e pikes se ngjashme ne artikullin Makine Anestezie te kesaj procedure, pasi ai nuk e cenon pajisjen nga ana funksionale. Menyra e ndryshme e arsyetimit per artikullin ne fjale tregon nje anshmeri ne gjykim dhe tendence ne kufizimin e gares.

Ne baze te Nenit 23, pika 3 (b) ku specifikimet teknike duhet t'iu referohen kerkesave ne terma funksionale, kur nje gje e tille kerkon t'u referohesh standardeve kombetare ose nderkombetare, si menyre qe nenkupton pajtueshmeri me kerkesat funksionale, del qarte se, nese pajisja kontrollohet totalisht nepermjet ekranit me prekje, i cili kerkohet ne kete procedure, nuk ka nevojte per butona fizike. Kujtojmë se specifikimet e mesiperme jane pranuar te ndryshohen ne proceduren e AK S.U. "Shefqet Ndroqi" (pasqyruar ne vendimin e KPP 165/2020) ku eshte kerkuar e njejta pajisje, pasi ato jane karakteristike vetem e modelit Life Scope VS Series 3763.

Ne menyre qe me perpilimin e specifikimeve te mesiperme te mos favorizohet vetem nje operator i caktuar, per te mundesuar nje gare te hapur e korrekte dhe ne menyre qe te krijohet mundesia e ofrimit te produkteve alternative te njevlershme ose me te avancuara kerkojme qe keto specifikime te ndryshohen si me poshte, ne diapazone dhe ne vlere logjike per sa i perket performances dhe qellimit funksional te pajisjes:

**Ekran i sheshte TFT/LCD/LED me prekje min 12 inch me mundesi afishimi te pakten 8 te formave te vales, ose me teper per ekran mbi 12 inch Monitori duhet te kete mundesine e bllokimit te komandimit me prekje ose te ofroje mundesi kontrolli nepermjet butonave fizike**

**Interval I ulet 0 deri 20**

**Alarmi Apnea : Fikur, 10 deri 40 s ne 5 hapa**

**Tipi i matjes: sistolik, Interval dhe mesatar: Sistolik: 40 deri 280 mmHg; Diastolik: 10 to 235 mmHg; (MAP): 15 deri 260 mmHg;**

**Neonate: Sistolik: 30 deri 140 mmHg; Diastolic: 10 deri 110 mmHg; (MAP): 15 deri 125 mmHg**

**Pediatric: Systolic 40 deri 240 mmHg, Diastolic: 10 deri 200 mmHg, MAP: 15 deri 215 mmHg**

9. Ne shtojcen 10, Specifikime Teknike Lot 1 - F.V pajisje Mjekesore për Maternitetin e Beratit ne lidhje me artikullin Nr. 21 Radiante, kerkohet:

-Ne modalitet Manual Intensiteti i energjise ngrohese duhet te rregullohet manualisht nga operatori ne te pakten 50 nivele energjie nga 0-100%.

Ju veme ne dukje se parametri i rendesishem ne kete kerkese eshte ai i diapazonit te energjise. Niveli i rrezatimit pergjate ketij diapazoni nuk eshte i nevojshem te jete ne vlera fikse (te saktetise 2%) per te mundesuar qeliminimin per te cilin eshte projektuar pajisja. Per kete arsye hapi i ndryshimit me 2% apo me 5% konsiderohet diference minore dhe nuk perben asnje diference nga ana teknike apo ne procesin e trajtimit te foshnjave.

Ne menyre qe te krijohet mundesia e ofrimit te produkteve alternative te njevlershme dhe me diapazon me gjithepershires, kerkojme qe ky specifikim te ndryshohet ne:

**Ne modalitet Manual Intensiteti i energjise ngrohese duhet te rregullohet manualisht nga operatori ne te pakten 20 nivele energjie nga 0-100%.**

**10. Ne shtojcen 10, Specifikime Teknike Lot 1 - F.V pajisje Mjekesore për Maternitetin e Beratit** ne lidhje me artikullin Nr. 22 Aparat fototerapie (llampe fototerapie), kerkohen:

-Te kete te pakten 20 LED dhe fuqia jo me shume se 20W

--Rrezatimi i sistemit LED te kete gjatesi vale 450 nm [uW/cm-/nm) ne fushe 54 - 56cm

-Fusha e rrezatimit ne 440 - 460 nm [uW/cm /nm) te mbuloje lartesine 43 - 45 cm

Se pari, ju veme ne dukje se specifikimet per kete artikull jane hartuar ne baze te modelit BiliblueLight, i prodhuesit Lowenstein Medical (katalogu bashkelidhur), duke favorizuar po te njejtin distributor dhe duke kufizuar konkurrencen e hapur dhe bere te pamundur ofertimin e produkteve alternative, ne kundershtrim te plote me LPP dhe VKM.

Gjithashtu perpilimi i tyre eshte bere ne forme lapsusi, pasi njesia e matjes se rrezatimit nuk shprehet ne centimetra, ashtu sikurse eshte vendosur ne vlerat e mesiperme.

Ne pergjigjen e tij AK ka pranuar kerkesen tone per dy prej pikave te mesiperme, por ndoshta ne forme lapsusi nuk i ka ndryshuar ato respektivisht ne menyre korrekte.

Ne kete menyre kerkojme qe keto specifikime te korrigjohen dhe ndryshohen si me poshte:

Te kete te pakten 20 LED dhe fuqi 20-50 W

Fusha e rrezatimit ne 450 - 470 nm [40 - 100 W/cm<sup>2</sup>/nm]

Si perfundim, theksojme se pergatitja e specifikimeve teknike ne favor te firmave prodhuese Maquet, Nihon Kohden, Fresenius Kabi e Lowenstein, te cilat respektivisht perfaqesohen nga i njejt Operator Ekonomik per tregun shqiptar, ben natyrshem te ngrihet dyshimi i arsyeshem, per ndikim ne hartimin e specifikimeve teknike ne kundershtrim te plote me ligjin dhe rregullat e prokurimit publik. Kerkojme nga ju, te nderhyni me Autoritetin qe ju jep ligji, te behen ndryshimet e kerkuara ne specifikimet teknike te produkteve te permendura.

II.4. Në datën 26.02.2021 nëpërmjet shkresës nr. 740 Prot., datë 24.02.2021 me objekt “Shkresë përcjellëse” është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik, informacioni dhe dokumentacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit.

### III

#### Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi dëgjoj relatorin e ceshtjes, shqyrtoj parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimt e ankimuesit, dhe pasi diksutoj ceshtjen në tërësi,

### **Arsyeton**

III.1 Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Biometric Albania” sh.p.k., të paraqitur pranë KPP-së, në lidhje me hartimin e specifikimeve teknike të produkteve Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se:

III.1.1. Në dokumentat e tenderit, shtojca 10, “Specifikimet Teknike”, autoriteti kontraktor ka përcaktuar kriterin:

#### **Shtojca 10**

[ *Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor* ]

#### **SPECIFIKIMET TEKNIKE**

**Përshkrimi i të dhënave teknike të mallrave objekt prokurimi** të përshkruara sa më saktë dhe në mënyrë të plotë, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.

#### **KUJDES**

Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë marke apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

#### **Lot 1 - F.V pajisje mjekesore për Maternitetin e Beratit ”,**

##### **1-Tavoline Operatore-Obstetrike dhe gjinekologjike**

- Tavoline operatore me të pakten 5 ndarje për nderhyrje të përgjithshme dhe Obstetrike.
- Tavolina të jete e përshtatshme për obstetrik-gjinekologji.
- Pajisja të jete e mbështetur në 4 rrota dhe me mbështetje statike gjatë nderhyrjeve.
- Me material special për radiolucet x-ray
- Tavolina duhet të ketë pozicion fikse për ekzaminimet me pajisjen C-arm.
- Trashësia e dyshekut 80mm
- Materili i konstruktit të jete inoks dhe aliazh alumini.

- Nderrimi i aksesoreve te jete me kapse dhe jo me vida, per nje perdorim te thjeshte nga stafi mjekesor.
- Telekomanda te komunikoje me infra red dhe te kete me butona me ndricim.
- Krevati te mbaje peshe te pakten 300 kg
- Gjatesia e tavolines jo me e vogel se 2100 mm.
- Gjeresia e tavolines jo me e vogel se 500 mm.
- Zgjatje horizontale longitudinale e tavolines per skanime x-ray te pakten 400 mm
- Lartesia e tavolines te pakten 720 - 1100 mm me levizje elektronike.
- Levizjet tredelenburg te pakten 40 grad
- Levizjet anesore majtas-djathtas te pakten 35 grad
- Levizja e pjeses se shpines te pakten -40 grad deri ne te pakten +78grad
- Levizja e pjeses se kembave te pakten 0 – 90 grad dhe e zmontueshme kur nevojitet
- Pllaken e zgjatjes, mbeshtetesen e kokes, çift per kembet, mbeshtetesen per krahun, mbeshtetesen laterale, lidhjet per trupin, ekrani per anestezine. Telekomanden e komandimit per levizjet e krevatit.

## **2-Makine Anestezie (Set)**

- Makine anestezie e pershtatshme per ventilim Neonatal/Pediatric dhe Adult.
- Sistem me 3 gaze mjekesore: O<sub>2</sub>, N<sub>2</sub>O dhe Ajer me auto-kalibrim.
- Aparati duhet te suportoje hyrjet Ajer/O<sub>2</sub> dhe N<sub>2</sub>O 250–650 kPa dhe te suportoje standardet AGA DISS NIST, etj.
- Pajisja duhet te jete me sistem te integruar dhe me indikator ne kohe reale per pastrimin e gazrave.
- Sistemi i pastrimit duhet te kete nje fuqi pastruese minimum 25 l/min.
- Ekran me prekje LED dhe me knob.
- Dimentioni minimal: 15", me ngjyra.
- Shfaqje ne kohe reale te grafike ne ekran dhe te formave te vales mbi 6 forma valesh dhe mundesi konfigurimi nga perdoruesi.
- Trendet: te dhena grafike, 1 deri 24 ore/ndarje
- Te dhena numerike, 1 deri 60 minuta/ndarje
- E pajisur me nje tavoline pune me sipërfaqe afersisht 380 mm x 240 mm
- Me llambe te integruar LED ne krahun e ekranit
- Te jene te montuar te pakten 2 sirtare
- Te kete sistem kontrolli per te parandaluar Hipoksine duke treguar nivelin e O<sub>2</sub> per te ndreprete procesin.
- Ventilim: Manual/Bag, AFGO, VC, PC, PS, PRVC, SIMV
- Karakteristikat e Ventilimit:
- Fluksi i gazit: 1-120 Litra/min
- Volumi Tidal: 20 – 2000 ml, me hap nga 1 deri 10 ml
- Volumi ne minute per te rritur: 0.5–60 l/min
- Frekuenca e Respirimit: 4–100 ±1 frymemarrje/minute

- Raporti I:E (VC, PC): 1:10 – 4:1
- PEEP: 0–50 cmH<sub>2</sub>O
- Presioni i Inspirimit: 0–120 cmH<sub>2</sub>O
- Fuqia Inspirimit: 200 l/min afersisht
- Karakteristikat e sistemit të frymemarrjes:
- Aparati duhet të përdorë sistem qarkullimi me reflektor volumi
- Sistemi duhet të sigurojë një volum maksimal jo më pak se 3000ml
- Sistemi duhet të sigurojë një maksimum humbjeje në metoden manuale jo më shumë se 3.5 ml/cmH<sub>2</sub>O
- Valvola të emergjencës APL frymemarrje e rastesishme deri në 80 cmH<sub>2</sub>O dhe për oksigjenin O<sub>2</sub> të pakten 0–10 l/min
- Alarmi për presionin e lartë: 10–120 cmH<sub>2</sub>O
- Volumi i respirimit për minutë: i lartë 0.5–60 l/min dhe i ulët 0.01–40 l/min afersisht
- Alarm APNEA: 5 – 45s dhe kur është i fikur. Alarmi për APNEA kur nuk ka frymemarrje për 120s
- Koncentrimin e inspirimit dhe të espirimit të Oksigjenit, CO<sub>2</sub> dhe agjentit anesteziq
- Kontroll në kohë reale i qarkut të frymemarrjes, prani të ventilatorit alternativ me reflektor volumi
- Detektim dhe Alarm për humbje të gazit në qarkun e pacientit.
- Rimbushja e agjenteve anesteziq të kryhet në kohë reale kur pacienti është i lidhur me pajisjen.
- Alarme për detektimin e bllokimeve në lidhjen e miksimin të gazrave
- Mundësi gjurmimi të përdorimit të agjentit anesteziq për të pakten 20 pacientet e fundit.
- Koha e mbushjes së vaporizatorit afersisht 4 ml/s
- Furnizimi me energji: Rrjeti 100–120V, 220–240V, AC 50–60Hz
- Bateria e rikarikueshme për kohën e operimit pa rrymë elektrike të pakten 90 minuta

#### **4-Llambe Mobile**

- Llambe për procedurë ekzaminimi mjekësor dhe kirurgji minore.
- Llambe ekzaminimi LED .
- Me fokus elektronik
- Tub i levizshëm mbi baze të levizshme me rrota
- Lartësi e rregullueshme afersisht 70 - 160cm
- Llambe me hijezim të reduktuar dhe ndricim eksponencial
- Diametri i fushës së dritës së përqendruar të pakten 30 cm
- Temperatura e ngjyres të kontrolluara elektronikisht të pakten nga 3700K deri 4700K
- Intensiteti të pakten 100,000 lux
- Jetëgjatësia e LED-it jo më pak se 55,000 ore
- Diametri i satelitit jo më pak se 35 cm

- Me rregullator Intesiteti me buton
- Me rregullator te temperatures se ngjyrave me buton
- Me doreze te sterilizueshme

### **5-Llampe Ekzaminimi**

- Llampe ekzaminimi LED
- Me fokus elektronik
- Tub fleksibel mbi baze te levizshme me rrota
- Lartesi e rregullueshme afersisht 70-160cm
- Diametri i fushes se drites te pakten 20 cm
- Temperatura e ngjyres te kontrolluara elektronikisht te pakten nga 3700K deri 4700K
- Intensiteti te pakten 50,000 lux
- Jetegjatesia e LED-it jo me pak se 55,000 ore

### **10-AED external me monitor**

- Defibrilator Bi-Fazik me Pacer per arrestet kardiake akute dhe kronike
- Menyrat e punes: Manuale, Pacer, AED dhe Monitorim.
- Mundesi Monitorim te formave valore: ECG 3/5 lead, SpO2, NIBP, IBP, etj.
- Te kete te instaluar funksionet per SpO2, NiBP, Temperature, CO2 dhe IBP.
- Me karikues dhe bateri dhe tregues digjital ne ekran te gjendjes se baterise.
- Pajisja me madhesi ekrani jo me te vogel se 8.2 inch
- Tipi i ekranit ST-NLT ngjyrim TFT
- Nr. i gjurmimit 6 forme valesh
- Diapazoni i energjise: min 2- 270 J
- ECG Lidhje Kabell me 3, 6 dhe 10 elektroda
- Numri i kanaleve te EKG: 2 (maksimum, me 6 ose 10 elektroda te shfaqura ne ekran), 12 (maksimum, me 10 elektroda ose dritare me 12 drejtime)
- Shkalla e numërimit të rrahjeve te zemrës Defribilim ose modeli i monitorimit: 15 deri ne 300 bpm
- Shkalla e paraqitjes se ritmit te zemres: 15 ne 220 bpm
- Diapazon i paraqitjes 0 deri ne 100%SpO2
- Saktesia e Matjeve  $80\%SpO_2 \leq \%SpO_2 \leq 100\%SpO_2: \pm 2\%SpO_2$   $70\%SpO_2 \leq \%SpO_2 < 80\%SpO_2: \pm 3\%SpO_2$
- Diapazon i llogaritjes se shkalles se frymemarrjes: 3 deri ne 150 llogaritje/min  $\pm 10\%$  dhe koha e përgjigjes brenda 3 s.
- Termat e shfaqur Sistolike (SYS), diastolike (DIA), mesatarja (MAP)
- Invasive blood pressure (IBP) Diapazon i matjeve -50 deri ne +300 mmHg
- Diapazon i matjes se temperatures: 0 deri ne 45°C
- Saktesia e matjes se temperatures se pacientit  $\pm 0.1^\circ C$
- Forma e vales ne dalje Bifazike, me shperndarje eksponenciale konstante te copezuar

- Koha e ngarkimit ne metoden mauale ne kapacitet 270 J, jo me shume se 5 s
- Koha e ngarkimit ne metoden AED ne kapacitet 270 J, jo me shume se 15 s
- Shkarkimi i sinkronizuar i perfshire.
- Ritmet e shmangies në sistemin elektrik të përçimit të zemrës.  $VT \geq 75\%$
- Pajisur me printer termal
- Me karte memorie per mundesi regjistrimi.
- Doreze te inkorporuar
- Duhet te kete alarme si dhe sinjale vizuale: Gjendje kritike me sinjal te kuq, gjendje qe duhet pasur kujdes me sinjalizim te verdhe, nevoje konsultimi me ngjyre te kalter.
- Aksesoret: 1x kabell ECG me 3 lead, 1x Set pllakash te riperdorshme adulte dhe pediatrike, 5 x Sete pllakash njeperdorimshe adulte dhe 5 sete pediatrike, 100 x Elektroda ECG njeperdorimshe, 1x kabell dhe Sensor SpO2 Adult, 1x Konektor dhe manshete NIBP Adult dhe pediatrik, 1x Sensor temperature Adult, 20 x rulona leter termike per printer, 1 x shishe xhel.

#### **16- Shiringe Infuzioni elektrike**

- Volumi i infuzionit te pakten nga: 0.1 ne 1200 ml/h me hap 0.1mL/H
- Kapaciteti i shiringes: minimum 10, 20, 30/35, 50/60 cc.
- Administrimi i bolus manualisht ne intervalin 50 ne 1200 ml/h dhe hap 50ml/h
- Saktesia  $\pm 1\%$  me nje minimum shiringash 100.
- Numri eventeve me shume se 1000.
- Te operoje ne presion 250-900 mmHg ne hapa 50 mm Hg ose ne hapa 25 mmHg per presion 50-250 mmHg.
- Shkalla e KVO: e mbyllur ose 0.1-5.0ml/h
- Njesite e dozimit g, mg,  $\mu$ g, ng, U, mmol, etj.
- Te kete te pakten 50 lloje ilacesh te programuar.
- Kapaciteti i shiringave: 5-50/60 ml
- Tipi i Ekranit te jete monokrom min LCD afersisht 63 mm x 28 mm
- Modaliteti i infuzionit duhet te perfshije: nderhyrjen standarde, kalkulimin e dozes, TIVA, TCI
- Furnizimi me energji elektrike: 100-240v, 25 VA, 50-60 Hz.
- Klasa e mbrojtjes ndaj ujit te pakten: IP22.
- Mbrojtje nga defibrilimi Class II CF.
- Ne perputhje me standardet EN / IEC 60601-1 dhe EN / IEC 60601-2-24 / dhe ne perputhje me EEC / 93/42.
- Bateria: Li/Ion, Min. 11h ne 5mL/h dhe 6h at 5mL/h nese perdoret komunikimi wireless.
- Koha e karikimit jo me shume se 6h ne gjendje OFF.

#### **17- Aparat ECHO Obsetrikale 2D, 3D, 4D**

- Eko dopler me ngjyra per Obstetri dhe Gjinekologji

- Model i levizshem me rrota me mbeshtetje ne dysHEME.
- I kontrolluar me mikroprocesor, teknologji dixhitale dhe kanale dixhitale
- Paketa llogaritjesh per testime Gjinekologjike, Obstetrike, Abdominale, Urologjike, Pjese te vogla, Vaskulare, Pediatrike
- Te mundesoje egzaminime Elastografie per qafen e mitres dhe gjirin.
- Te kete te pakten 3 porta per sonda aktive.
- Menytrat e operimit: 2D, 3D, 4D, te perfshira dhe instaluara ne aparat ne menyre permanente.
- Monitori i imazhit i sheshte (LCD/LED), me ngjyra.
- Madhesia e ekranit mbi 21", me rezolucion te larte HD.
- Paneli i kontrollit me lartesi te rregullueshme, i pajisur me ekran (LCD/LED) me prekje, per komandim/kontroll funksional dhe vizualizim imazhi ekografik ne ekran. Madhesia minimale: 13" me rezolucion te larte HD.
- Monitori i rrotullueshem, me lartesi dhe kend te ndryshueshem.
- Intervali Dinamik maksimal mbi 240 dB
- Thellesia e skanimit te pakten deri ne 40 cm
- Intervali i frekuencave te funksionimit 2.5 deri ne 16MHz
- Perfshin funksione cine me memorizim te shume cikleve.
- Shpejtesia maksimale e nderrimit te imazhit mbi 1200 frames/sec
- Perfshin menytrat e shfaqjes se imazhit: B-Mode, M-Mode, Color M Mode, Color Doppler Mode, Power Doppler (PD), 3D, 4D, Beam Steering, Harmonic Imaging, TDI.
- Te kete mundesi per shtese te elastografise

#### Perfshin Sondat:

Sonde Volumetrike Endovaginale multifrekuence me bande te gjere afersisht 3 – 12.5 MHz

Fushepamja deri ne 195 grade

Numri i elementeve: minimum 191

Thellesia e skanimit 1.5 deri ne 28 cm

Sonde Lineare multifrekuence me bande te gjere afersisht 4 - 13.5 MHz.

Fushepamja deri ne 3.5 cm

Numri i elementeve: minimum 128

Thellesia e skanimit 1.5 deri ne 28 cm

- Te kete memorie te brendshme HDD jo me te vogel se 850 GB
- CD/DVD-RW te inkorporuar
- Te kete te pakten 3 porta USB 2.0.
- DICOM 3.0 me license aktive te perhershme
- Porte network (Ethernet)
- Porte per Video Out dixhitale
- Video Printer Bardh e Zi



## 18-Pompe infuzioni

- Portabel. Sistem baze me mikroprocesor
- Ushqimi; AC- 220V, 50Hz dhe bateri.
- Monitor dixhital per tregimin e vlerave.
- Infuzion KVO (per mbajtjen hapur te venes)
- Sistemi i infuzionit: PERISTALTIK
- Presioni i infuzionit i rregullueshem
- Memorizim i te dhenave ne rast nderprerjeje te energjise
- Ndryshim i parametrave te infuzionit pa nderprere proceduren e infuzimit
- Bateri e integruar e rikarikueshme. Karikohet automatikisht gjate punes.
- Kalim automatik ne regjim baterie ne rast nderprerjeje te energjise
- Kohezgjatja e baterise ne regjim pune; te pakten ne 8 ore.
- Karakteristikat
- Fluksi : 0.1-1500 ml/ore
- Vellimi i infuzuar : 0.1-9999 ml me rritje prej 0.1 ml-1ml
- Koha e infuzionit: 1 s – 165 ore e 59 minuta
- Shpejtesia e bolusit: I rregullueshen deri ne 1500 ml/ore
- Saktesia:  $\pm 5\%$
- KVO e rregullueshme 1 – 20.0 ml/ore
- Pajisur me modalitet kontrolli te ndryshueshem gradual ose te paracaktuar ne 3 nivele
- Pajisur me sistem dinamik per te sinjalizuar ndryshimin e presionit
- Alarme vizive dhe akustike per raste te ndryshme: Rastet: bateri e ulet, afrimi i mbarimit te infuzionit, rritje e presionit, fund infuzioni, fluks i ulet, bllokim i linjes, keqfunksionim i brendshem, ajer ne sistem, kapak i hapur.
- Te mundesoje integrimin e librarise se ilaceve te ndryshme
- Numri i eventeve te pakten 1500
- 15-Karrel Instrumentash kirurgjikale
- Manovrueshmeri e madhe: 4 rrota me frena dhe qe nuk krijojne zhurme
- Rezistence e larte
- Celik Inoksidabel (qoshe të rrumbullakosura) ose tabaka të sheshtë të izoluar me tuba inoksi
- Celik te paoksidueshem
- 16-Shiringe Elektrike
- Volumi i infuzionit te pakten nga: 0.1 ne 1200 ml/h me hap 0.1mL/H
- Kapaciteti i shiringes: minimum 10, 20, 30/35, 50/60 cc.
- Administrimi i bolus manualisht ne intervalin 50 ne 1200 ml/h dhe hap 50ml/h
- Saktesia  $\pm 1\%$  me nje minimum shiringash 100.
- Numri eventeve me shume se 1000.
- Te operoje ne presion 250-900 mmHg ne hapa 50 mm Hg ose ne hapa 25 mmHg per presion 50-250 mmHg.

- Shkalla e KVO: e mbyllur ose 0.1-5.0ml/h
- Njesite e dozimit g, mg, µg, ng, U, mmol, etj.
- Te kete te pakten 50 lloje ilacesh te programuar.
- Kapaciteti i shiringave: 5-50/60 ml
- Tipi i Ekranit te jete monokrom min LCD afersisht 63 mm x 28 mm
- Modaliteti i infuzionit duhet te perfshije: nderhyrjen standarde, kalkulimin e dozesh, TIVA, TCI
- Furnizimi me energji elektrike: 100-240v, 25 VA, 50-60 Hz.
- Klasa e mbrojtjes ndaj ujit te pakten: IP22.
- Mbrojtje nga defibrilimi Class II CF.
- Ne perputhje me standardet EN / IEC 60601-1 dhe EN / IEC 60601-2-24 / dhe ne perputhje me EEC / 93/42.
- Bateria: Li/Ion, Min. 11h ne 5mL/h dhe 6h at 5mL/h nese perdoret komunikimi wireless.
- Koha e karikimit jo me shume se 6h ne gjendje OFF.

## **20- Pajisje per monitorimin e parametrave vital Adult**

- Sistem Modular Monitor Pacienti per mundesine e realizimit te matjeve te parametrave vitale:
- ECG (3/6/10 lead), HR, SpO2, NIBP, IBP, Temperatures (2 kanale), Parametrat Hemodinamike, CO, CO2 ne metoden mainstream dhe sidestream, Flow/Paw, BIS, Gazrave anestesizik(CO2, O2, N2O) si dhe parametrat NMT, Ventilimon, CCO dhe EEG.
- Monitori duhet te jete i pershtatshem per kategorite e perfshira: femije, neonatal:
- Ekran i sheshte TFT/LCD/LED me prekje min 12 inch me mundesi afishimi te pakten 15 te formave te vales. Te kete alarm visual me 3 nivele ngjyrash te ndryshme sipas rendesise.
- Monitori duhet te kete mundesine e bllokimit te komandimit me prekje dhe te ofroje mundesine e kontrollit ndermjet butonave fizik. Regjistrim i te dhenave grafike dhe parametrave te pakten 72 ore.
- Mbrojtje nga defibrilimi dhe hyrjeve sipas standardeve IEC 60601-2-27 17.101

### **ECG:**

- ECG (3/6/10 lidhje),
- Diapazoni min 15-300 bpm. Saktesia jo me shume se  $\pm 2$  bpm.
- Mbrojtje dhe sinkronizim me defibrilatorin.
- Zbulim te segmentit –ST. Me algoritem per aritmi dhe pacemaker.
- Alarme vizuale dhe zanore.

### **SPO2**

- Te pershtatet me standardet ISO 9919: 2005, ISO 80601-2-61:2011
- Diapazoni 1-100%
- Diapazoni i Pluse 20-300 bpm
- Saktesia  $\pm 3\%$

- Drita e sensorit minimumi 0.13mW
- Me dy forma vale min 660/940 nm

#### Respirimi:

- Metoda: matje e impedences elektrike
- Diapazon: 30-200 bpm (te rritur); 4-120bpm (porsalindur/femije)
- Saktesia :  $\pm 5$ rpm. Alarme per rrezen e matjes.
- Hapat e matjes: 0, 4 deri 60 hapa/min
- Saktesia e matjes:  $\pm 1$  numerim/min
- Interval I larte: 2 deri 150
- Interval ulet 0 deri 148
- Alarmi Apnea : Fikur, 5 deri 40 s ne 5 hapa

#### NIBP(Presioni i gjakut jo Invaziv)

- Metoda: Oshilometri Automatike
- Menytrat: Interv/automatike/vazhdueshme. Per Neonate, Pediatrik dhe Adult
- Diapazoni: min 10-280mmHg.
- Tipi i matjes: sistolik, Interval dhe mesatar: Sistolik: 40 deri 280 mmHg; Diastolik: 10 to 235 mmHg; (MAP): 10 deri 280 mmHg;
- Neonate: Sistolik: 30 deri 140 mmHg; Diastolic: 10 deri 110 mmHg; (MAP): 10 deri 140 mmHg
- Pediatrik: Systolic 40 deri 280 mmHg, Diastolic: 10 deri 235 mmHg, MAP: 10 deri 280 mmHg
- Saktesia te jete sipas standardeve ISO 81060-2 (perkatesisht  $\leq \pm 5$  mmHg dhe  $\leq \pm 8$  mmHg)

#### Temperatura:

- 2 kanale, 1 sonde per matjen e temperatures ne diapazonin: 0-45°C.
- Rezolucion: 0.1°C. Saktesia:  $\pm 1^\circ\text{C}$ .
- Pajisur me alarm per temperaturat jashte diapazonit te matjes.
- IBP (Presioni i gjakut invaziv)
- Mundesi matjeje me 2- kanale
- Interval i matjes: -40÷300 mmHg. Saktesia e matjes:  $\pm 5\%$ .
- Alarme: arrhythmia, apnea, HR, RR, PR, ST, APNEA, TEMP, deltaTEMP, Ppeak, SpO2, NIBP, IBP, ETCO2, CO2, CCO, O2 insp, O2 exp, Tb, MV, VPC, PEEP, N2O Agent, SEF, BIS, CCI, TP, etj.
- Alarmet e Arrhythmia: te pakten 20 aritmi te ndryshme ku te perfshihen BRADYCARDIA, PROLONGED RR, BIGEMINY, ASYSTOLE, EARLY VPC, PACER NON-CAPTURE, NO PACER PULSER, etj

#### Aksesoret e ofruar nga prodhuesi dhe te shoqeruara me CE/DC:

- Konektor per EKG me 3/6/10-lead. Per Pediatrik dhe Neonat, nga 5 set elektrodash me nje perdorim per secilen mase.
- Manshete NIBP Pediatrik nga 5.
- Sensor SpO2 Pediatrik nga 3 secila me shume perdorime me kabell dhe konektor elektrik.

- Sonde lekure temperature Pediatrik nga 2 .
- Bateri e integruar e rikarikueshme per pune normale per te pakten 1.5 ore. Mundesi per te shtuar bateri te dyte.

## **21-Radiante**

- Sistem Ngrohës për neonate
- I pajisur me rezistencë ngrohëse  $0\div 500W$ . Modalitet funksionimi Manual dhe Automatik (servo mode).
- Te ketë ekran të pakten 8 inch për afishimin e temperaturës dhe parametrave të tjerë
- Te afishojë Apgar – timer (kronometer)
- Sistem i pajisur me një portë për sensor temperaturë me vendosje sipërfaqësore (në lekure).
- Te ketë mundësi manuale dhe automatike të kontrollit të temperaturës ose nepermjet sensorit të temp
- Modalitet Funksionimi Manual
- Në modalitet Manual Intensiteti i energjisë ngrohëse duhet të rregullohet manualisht nga operatori në të pakten 50 nivele energjie nga 0-100%.
- Modalitet Funksionimi Automatik
- Në modalitet Automatik (servo), të kontrollohet energjia ngrohëse në mënyrë automatike sipas temperaturës së dëshiruar për pacientin (setpoint) dhe sipas informacionit të marrë nga sensori i temperaturës (feedback).
- Intervali i rregullimit të temperaturës:  $34\div 38^{\circ}C$  me rezolucion  $0.1^{\circ}C$ .
- Te jetë i pajisur me llambe ndricimi për përdoruesin
- Dimensionet e përafërta të platformës së pacientit afërsisht 450 x 650 mm
- Platforma duhet të mundësojë vendosjen e kasetave X-ray duke mos levizur pacientin.
- Platforma e pacientit duhet të mundësojë pozicionim horizontal në këndet  $0^{\circ} \pm 12^{\circ}$ .
- Mundësi rrotullimi të kokës së radiantit  $\pm 90^{\circ}$  për të mundësuar vendosjen e pajisjeve të tjera (njësi portative x-ray, njësi fototerapie, etj.)

## **22-Aparat fototerapie (llambe fototerapie)**

- Te jetë i pajisur me sistem LED dhe intensitet të lartë.
- Te ketë të pakten 20 LED dhe fuqia jo më shumë se 20W
- Sistemi LED të ofrojë jetegjatesi të pakten 35,000 ore pune
- Te ketë sistem për mbrojtjen ndaj personelit mjekësor.
- Rrezatimi i sistemit LED të ketë gjatësi vale 450 nm [ $\mu W/cm^2/nm$ ] në fushë 54 - 56cm
- Fusha e rrezatimit në 440 - 460 nm [ $\mu W/cm^2/nm$ ] të mbulojë lartësinë 43 – 45 cm

## **23-Aparat CPAP**

- Pajisja përbehet nga Njesia CPAP dhe Lageshtues
- Njesia CPAP:
- Pajisje për terapi CPAP për neonate me kontroll dhe monitorim të %O<sub>2</sub> në intervalin: 21-100%
- Përzierës gazesh (Ajer dhe O<sub>2</sub>) i integruar në pajisje.

- Fluksimeter i integruar ne pajisje per flukse nga 1-15 Litra/minute
- Te jete i pajisur me display LCD ku shfaqen parametrat e CPAP.
- Presioni i gazeve ne hyrje te pajisjes: 3.5-6 atm.
- Furnizim nga rrjeti AC 220V/50Hz dhe bateri e integruar per te garantuar funksionim per te pakten afersisht 1 ore.

Lageshtues:

- Lageshtues i pershtatshem per t'u perdorur ne kombinim me njesine CPAP te pershkruar me siper.
- Sistem lageshtimi me dhome uji (chamber).
- Kontrolli i temperatures se gazit ne qarkun e pacientit nepermjet ngrohjes ne intervalin afersisht: 30-40°C
- Monitorim i temperatures se gazit nepermjet sensoreve te vendosur ne qarkun e pacientit.
- Furnizim nga rrjeti AC 220V/50Hz.

Aksesoret: Te perfshihen sensoret e temperatures se lageshtuesit, Te perfshihet nje strukture metalike e levizshme me rrota ku do te montohen njesia CPAP dhe Lageshtuesi. Te perfshihen 5 qarqe pacienti neperdorimsh neonatal me rezistenca te integruara te pershtatshem per t'u perdorur sebashku me njesine CPAP dhe lageshtuesin e mesiperm.

#### **24-Peshore femijesh dixhitale**

- Peshim per femije deri ne 20 Kg
- Ekran LCD per leximin e te dhenave
- Njesia ne Kg ose ne Lb
- Operim i thjeshte me nje buton
- Pjata e vendosjes se femijes me mundesi shkeputjeje
- Funksion auto-off per kursim energjie
- Funksion me bateri
- Shkalle matese gjatesie modulare (vendoset dhe hiqet sipas nevojave )

#### **25-Peshore adulte**

- Ekran elektronik
- Duhet te jete ne konformitet me normat: EN 60601-1, EN 60601-1-2, EN 300 328, EN 301 489-1, EN 301 489-17, 2011/65/EU, 1999/5/EC, 93/42/EEC
- E lehte per transport
- Kapaciteti maksimal 200 kg/450 lbs dhe hap 100 g/ 0.2 lbs
- Dimensionet e peraferta : 294 x 831 x 417 mm / 11.6 x 32.7 x 16.4"
- Dimensionet e platformes: 272 x 75 x 280 mm / 10.7 x 3 x 11"
- Ushqimi Bateri/Adaptor AC/DC
- Funksione: TARE, mbajtje automatike te te dhenave, fikje automatike, BMI
- Ruajte te dhenash ,ndryshim, kalim ne njesi matjeje lbs/kg ,BMI

#### **26-Aspirator Neonat**

- Te jete i pershtatshem per infant
- Te shoqerohet me te pakten 2 koka silikon.

#### **27 - Inkubator Bebe**

- Inkubator spitalor per te sapolindur dhe te lindur prematur.
- Pajisur me sistem kontrolli me mikroprocesor

- Kontrollon dhe monitoron ne menyre automatike gjate gjithë kohes: temperaturën e ajrit dhe të lekures, përqendrimit të oksigjenit dhe të lageshtisë relative.
- I pajisur me panel kontrolli me ekran LED të pakten 9'' me ngjyra, për të vizualizuar parametrat e kontrollit
- Pajisur me peshore të integruar
- Vizualizim i vlerave aktuale dhe vlerave të vendosura të temperaturës së ajrit, temperaturës së lekures, lageshtisë relative dhe përqendrimit të oksigjenit. Vizualizim i trendit grafik të parametrave të kontrollit.
- Alarmi vizual dhe akustik:
- Pajisur me sisteme alarmi vizual dhe akustik për parametrat e matur
- Struktura e përbërë nga të pakten 2 porta hyrëse, 4 porta manipulimi.
- Pajisur me mbajtëse për kaseta x-ray
- Funkcion automatik të kompensimit të temperaturës në momentin kur hapet një nga portat hyrëse të inkubatorit
- Komandim elektronik i kendit të shtratit nga paneli i komandimit, tredelenburg dhe anti-tredelenburg në 12°
- Sistemi duhet të jetë i mbështetur në 4 rrota dy prej të cilave duhet të jenë të pajisura me frenë.
- Kontrolli i temperaturës:
- Ajer, Servo control në diapazonin: 20-37°C me rregullim 0.1°C dhe 37.1- 39.0 °C me rregullim 0.1°C
- Kontroll i temperaturës së lekures: Servo control, diapazoni: 34-37°C me rregullim 0.1°C dhe 37.1- 39.0 °C me rregullim 0.1°C
- Kontroll i lageshtisë: 40-95% në 1% Inkrementim
- Diapazoni tregues për lageshtinë: 10-99%
- Kontroll i Oksigjenit: 22-75%
- Diapazoni tregues për përqendrimit të oksigjenit: 10 % - 100%
- Niveli i Zhurmës brenda inkubatorit me pak se 38 dB
- Të ketë një strukturë për montimin e monitoreve, pajisjeve dhe aksesoreve
- Të jetë i pajisur me një set sensoresh për temperaturën e lekures.
- Të furnizohet sëbashku me konektoret e oksigjenit për neonate dhe bebe premature.

## **28-Blanket fototerapie**

- Paisje për trajtimin fototerapik të të porsalindurit, lehtësisht e transportueshme, teknologji LED e gjeneratorit të dritës me fibra optike.
- Të jetë i pajisur me dyshek me fibra-optike, me mbulës mbështjellëse të butë, me sipërfaqe të emetimit të dritës afërsisht 25x30cm të lidhur me gjeneratorin e dritës me kabell optik .
- Diapazoni i rrezatimit optik brenda diapazonit: 430-490nm.
- Gjeneratori i dritës LED të jetë lehtësisht i montueshem në stativ.
- Ushqimi: AC: 230 V~ 50/60 Hz

## **29-Kaska HOOD**

- Set prej tre kapash oksigjeni me madhësi të ndryshme
- Materiali plastik
- 3 dimensione të ndryshme për të porsalindur, pediatrik dhe adult
- Të jenë të pajisura me konektore për oksigjenin

### **30-Aparat blender ajer/O2**

- I tipit manual me flowmeter
- Te mbaje fluks maksimal te pakten 40 litra/min
- Saktesia: +/- 3%
- Me rregullim manual te FIO2: 0.21 deri ne 1.0

### **31-PUAR**

- Material gome
- Kapaciteti: 200-250 ml
- Te shoqerohet me aplikator

### **32-Nebulizator (aerosol) per neonat**

- Nebulizator Profesional per perdorim spitalor
- Presion Max.: 350 kPa
- Niveli i zhurmës: 60 dBA
- Presion operativ: 0-130 kPa
- Sasia e ajrit të qarkulluar: 15 l/min
- Do shoqerohet me aksesoret e meposhtem:
- Maska e hundës (polypropylene)
- Maska e gojës (polypropylene) me valvul (silikoni);
- Maskë për fëmijë

### **33-Laringoskop adult**

- Me bateri dhe lamat Celik Inoksi modeli Miller 0, 1, 2 dhe te autoklavueshme
- Te jete me doreze metalike me bateri
- Te jete me llamba LED

### **34-Laringoskop neonatal**

- Me bateri dhe lamat Celik Inoksi modeli Miller 0 dhe te autoklavueshme
- Te jete me doreze metalike me bateri
- Te jete me llamba LED

### **35-Bilirubinometer Transkutan**

- Per matje transkutane te bilirubines pa cpim (jo invazive)
- Te jete i pershratshem per te matur ne te gjitha llojet e lekurave
- Diapazoni i matjes afersisht 0-20 mg/dl
- Sistemi te afishoj ne ekran vlerat e matjes ne kohe reale
- Sistemi te kete mundesi te perdoret ne paciente menjehere pas lindjes
- Sistemi te funksionoj me bateri me kohe te gjate
- Sistemi te funksionoj pa kerkuar materiale konsumi per matje
- Perdorim i lehte dhe matje e shpejte

### **36-Shtrat Reanimacioni**

- Lartesi e rregullueshme ne menyre elektrike afersisht 50-80cm
- Seksionet e shpines te rregullueshme ne menyre elektrike ne kendet 0°-60°
- Seksioni i kembeve i rregullueshem ne menyre elektrike kendet 0°- 20°
- Komandim elektrik tredelenburg dhe i kundert tredelenburg ne kendet 0°-15°
- Gjatesia e perafert: 220 cm

- Gjerësia e perafert: 100 cm
- Rrota me frena dhe diameter minimal 15cm
- Mbrojtëse anësore dhe Mbrojtëse ndaj goditjeve për pjesën balllore dhe fundore
- Platforme e dyshekut me material ABS me dimensione të përafërta 190x85cm
- Të përfshihet dyshek me dimensione të përshtatshme
- Kapaciteti maksimal ngarkesës: 200 kg
- Struktura metali e lyer me bojë elektrostatiqe
- Shufër IV, Bateri për back-up e karikueshme
- Buton me funksion kyçjeje
- Panele kontrolli për pacientin dhe stafin mjekësor
- Furnizimi me energji VAC 220-240/50Hz

### **37-Shtrat Bebi**

- Të jetë me material plastik, antibakterial, transparent dhe portable.
- Levizjet Trendelenburg dhe reverse trendelenburg të pakten -14 deri +14 grade
- Struktura mbajtëse të jetë konstruktion çeliku anti korrozioneve
- Të jetë i pajisur me rrota, 2 prej të cilave me frena
- Gjatesia afërsisht 85 cm
- Me dyshek për bebe dhe me veshje rezistente ndaj lëngjeve

### **38-Shtrat Pacienti**

- Kapacitet mbajtës deri në 180 kg
- Platforma e dyshekut me 2 seksione:
- Pjesa e kokës ka aftësinë të lëvizë në disa opsione
- Mekanizëm rregullues i lartësisë në pjesën e kokës sipas dimensioneve të shtratit
- Dyshek me cilësi të lartë në të gjithë shtratin i veshur me mbulesë të qëndrueshme vinyllex, e cila është rezistente ndaj nxehtësisë, antibakteriale dhe lahet.
- Rregullimi manual i mbështetëses së kokës në pozicione të ndryshme.
- Mbajtës universal i rrotullës së letrës (në pjesën e kokës ose në fund të shtratit sipas kërkesës).
- Kornizë metalike e veshur me pluhur elektrostatiqe.
- Përmasat: 600 X 1750 X 750 mm. (Gjer x L x H).
- Përmasat e seksionit fiks: 128 x 60 x 5,5 cm.
- Kornizë e shtratit të sipërm me profile katrore 40x40mm, trashësi 1,5 mm, e bardhë elektrostatiqe e pikturuar e pjekur në 180 ° C
- Katër baza këmbësh me profile katrore 40x40mm, trashësia 1.5 mm, elektrostatiqe e bardhë e pjekur në 180 ° C, gjatësia 12cm
- Katër këmbë shtrati me profile katrore 35x35mm, trashësia 1,35 mm, elektrostatiqe e bardhë e pjekur në 180 ° C, pjesa e dukshme e këmbës prej çeliku inox gjatësia e saj 54cm
- Seksioni i kokës Përmasat e dyshekut: 55cm x 60 cm x 12cm
- Mbajtëse letrë prej çeliku inox, me diametër 25 mm dhe trashësi 1,35

### **39-Shtrat lindjeje obsetrike**

- Shtrat lindjeje dhe procedura obstetrikale
- E ndarë në tre seksione: shpina, ndenjesja dhe kembet
- Me tre motore për rregullim elektronik të lartësisë, shpines dhe pozicioneve



- Tredelenburg/Reverese Tredelenburg
- Komandim nga nje panel kontrolli dhe/ose telekomande
- Pjesa e kembeve e zmontueshme lehtesisht
- Tredelenburg / Reverse Trendelenburg
- Dyshek me tre seksione, me materiale antimikrobiale, rezistente ndaj ujit, te padjegeshme, te respirueshem, dhe lehtesisht te pastrueshem
- Bazamenti / platforma e dyshekut prej materiali ABS
- Shina anesore (te zmontueshme) prej celiku inox ne seksionin e ndenjeses, destinuar per montim aksesoresh.
- Pjesa e shtrirjes (dysheku) i mbushur me shkume-gome per te ndjekur formen anatomike te trupit.
- Amortizatore goditjesh gjate levizjeve
- Lartesia e shtratit e rregullueshme ne diapazonin 70 deri 85 cm
- Siperfaqja e krevatit; gjatesia min 185 cm, gjeresia min 80 cm
- Seksioni i shpines i rregullueshem nga 0 ne 70 deg.
- Tredelenburg/Reverse Tredeleburg i rregullueshem deri ne rreth +/- 13 deg
- Pesha mbajtese: 200 kg  $\pm$  10%
- Aksesore: Mbajtese kembesh (1 cift), me veshje materiali te gomuar, me lidhese per fiksime kembesh, me konstruksion me cerniere sferike per pozicionim kendor te rregullueshem, dhe lartesi te rregullueshme, Mbajtese anesore te pacientit (1 cift); Bacinele inoksi me fiksuesin perkates (1 cope);

#### **40-Shtrat Ekzaminimi Gjinekologjik**

- Shtrat Ekzaminimi gjinekologjik me 3 ndarje
- Mbeshtetja e kokes dhe kembeve te jete e rregullueshme
- Permasat afersisht 60x180x80cm dhe kapaciteti mbajtes jo me pak se 220 kg
- Mbuluar me lekure sintetike ne pjesen e jashtme, lehtesisht e pastrueshme dhe qe duron nxehtesine
- Strukture metalike e kromuar ne te kater kembet
- Me mbajtese kembesh dhe bacinele si dhe mbajtese letre ne pjesen e kokes.

#### **41- Shtrat Vizite**

- Shtrat vizitash me skelet inoksi me përmasa jo me te vogla se (180\*57\* h73cm pesha min 100kg)
- me dy pjesë: pjesa shpinore e cila ka mundësi të lëvizë në disa pozicione, e pajisur me dyshek të veshur me material rezistent kundra zjarrit, antibakterial dhe të lashëm, e kornizuar, e pajisur me 4 këmbë inoksi, e pajisur në fund të shtratit me mbajtësen e letrës rulo universal.

#### **42-Stativ**

- Stativ Inoksi me bazament me 5 rrota
- I gjithi me material inoksi
- Me mbajtese serumit inoksi per 4 vende
- Me rregullim lartesisht dhe me fiksues
- Te jete rezistent ndaj dezinfektanteve spitalor

#### **43-Barrele spitalore**

- Material alumini ose ekuivalent me 4 rrota universal.

- Siperfaqja e barreles kundra ujit, me mbështetese shpine te rregullueshme, me rrota me frena,
- Pesha mbajtese te pakten 100 kg.
- Mbajtese ne te kater anet e barreles.
- Karroce me rrota

#### **44-Karroce spitalore per pacientet**

- Karroca duhet ta kete pjesen e karriges se palosshme.
- Struktura duhet te jete çeliku e kromuar dhe e pajisur me xhep të pasmë.
- Duhet te kete sistem frenimi (të dy rrotat) dhe mbështetëse e lëvizshme e pjeses se këmbëve.
- Kapaciteti mbajtes te pakten 100 kg.

#### **45-Stol me 1 shkalle per shtreter obsetrik**

- Stoli te jete me 1 shkalle, rezistent nga nxehtesia dhe kundra ujit.
- Te kete konstruksion alumini
- Permasat e peraferta: 40 x 51 x h 25 cm

#### **46-Aerosteril**

- Sterilizator me ajer te thate
- Sistem elektronik i kontrollit te temperatures dhe kohes
- Struktura e brendshme dhe e jashtme teresisht celik inoksi i paoksidueshem
- Dera e pajisjes e siguruar me celes
- Me ventilim te forcuar.
- Te kete mundesi te punoje me programim te kohes 0-250 minuta ose ne menyre te vazhdueshme.
- Te mund te arrije temperature te pakten 200 grade
- Te jete e pajisur me thermostat sigurie
- Ushqimi: AC: 230 V~ 50/60 Hz

#### **47-Set veglash mjekimi**

- Forceps Thumb 16 cm
- Spekul vaginal Cusco i vogel
- Spekul vaginal Cusco i mesem
- Spekul vaginal Cusco i madh
- Mbajtese instrumentesh 150 ml
- Forceps TOE i drejte 14 cm
- Forceps TOE i drejte 18 cm
- Gershere Episiotomie 14 cm
- Gershere umelikale 10.5 cm
- Forceps Kocher i drejte 16 cm
- Forceps Kocher i drejte 18 cm
- Forceps Kocher i harkuar 16 cm
- Bacinele 20 cm dhe 25 cm
- Forceps me dhembe: 1x2 - 14 cm
- Forceps Museux Vulsellum 8 mm e drejte 24 cm

- Gershere per suture 15 cm
- Gershere Mayo e drejte 15 cm
- Gershere operimi e mprehte dhe e drejte 15 cm
- Gershere operimi e mprehte dhe e harkuar 15 cm
- Mbajtese gjilpere Mayo Hegar 18 cm
- Forceps dilatimi Rampley e drejte 18 cm
- Forceps dilatimi Rampley e drejte 24 cm
- Spekul vaginal Sims i vogel
- Spekul vaginal Sims i mesem
- Spekul vaginal Sims i madh
- Bacinele instrumentesh drejtkendeshe 45x30x6.2 cm

#### **48- Spekulum**

- Materiali te jete celik inoksi i paoksidueshem
- Me permasa: small 75 x 32 mm, medium 85 x 35 mm, large 100 x 37 mm

#### **49-Cistine e madhe**

- Materiali te jete celik inoksi AISI 304
- Me permasa: 280 x 141 x 40 mm
- Kapaciteti mbajtes: 1600 ml
- E autoklavueshme ne 121°C

#### **50-Cistine e mesme**

- Materiali te jete celik inoksi AISI 304
- Me permasa: 254x141xh 33 mm
- Kapaciteti mbajtes: 750 ml
- E autoklavueshme ne 121°C

#### **51-Cistine e vogel**

- Materiali te jete celik inoksi AISI 304
- Me permasa: 207x128xh 33 mm
- Kapaciteti mbajtes: 480 ml
- E autoklavueshme ne 121°C

#### **52-Valvula gjinekologjike**

- Me Madhesi dhe gjatesi te ndryshme
- Afersisht: 70mm, 80mm, 90mm, 105mm, 105mm, 110mm, 110mm, 135mm

#### **53-Hysterosalpinografi**

- Te jete sipas metodologjise se Prof. Dr. Schultze.
- Manometri me diapazon: 0 ne 200 mm Hg me hap 10 mm Hg
- Te jete me material te kromuar
- Shkalla te kete mundesi te lexohet edhe ne erresire
- Te jete me dalje Luer-lock
- Te perfshije te pakten 3 masa te ndryshme te pjeses konike prej materiali te kromuar, mbajtesi per te pakten 2 forcepsa uterusi. Nje shiringe qelsi dhe kromi te pakten 20 ml dhe kutine perkatese.

#### **54-Pistoleta per marrje biopsie**

- Marres biopsie i modelit KEVORKIAN me gjatesi 20 cm
- Marres biopsie i modelit Tishler i vogel, i drejte me gjatesi 25 cm
- Marres biopsie i modelit Tishler, i drejte me gjatesi 25 cm

#### **55-Elektrocauter (njesia dhe ansat)**

- Elektrobisturi me dy dalje monopolare dhe nje dalje bipolare.
- Diapazoni i fuqise: te pakten 300W
- Te kryeje procedura te endoskopise bipolare ne solucion saline.
- Mundesi memorizimi te pakten 9 programe
- Mundesi kontrolli me celes kembe dhe me elektroda dore.
- LED-bar per kontroll vizual te cilesise te kontaktit.
- Alarme vizive te ndara me ngjyra dhe akustik
- Te kete mundesi per te funksionuar edhe me gaz Argoni dhe me aspirator tymi
- Ne perputhje me standardet IEC 60601-1 , EN 60601-1 dhe IEC 60601-2-2
- Mrojtje e Klasit te pare te shkalles CF
- Aksesoret: 1x celes pedal-kembe, 1x Pllake tokzimi neutrale gome, shumeperdorimshe. 1x Elektrode thike monopolare, 1x elektrode lancet e drejte (Needle Shaft electrode). 1x Pince diatermie. 1x Elektrode me tel te harkuar (Loop electrode).
- Te perfshihen nga 1 set shtese elektrodash, Elektrode thike monopolare, 1x elektrode lancet e drejte, 1x Elektrode me tel te harkuar (Loop electrode).

#### **56- Aborcang me qafe**

- Pince per abort, e drejte me nofulla afersisht 12 mm dhe gjatesi afersisht 25 cm

#### **57-Myzo**

- Te jete me gjatesi afersisht 8 mm dhe e drejte afersisht - 24 cm

#### **58- Tavoline mobile (karroca) per perгатitjen e terapise**

- Tavolinë pune, e pajisur me dy sirtarë (47x30x12 cm) nga secila anë, për të punuar në të dy anët njëherësh.
- Me kornize celik inoxi AISI 304 me strukture katrore tubulare.
- Pjesa e sipërme e përbërë nga celik inoxi te lemuar.
- E montuar në 4 rrota me diametër 100 mm dhe 2 frenat.
- Peshë e përafërt 50 kg si dhe përmasa 120 x 70 x h 95 cm

#### **59- Tavoline mobile (karroca) per pajisjet kirurgjikale**

Raftet me mbështetëse në të katër anët. Doreza e shtytjes. Montuar në rrotulla 80 mm.

- Strukture totale prej celik inoxi
- Me doreze per shtyrje
- E pajisur me 2 rafte
- Me dimensione: 60 x 40 x 80 h cm
- Me kater rrota me diametër prej 80 mm.

#### **60- Tavoline mobile (karroca) per medikamente dhe materiale mjekesore**

- Tavoline mobile alumini.
- Te jete i pajisur me 2 rafte te bardha me trashesi 18 mm e konturuar me PVC ngjyre te erret.
- Me mbajtese ne te dyja anet laterale te cilat ndihmojne per transportin e tavolines mobile
- Te jete i pajisur me 4 rrota me material nylon me diameter 80mm.
- Kapaciteti maksimal i mbajtjes jo me pak se 40 kg.
- Permasat e peraferta: 60 x 40 x h 77 cm
- Te jete e lehte per tu levizur dhe me peshe jo me te madhe se 13 kg.

#### **61- Stol Kirurgjikal**

- Stoli te jete i pajisur me mbeshtetese per kurrizin.
- Levizja e rregullueshme
- Te jete i pajisur me 5 rrota

#### **62-Set hysteroskopie**

- Hysteroskopi 2.9 mm 0° me rezolucion te larte, te jete me Sistem optik me cilësi të lartë, me veshje (anti-reflektues)
- Xham shumë refraktues për dhënien optimale të ngjyrave edhe kur imazhi zmadhohet
- Te kete Fusha me rezolucion të lartë, xhami i mbuluar me safir në të dy skajet, te jete ne forme Koni për të mbledhur dritë nga kablllo
- Elementi i punes: BIPOLAR pasiv me kanal 18.5 CH dhe me kapje Easy lock
- Elektroda me hark, e drejte me diameter 17.5 CH per Histeroskopin e mesiperm
- Hysteroskopi Ø 4.0 mm, 12° HM HD 4 mm

#### **63 – Kolposkop**

- Kolposkop te jete i pershtatshem per ekzaminime gjinekologjike me dizajn ergonomik dhe i lehte ne perdorim.
- Okularet dhe lentet e objektivit duhet te jene te zevendesueshme.
- Duhet te kete Imazh te paster me detaje me rezolucion te larte dhe ngjyra natyrale me optike apokromatike
- Ndricim me rreze paralele per ndricim me te mire te fushes vizuale
- Duhet te kete zmadhim me nivele te ndryshme, me vezhgim te pergjithshem ne nivele te uleta dhe me dallim te qarte te detajeve ne nivele te larta.
- Me karrel mbajtes me diameter rreth 65 cm me 5 rrota per transport te lehte dhe te qendrueshem.
- Te kete mundesi shtimi te adaptoreve foto dhe video per kamera dixhitale ose endoskopike per te mundesuar dokumentimin e diagnostikimeve mjekesore si dhe te sistemit lazer per te mundesuar heqjen e indeve te demtuara.
- Te jete i perbere prej materiali metalik per te siguruar jetegjatesi.
- Kolposkopi duhet te jete me imazhe tredimensionale dhe me thellesi fushe te madhe per nje diagnoze te suksesshme.
- Me ndricim te integruar LED per jetegjatesi te llambes
- Distanca e punes/ Objektivit : 250mm ose 300mm standard.

- Fokusimi i imet: 12mm me objektiv fokusimi  $f=250$  mm dhe  $f=300$  mm, 40mm manual dhe 40mm i motorizuar
- Tubat Binokulare: Tuba te drejte  $f=125$  mm, Tuba te pjerret  $f=125$  mm  $45^\circ$
- Okularet: Cift me kend te gjere me diopter WF 16 x V ose WF 20 x V
- Zmadhim minimumi deri ne 21X me fushe pamje me diameter minimal 8 mm
- Gjatesia totale e kraheve minimum 110 cm dhe lartesi jo me e vogel se 130 cm

#### 64- Monitor

- Monitori te jete mjekesor dhe te suportoje afersisht 1.07 billion ngyra.
- Monitori duhet te jete te pakten 21.3" dhe me rezolucion te larte (2048X1536)
- Monitori duhet te i pershtatshem per pajisje mjekesore dhe i pershtatshem edhe per sistemin PACS
- Monitori duhet te jete i kalibruar sipas metodës DICOM dhe te ofroje sakte si maksimale te detajeve dhe imazheve mjekesore.
- Niveli i ndricimit te jete jo me pak se 1000cd/m<sup>2</sup> Typ dhe i kontrastit 1500:1 Typ.
- Kendi i imazhit te jete afersisht  $178^\circ$
- MTBF: > 50,000Hours

III.1.2. Në shtojcën për modifikimin e dokumenteve të publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike me emërtim “Mbi modifikimin në Dokumentet Standarde të Tenderit” autoriteti kontraktor me nismën e tij ka modifikuar dokumentet e tenderit dhe ka përcaktuar si më poshtë vijon:

ISHTE

Ne Kapacitetin teknik pika 5

*5.Operatori ekonomik duhet të paraqesë Certifikata konformiteti CE ose FDA sipas direktivës (MDD ose MDR) 93/42 EEC, të vlefshme, ose ekuivalent, për artikujt e ofruar, sipas kategorizimit të tyre.*

BËHET

*5.Operatori ekonomik duhet te paraqese Certifikata konformiteti CE ose FDA sipas direktives (MDD ose MDR) 93/42 EEC, te vlefshme, ose ekuivalente, per artikujt e ofruar aty ku eshte e aplikueshme, sipas kategorizimit te tyre.*

#### Data e zhvillimit të tenderit

Mbeshtetur në ligjin Nr.9643, datë 20.11.2006, (i ndryshuar me ligjin 182/2014 dhe me ligjin Nr.47/2017) “Per Prokurimin Publik”, neni 42, pika 2/1, dhe në VKM Nr.914, datë 29.12.2014 “Per miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”(i ndryshuar me VKM Nr. 797, datë 29.12.2017),Kreut VII,Neni 62, për shkak të modifikimit të dokumenteve të tenderit, data e zhvillimit të tenderit dhe afati përfundimtar për dorëzimin e ofertave do të shtyhet :

Ishte: parashikuar datë 01.03.2021 ora: 12.<sup>00</sup> vendi: **website e APP-se** ([www.app.gov.al](http://www.app.gov.al))

Bëhet: Shtyhet për në datë 08.03.2021, ora: 12.<sup>00</sup> vendi: **website e APP-se** ([www.app.gov.al](http://www.app.gov.al))

Të gjitha të dhënat e tjera në dokumentet e tenderit mbeten të pandryshueshme.

Ngarkohet Administratori i sistemit elektronik të prokurimeve dhe Njësia e prokurimit të bëjnë veprimet përkatëse konform udhëzimit të Agjencisë së Prokurimit “Per modifikimin e dokumenteve dhe shtyrjen e afatit ne sistemin e prokurimit elektronik”.

III.1.3. Në nenin 23, pikat 1, 2 dhe 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se : “1. *Specifikimet teknike, që përcaktojnë karakteristikat e mallrave, punëve dhe shërbimeve që do të prokurohen, duhet të përgatiten për të përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë objektin e prokurimit, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.* 2. *Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të njëjtë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.* 3. *Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit kontraktor, duke iu referuar: a) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve apo përdorimin e produkteve; b) kërkesave në terma funksionalë, kur një gjë e tillë kërkon t’u referohesh standardeve kombëtare ose ndërkombëtare, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale; c) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të këtij neni për mallra, shërbime apo punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

III.1.4. Në nenin 27, pika 1 të Vendimit nr. 914, datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet se “*Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 23 të LPP dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara*”.

III.1.5. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se është e nevojshme të ndalet në një interpretim të zgjeruar të dispozitës së lex specialis, mbi mënyrën e hartimit të specifikimeve teknike. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se autoritetet kontraktore në hartimin e specifikimeve teknike, krahas përshkrimit të saktë të nevojave të këtij të fundit, duhet të kenë në vëmendje faktin, se hartimi i specifikimeve teknike duhet bërë në një mënyrë gjithëpërfshirëse duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve, duke përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë karakteristikat e mallrave/shërbimeve/punëve dhe në përputhshmëri me objektin e kontratës. KPP thekson se, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit (parashikuar nga neni 2 gërma “b” dhe “c” e LPP-së), janë ato të transparencës dhe

trajtimin të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik. Specifikimet teknike duhet të ofrojnë akses të barabartë për ofertuesit dhe nuk duhet të kenë efektin e krijimit të pengesave të pajustificuara për hapjen e prokurimit publik ndaj konkurrencës. Në respekt të parimit të mësipërm, specifikimet teknike, në asnjë rast nuk duhet të diskriminojnë/përjashtojnë nga konkurimi operatorët ekonomikë ofertues dhe/ose prodhuesit qofshin këta kombëtarë apo ndërkombëtarë. Në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të shmangin çdo formë diskriminimi, qoftë ato të dukshme, qoftë ato të fshehta, të cilat kanë të njëjtin efekt. Në asnjë rast, specifikimet teknike nuk duhet të hartohen në mënyrë që të drejtojnë drejt një produkti/malli/shërbimi që ofrohen nga një operator i vetëm ekonomik ose nga një prodhues i vetëm. KPP gjykon, se parashikimet e mësipërme duhet të zbatohen në të gjithë procedurat e prokurimit, me përjashtim të rasteve ku vetë ligji i prokurimit publik, parashikon një përjashtim të tillë. Në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në vëmendje faktin se specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 23 të LPP dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, parashikuar edhe nga neni 27, pika 1 e VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Gjithashtu, duke u ndalur në pikën 3 të nenit 23 të LPP-së, KPP gjykon se, ligjvënësi ka parashikuar tre metoda kryesore në hartimin e specifikimeve teknike. Metoda e parë lidhet me referimin e standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve apo përdorimin e produkteve. Metoda e dytë e hartimit të specifikimeve teknike lidhet me referimin e kërkesave në terma funksionalë, kur një gjë e tillë kërkon t’u referohesh standardeve kombëtare ose ndërkombëtare, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale. Gjithashtu, edhe metoda e tretë, e cila është një ndërthurje e dy metodave të mësipërme, por çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”. Autoritet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë me përpikmëri dispozitën e mësipërme të LPP-së në hartimin e specifikimeve teknike dhe kjo duhet pasqyruar edhe në dokumentet e tenderit. Nga interpretimi teleologjik (qëllimi i normës juridike), arrijmë në përfundim, se e rëndësishme është që përmes specifikimeve teknike, autoriteti kontraktor të mundësojë një konkurim të drejtë, të hapur, e gjithëpërfshirës, të barabartë dhe jo diskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, si edhe të mos drejtohen drejt një produkti të vetëm të ofruar nga një operator i vetëm ose nga një numër i kufizuar operatorësh ekonomikë. Gjithashtu referuar nenit 42 të Direktivës 24/2014 “Për prokurimin publik” KE, parashikohet se: *“Specifikimet teknike siç përcaktohen në pikën 1 të Shtojcës VII do të përcaktohen në dokumentet e prokurimit. Specifikimi teknik përcakton karakteristikat që kërkohet për një punë, shërbim ose furnizim”* Në pikën 1 të Shtojcës VII të Direktivës parashikohet se: *“specifikim teknik” nënkupton njërin nga sa vijon: b) në rastin e kontratave të furnizimit publik ose shërbimeve, një specifikim në një dokument që përcakton karakteristikat e kërkuara të një produkti ose një shërbimi, siç janë nivelet e cilësisë, nivelet e performancës mjedisore dhe klimatike, modeli për të gjithë kërkesat (përfshirë aksesin*



e personave me aftësi të kufizuara) dhe vlerësimin e konformitetit, performancën, përdorimin e tyre produkti, siguria ose dimensionet, përfshirë kërkesat që lidhen me produktin në lidhje me emrin nën të cilin produkti shitet, terminologji, simbole, metodat e provës dhe provës, paketimin, markimin dhe etiketimin, përdorues udhëzimet, proceset e prodhimit dhe metodat në çdo fazë të ciklit jetësor të furnizimit ose shërbimit dhe procedurat e vlerësimit të konformitetit; Në vendimin e GJED Cëshjta C-368/10 *“Komisioni European vs. Mberëtëria e Hollandës”* inter allia dhe *mutatis mutandis* është arsyetuar se: *“Specifikimet teknike të hartuara nga blerësit publik duhet të lejojnë që prokurimet publike të hapen në konkurrencë. Për këtë qëllim, duhet të jetë e mundur të dorëzohen tenderë që pasqyrojnë larminë e zgjidhjeve teknike. Prandaj, duhet të jetë e mundur të hartohen specifikimet teknike për sa i përket performancës funksionale dhe kushteve, dhe, kur referimi bëhet në standardin Evropian ose, në mungesë të tij, ndaj standardit kombëtar, ofertesit bazuar në marrëveshje ekuivalente duhet të merren në konsideratë nga autoritetet kontraktuese.”*

Gjithashtu, nga ana tjetër Komisioni i Prokurimit Publik gjen me vend të sqarojë se është në të drejtë të operatorëve ekonomikë që në respekt të nenit 63 pika 1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 *“Për prokurimin publik”* të ndryshuar ku parashikohet se: *“Çdo person, që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin.”* Në interpretim literal, sistematik dhe teologjik me synim vendosjen në pah të *ratio legis*, mbështetur edhe në parimin e e së drejtës se *ratio legis est anima legis*, (qëllimi i ligjit është edhe shpirti i ligjit), interesi i ligjshëm i operatorëve për të paraqitur ankim pranë autoritetit kontraktor si edhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik duhet të të jetë dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i marrë nga autoriteti kontraktor në kundërshtim me ligjin e prokurimit publik. KPP thekson se, fakti se një ose disa produkte të një ose disa prodhues vendas ose ndërkombëtarë nuk përmbushin minimumin e specifikimeve teknike të përcaktuara nga ana e autoritetit kontraktor nuk përbën një kusht *sine qua non* se specifikimet teknike janë hartuar në kundërshtim me ligjin për prokurimin publik. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se në rastin konkret ndodhemi në kuptimin klasik të barrës së proves referuar parimit juridik onus probandi incubit actor (barra e provës i bie kërkuesit) si edhe në përputhje me nenin 82 pika 1 të ligjit nr.44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”*, në të cilin parashikohet se: *“Në procedurat administrative, të filluara me kërkesë të palës që inicion procedurën, barra e provës për faktet e pretenduara bie mbi këtë palë, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj.”* Pra, operatorët ekonomikë duhet të argumentojnë/dëshmojnë se specifikimet teknike të hartuara nga autoriteti kontraktor janë në kundërshtim me ligjin e prokurimit publik dhe jo mbi faktin se këto të fundit nuk plotësohen nga një ose disa prodhues kombëtar/ndërkombëtar me reputacion.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues *“Biometric Albania”* shpk se ;

1. Ne shtojcen 10, *Specifikime Teknike, Lot 1 - F.V pajisje Mjekesore për Maternitetin e Beratit ne lidhje me artikullin Nr. 1 Tavoline Operatore-Obsertikale dhe gjinekologjike kerkohen:*

*-Pajisja te jete e mbeshtetur ne 4 rrota dhe me mbeshtetje statike gjate nderhyrjeve*

*-Krevati te mbaje peshe te pakten 300 kg*

*-Levizjet anesore majtas-djathtas te pakten 35 gradë*

*Ju veme ne dukje se prodhues te ndryshem ofrojne opsione te ndryshme te suportit mbeshtetes te tavolines operatore, sic eshte mbeshtetja statike ose supporti me rrota. Rrjedhimisht plotesimi i njërës prej kerkesave eshte i mjaftueshem persa i perket funksionalitetit te pajisjes dhe levizjes se saj.*

*Nese tavolina operatore eshte e pajisur me rrota me frena, atehere stafi mjekesor mund ta levize lehtesisht ate kur eshte e nevojshme si dhe ta vendose ne pozicion statik me ane te frenave gjate nderhyrjeve.*

*Gjithashtu kapaciteti mbajtes 300 kg eshte nje tjetër kriter jo i nevojshem dhe kufizues, pasi dihet qe pesha e pacientit se bashku me aksesoret qe mund te montohen ne tavoline, nuk mund te arrije ne keto vlera. Per me teper tavolina operatore e kerkuar eshte per qellime obstetrike-gjinekologjike dhe jo ortopedike, rast ne te cilin, sasia e moduleve shtese dhe aksesoreve qe mund te montohen ne tavoline eshte me e madhe.*

*Levizja anesore laterale te pakten 35 gradë eshte nje tjetër kriter kufizues, pasi diferenca me  $\pm 5$  grade nuk ka asnje ndikim ne procedurat obstetrike gjinekologjike dhe pozicionimi lateral ne nje kend  $\pm 30$  grade eshte mese i mjaftueshem edhe gjate komplikacioneve qe mund te shkaktohen nga presioni I larte.*

*Per te mos kufizuar garen dhe per te krijuar mundesine e ofertimit te produkteve ekuivalente pa cenuar funksionalitetin e pajisjes kerkojme qe keto specifikime te ndryshohen si me poshte:*

*Pajisja te jete e mbeshtetur ne rrota me frena ose me mbeshtetje statike gjate nderhyrjeve*

*Krevati te mbaje peshe te pakten 270 kg*

*Levizjet anesore majtas-djathtas te pakten 30 gradë*

III.2.1. Autoriteti kontraktor në kthimin e përgjigjes drejtuar operatorit ekonomik ankimues për trajtimin e ankesës sqaron se:

*Ne lidhje me piken "Pajisja te jete e mbeshtetur ne 4 rrota dhe me mbeshtetje statike gjate nderhyrjeve". ky eshte nje kriter i domosdoshem i kerkuar nga mjeket per tavolinen operatore, e cila duhet t'i ofroje stafit mjekësor lehtësine për ta lëvizur kur është e nevojshme dhe ta vendose ate ne pozicion statik gjate ndërhyrjeve. Ky kriter ofrohet nga te gjithë prodhuesit dhe nuk eshte aspak kriter perjashtues. Per kete arsye pretendimi juaj nuk qendron.*

*-Ne lidhje me piken "Krevati të mbajë peshë të paktën 300 kg". Tavolina operatore pervec konfigurimit standard merr dhe konfigurime te tjera ne varesi te nevojave te vecanta te pacientit. Kapaciteti mbajtes i tavolines nuk i referohet vetem peshes se pacientit por edhe aksesoreve shtese te tavolines si suport te ndryshme, pllaka e zgjatjes etj prandaj ky kapacitet eshte i nevojshem. Prodhues te ndryshem e ofrojne kete specifikim dhe nuk eshte nje kriter i panevojshem. Per kete arsye pretendimi juaj nuk qendron.*

*-Në lidhje me pikën "Lëvizjet anësore majtas-djathtas të paktën 35 gradë" Në lidhje me këtë specifikim levizjet anesore jane shume te rendesishme ne procedurat obstetrike-gjinekologjike.*

*Levizjet anesore ne te pakten 35 gradë i lehtësojnë pacientes komplikacionet që mund të vijnë Bëhet 32 gradë.”*

III.2.2. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për procedurën e prokurimit si dhe ka detyrë të përcaktojë kritere që janë në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Rrjedhimisht autoriteti kontraktor është në të drejtën e tij për të përcaktuar kritere dhe specifikime teknike në lidhje me produktin e kërkuar, por pa përcaktuar kritere të cilat të çojnë drejt një marke të caktuar, apo që nuk ndikojnë në performancën e produktit, pasi përcaktime të tilla janë diskriminuese dhe përjashtuese nga pjesëmarrja në procedurë të operatorëve ekonomikë të interesuar. Në asnjë moment autoriteti kontraktor nuk duhet të vendosë kritere apo të hartojë specifikime teknike të cilat të drejtojnë në një emër të caktuar marke apo prodhuesi duke u bërë kështu përjashtues për operatorë të tjerë për një konkurrencë të hapur e të gjerë, bazuar kjo në përcaktimet e legjislacionit për prokurimin publik si më sipër cituar.

III.2.3. Në rastin konkret, autoriteti kontraktor ka përcaktuar- *Pajisja te jete e mbeshtetur ne 4 rrota dhe me mbeshtetje statike gjate nderhyrjeve -Krevati te mbaje peshe te pakten 300 kg, -Levizjet anesore majtas-djathtas te pakten 32 gradë”* duke pranuar të modifikojë siç vihet re nga kthimi i përgjigjes së autoritetit kontraktor vetëm pjesën “*Levizjet anesore majtas-djathtas te pakten 35 gradë”* në “*Levizjet anesore majtas-djathtas te pakten 32 gradë”* por pa publikuar shtojcën për modifikimin e kësaj pike.

KPP gjykon se autoriteti kontraktor në hartimin e specifikimeve teknike duhet të evitojë përcaktime fikse sikundër në rastin konkret peshën 300 kg, levizje anësore majtas djathtas 32 gradë, dhe krevati të ketë 4 rrota pasi përmasat dhe të dhënat fikse çënojnë konkurrencën dhe janë diskriminuese. Për këtë arsye KPP gjykon se në hartimin e specifikimit teknik në lidhje me peshën autoriteti kontraktor duhet të vendosë një minimum peshe ndërsa në lidhje me numrin e rrotave dhe këndin e lëvizjes, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë një diapazon minimum dhe maksimum si dhe të rishikojë të dhënat teknike për rrotat pa çënuar funksionalitetin e pajisjes në mënyrë që të mos ketë asnjë element që çon në kufizimin e konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomikë.

Për sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Biometric Albania ” shpk se:

**“ 1. Ne shtojcën 10, Specifikime Teknike Lot 1 - F.V pajisje Mjekesore per Maternitetin e Beratit ne lidhje me artikullin Nr. 2 Makine Anestezie (Set) kerkohen:**

*-Sistem me 3 gaze mjekesore: O2, N2O dhe Ajer me auto kalibrim*

*- Aparati duhet te suportoje hyrjet Ajer/O2 dhe N2O 250-650 kPa dhe te suportoje standardet AGA*

*DISS NIST, etj*

*-PEEP: 0-50 cmH2O*

*-Presioni i Inspirimit: 0-120 cmH<sub>2</sub>O*

*-Aparati duhe te perdore sistem qarkullimi me reflektor volume*

*-Valvola te emergjences APL frymemarrje e rastesishme deri ne 80 cmH<sub>2</sub>O dhe per oksigjenin 02 te pakten 0-10 l/min*

*-Alarm APNEA: 5 - 45s dhe kur eshte i fikur.*

*-Kontroll ne kohe reale i qarkut te frymarrjes, prani te ventilatorit alternativ me reflektor volume*

*-Koha e mbushjes se vaporizatorit afersisht 4 ml/s*

*Ju veme ne dukje se keto specifikime jane hartuar ne kundershtim te hapur me LPP dhe VKM, pasi ato jane realizuar ne baze te modelit te aparatit te anestezise Flow-I, te prodhuesit Maquet (Getinge Group) (katalogu bashkelidhur), gje e cila favorizon ne menyre te hapur distributorin e kesaj kompanie. Nder te tjera, pervec specifikimeve numerike unike jane perdorur edhe terma dhe teknologji te patentuara te prodhuesit Getinge te cilat e bejne te pamundur ofrimin e produkteve nga prodhues te tjere prestigjoze.*

*Per me teper kerkesat e mesiperme nuk kane asnje vlere klinike apo funksionale per pajisjen, sic edhe rendisim ne vijim:*

*Autokalibrimi i gazeve mjekesore eshte thjesht karakteristike kufizuese e prodhuesit te siperpermendur. Theksojme se asnje nga prodhuesit e pretenduar nga AK nuk e disponon karakteristiken e autokalibrimit e gazeve.*

*Per kete arsye kerkojme qe ky specifikim TE HIQET.*

*Gjithashtu diapazoni i presionit te gazeve hyrese 250-650 kPa, disponohet vetem nga ky prodhues, pasi shume kompani te tjera prodhuese si GE, Mindray, Draeger, Medec Benelux e kane kete diapazon 280-600 kPa.*

*PEEP 0-50cmH<sub>2</sub>O*

*Kerkesa jone per kete pike nuk eshte aspak kontradiktore sic edhe shprehet AK, pasi parametri i presionit PEEP nuk ka te beje me presionin maksimal inspirim-ekspirim ne rruget e frymemarrjes. PEEP (Positive End Expiratory Pressure) eshte presioni alveolar ne mushkeri qe mbetet ne fund te nje ekspirimi, per te shmangur kolapsin e tyre. Ky presion konsiston ne vlere normale 1-5 cmH<sub>2</sub>O, dhe ne varesi te gjendjes apo parametrave te pacientit mund te arrije ne vlere te vendosura nga anestezisti deri ne 25 cmH<sub>2</sub>O, por asnjehere mbi 30 cmH<sub>2</sub>O.*

*Ju veme ne dukje se pervec prodhuesit Maquet, asnje prodhues i pajisjeve te anestezise nuk e ka kete parameter ne vlere maksimale mbi 30 cmH<sub>2</sub>O, pasi mbi kete diapazon ai nuk ka asnje vlere klinike, bashkelidhur disa pjese nga kataloget e prodhuesve te mesiperme te mirenjohur).*

*Presioni i inspirimit 0-120 cmH<sub>2</sub>O*

*Sipas pretendimit te AK, ky eshte nje parameter qe lidhet ngushte me volumen tidal sidomos gjate modaliteteve te ventilimit me ane te volumit. Parametri i vendosur i presionit te respirimit eshte nje parameter i cili ka te beje me ventilimin ne modalitet PCV (Pressure Control) dhe jo VCV (Volume Control).*

*Ju veme ne dukje se vete modeli Flow-i i Maquet Getinge, e ka kete diapazon ne lidhje me modalitetet e kontrolluara me ane te Presionit dhe jo me ane te Volumit sic pretendohet nga AK. Sipas logjikes se AK qe pergjysmimi i ketij parametri perkeqeson qelimin e pajisjes, le te kuptoje qe prodhues prestigjoze te aparateve te anestezise si GE, Draeger, Mindray, Medec Benelux etj, (tek te cilet diapazoni i presionit te inspirimit eshte jo me shume se 5-60 cmH<sub>2</sub>O), prodhojne pajisje*

*te cilat vene ne rrezik jeten e pacientit, gje e cila eshte jashte cdo arsyetimi teknik apo logjik.*

*(bashkelidhur disa pjese nga kataloget e prodhuesve te mesiperm te mirenjohur).*

*Valvola e emergjences APL deri ne 80cmH20, gjithashtu eshte kerkuar ne nje diapazon i cili nuk ka asnje rendesi klinike pasi gjate ventilimit manual, apo ventilimit automatik, presioni maksimal ne rruget e frymemarrjes nuk kalon 40-50 cmH20.*

*Shume prodhues e kane kete parameter deri ne 60 cmH20 dhe vlera 80cmH20 e plotesuar vetem nga modeli i Maquet eshte nje kriter kufizues.*

*Mbushja e vaporizatorit 4ml/s eshte gjithashtu karakteristike e vaporizatoreve elektronike qe ka aparati Flow-i i prodhuesit Maquet (Getinge).*

*Perderisa kerkesa nuk eshte per vaporizatore elektronike, ata mund te mbushen manualisht.*

*Rrjedhimisht kerkesa e mbushjes se tyre me nje shpejtesi te caktuar nuk qendron.*

*Per kete arsye kerkojme qe ky specifikim TE HIQET.*

*Gjithashtu teknologjia me reflektor volumi eshte nje patente e kompanise Getinge ku ne vete katalogun e saj citohet: "Our patented Volume Reflector is a smart rebreathing system".*

*AK e ka pranuar kete pretendim, duke shtuar frazen "ose ekuivalent", por nderkohe kjo lloj teknologjie sic eshte reflektori i volumit ne pajisjen e Maquet, nuk ka nje teknologji ekuivalente persa i perket pajisjeve te anestezise, rrjedhimisht asnje prodhues nuk mund te ofroje te njevlershmen e saj.*

*Per kete arsye kerkojme qe ky specifikim TE HIQET.*

*Kujtojme se specifikimet e mesipermte jane pranuar te ndryshohen ne proceduren e AK S.U. "Shefqet Ndroqi" (pasqyruar ne vendimin e KPP 165/2020) ku eshte kerkuar e njejta pajisje, pasi ato jane karakteristike vetem e modelit Flow-i.*

*Duke qene ne kundershtrim te hapur me Nenin 23, pika 5 e Ligjit te Prokurimit Publik kerkojme qe te kryhen modifikimet si me poshte, ne diapazone dhe ne vlera logjike per sa i perket performances dhe qellimit funksional te pajisjes:*

*Sistem me 3 gaze mjekesore: O2, N2O dhe Ajer*

*Aparati duhet te suportoje hyrjet Ajer/O2 dhe N2O 280–600 kPa dhe te suportoje standardet AGA DISS NIST, etj*

*PEEP: 0–30 cmH20*

*Presioni i Inspirimit: 5-60 cmH20*

*Valvola te emergjences APL frymemarrje e rastesishme deri ne 60 cmH20 dhe per oksigjenin O2 te pakten 0–10 Vmin*

## **2. Ne shtojcen 10, Specifikime Teknike Lot 1 - F.V pajisje Mjekesore për Maternitetin e Beratit ne lidhje me artikullin Nr. 10 AED external me monitor, kerkohen:**

*-Nr i gjurmimit 6 forme valesh*

*-Shkalla e paraqitjes se ritmit te zemres: 15 ne 220 bpm*

*Se pari, ju veme ne dukje se specifikimet per kete artikull jane hartuar duke u marre copy-paste nga modeli i defibrilatorit Cardiolife TEC-8300 i prodhuesit Nihon Kohden (katalogu bashkelidhur), duke kufizuar konkurrencen e hapur dhe duke bere te pamundur ofertimin e produkteve alternative, ne kundershtrim te plote me LPP dhe VKM.*

*Per me teper hartimi i specifikimeve nuk eshte ndertuar ne baze te parametrave qe kane vertet rendesi klinike per jeten e pacientit, por ne kerkesa te cilat nuk kane lidhje te drejtperdrejte me funksionalitetin dhe performancen e pajisjes.*

*Nr. i gjurmimit 6 forme valesh*

*Ju veme ne dukje se ky kriter plotesohet vetem nga modeli i siperpermendur per sa i perket nje pajisjeje sic eshte Defibrilatori. Ne kete pike AK nuk po kerkon nje monitor pacienti, ne te cilin eshte e nevojshme te shfaqen ne menyre te njekohshme nje numer i madh formash valore.*

*Parametrat me te rendesishem dhe jetike qe mund te shfaqen ne forme grafiku (forme valore) dhe per kohe reale ne nje pajisje urgjence si defibrilatori, jane ECG dhe SpO2, dhe me kerkesen ne DST per monitorim te 3 lidhjeve ECG, 4 forma valore jane mese te mjaftueshme per keto parametra.*

*Shkalla e paraqitjes se ritmit te zemres: 15 ne 220 bpm*

*Sugjerojme qe ky specifikim te kerkohet ne nje diapazon me te gjere, pa cenuar funksionalitetin e pajisjes.*

*Kujtojme se specifikimet e mesiperme jane pranuar te ndryshohen ne proceduren e AK S.U. "Shefqet Ndroqi" (pasqyruar ne vendimin e KPP 165/2020) ku eshte kerkuar e njejta pajisje, pasi ato jane karakteristike vetem e modelit Cardiolife TEC-8300.*

*Ne menyre qe te mos favorizohet vetem nje operator i caktuar, per te mundesuar nje gare te hapur e korrekte dhe ne menyre qe te krijohet mundesia e ofrimit te produkteve alternative te njevlershme ose me te avancuara kerkojme qe keto specifikime te modifikohen si me poshte:*

*-Nr. i gjurmimit 4 forme valesh*

*-Shkalla e paraqitjes se ritmit te zemres: 20 ne 250 bpm*

### **3. Ne shtojcen 10, Specifikime Teknike Lot 1 - F.V pajisje Mjekesore për Maternitetin e Beratit ne lidhje me artikullin Nr. 16 Shiringe Infuzioni elektrike, kerkohen:**

*-Saktesia  $\pm 1\%$  me nje minimum shiringash 100*

*-Te operoje ne presion 250-900 mmHg ne hapa 50 mm Hg ose ne hapa 25 mmHg per presion 50-250 mmHg*

*Se pari, ju veme ne dukje se specifikimet per kete artikull jane hartuar duke u marre copy-paste nga modeli Agilia SP i prodhuesit Fresenius KABI (katalogu bashkelidhur), duke kufizuar konkurrencen e hapur dhe duke bere te pamundur ofertimin e produkteve alternative, ne kundersizim te plote me LPP dhe VKM. Saktesia  $31\%$  me nje minimum shiringash 100 eshte nje karakteristike e plotesuar vetem nga prodhuesi i siperpermendur. Shume prodhues te mirenjohur te shiringave elektrike si Carefusion, BD, B-Braun, Smiths Medical, Sinohero, Mindray etj, e kane kete saktesi jo me shume se  $2\%$ . Diferenca me  $1\%$  nuk sjell asnje perfitim klinik, por eshte thjesht nje kriter kufizues i modelit Agilia SP.*

*Gjithashtu hapi i parametrat te presionit 25mmHg apo 50mmHg, eshte perseri karakteristike e vetem ketij prodhuesi. I rendesishem eshte diapazoni i operimit te presionit, ashtu sic eshte*

pranuar edhe nga AK, ndersa nivelet e hapave jane variabel sipas modeleve dhe prodhuesve te ndryshem. Per kete arsye, ne menyre qe te mos favorizohet vetem nje operator i caktuar, per te mundesuar nje gare te hapur e korrekte dhe ne menyre qe te krijohet mundesia e ofrimit te produkteve alternative te njevlershme ose me te avancuara kerkojme qe keto specifikime te paraqiten me diapazon me te gjere dhe te ndryshohen ne:

-Saktesia jo me pak se  $\pm 2\%$  me nje minimum shiringash 50

-Te operoje ne presion 80-900 mmHg ne 10-11 nivele, ose ne hapa 50-80 mmHg

#### **4. Ne shtojcen 10, Specifikime Teknike Lot 1 - F.V pajisje Mjekesore për Maternitetin e Beratit ne lidhje me artikullin Nr. 18 Pompe infuzioni, kerkohen:**

-Koha e infuzionit: 1s-165 ore e 59 minuta

-KVO e rregullueshme 1 – 20.0 ml/ore

Ju veme perseri ne dukje se specifikimet per kete artikull jane hartuar duke u marre copy-paste nga modeli Agilia VP MC, gjithashtu i prodhuesit Fresenius KABI (katalogu bashkelidhur), duke kufizuar konkurrencen e hapur dhe duke bere te pamundur ofertimin e produkteve alternative, ne kundershtrim te plote me LPP dhe VKM.

Per me teper hartimi i specifikimeve nuk eshte ndertuar ne baze te parametrave qe kane vertet rendesi klinike per jeten e pacientit, por ne kerkesa te cilat nuk kane lidhje me funksionalitetin dhe performancen e pajisjes sic eshte koha e infuzionit deri ne 166 ore, apo KVO deri 20ml/ore, parametra te cilet i ploteson vetem modeli i siperpermendur i prodhuesit Fresenius Kabi.

Per parametrin e KVO, AK pretendon qe zvogelimi i tij do te veshtiresonte punen e stafit duke rritur mundesine per te patur bllokime gjate infuzionit, nderkohe qe te njejtin parameter ne artikullin Shiringe Infuzioni elektrike e ka kerkuar ne diapazon 0.1-5.0ml/h. Ky parameter i cili ben te mundur mbajtjen hapur te venes, ka te njejtin funksion tek te dy llojet e pajisjeve dhe shume prodhues prestigjoze si Carefusion, BD, B-Braun, Mindray etj, e disponojne ate ne vlera jo me shume se 5ml/h.

Ne menyre qe te mos favorizohet vetem nje operator i caktuar, per te mundesuar nje gare te hapur e korrekte dhe ne menyre qe te krijohet mundesia e ofrimit te produkteve alternative te njevlershme ose me te avancuara kerkojme qe keto specifikime te jene me gjithepershireshe dhe te ndryshohen ne: Koha e infuzionit: 1s-99 ore e 59 minuta

KVO e rregullueshme 1 - 5.0 ml/ore

#### **5. Ne shtojcen 10, Specifikime Teknike Lot 1 - F.V pajisje Mjekesore për Maternitetin e Beratit ne lidhje me artikullin Nr. 20 Pajisje per monitorimin e parametrave vital neonat, kerkohen:**

-Ekran i sheshte TFT/LCD/LED me prekje min 12 inch me mundesi afishimi te pakten 15 te formave te vales

-Monitori duhet te kete mundesi e bllokimit te komandimit me prekje dhe te ofroje mundesi kontrolli ndermjet butonave fizik

-Interval ulet 0 deri 148

-Alarmi Apnea : Fikur, 5 deri 40 s ne 5 hapa

- Tipi i matjes: sistolik, Interval dhe mesatar: Sistolik: 40 deri 280 mmHg; Diastolik: 10 to 235 mmHg; (MAP): 10 deri 280 mmHg,  
 -Neonate: Sistolik: 30 deri 140 mmHg, Diastolic: 10 deri 110 mmHg; (MAP): 10 deri 140 mmHg  
 - Pediatrik: Systolic 40 deri 280 mmHg, Diastolic: 10 deri 235 mmHg, MAP: 10 deri 280 mmHg  
 Se pari, ju veme ne dukje se specifikimet per kete artikull jane hartuar sipas modelit Life Scope VS Series 3763, i prodhuesit Nihon Kohden, duke kufizuar konkurrencen e hapur dhe duke bere te pamundur ofertimin e produkteve alternative, ne kundershtim te plote me LPP dhe VKM. Per me teper hartimi i specifikimeve nuk eshte ndertuar ne baze te parametrave qe kane vertet rendesi klinike per jeten e pacientit, por ne kerkesa dhe numra fikse te cilet i takojne modelit te siperpermendur. Keto specifikime nuk jane mbeshetur ne asnje pervoje te meparshme, sic jane procedura prokurimi te ngjashme te organizuara nga Ministria e Shendetesise apo Banka Boterore, por jane percaktuar te tilla duke kerkuar pajisje qe per me teper nuk jane instaluar ne asnje nga klinikat universitare apo ne departamentet e kardiokirurgjise/hemodinamikes.

Ne nje kohe qe kerkohet standardizimi dhe njehsimi i pajisjeve te instaluara ne spitalet rajonale, menyra e hartimit te ketyre specifikimeve, duke mos u mbeshetur ne asnje pervoje te meparshme, bie ndesh me keto standarde. Ju veme ne dukje pikat si me poshte:

Per nje monitor te kerkuar me madhesi ekrani 12 inc, nuk eshte i nevojshem pasqyrimi i formave valore deri ne 15. Kjo eshte nje vlere kufizuese dhe i perket vetem modelit te siperpermendur. Per me teper per monitorimin e parametrave vitale pediatrike apo neonat, 8 forma valore jane mese te mjaftueshme per nje ekran te madhesise 12 inc. AK pretendon se kerkesa per monitor minimalisht 12 inc nuk e perjashton mundesine e ofrimit te nje monitori me te madh, por nderkohe theksojme se i vetmi prodhues dhe model i cili ofron 15 forma valore ne nje ekran 12 inc eshte ai i Nihon Kohden, duke krijuar ne kete menyre diskriminim dhe nje gare te pabarabarte ne kosto dhe kerkesa me te gjithe ofertuesit (prodhuesit) e tjere, te cilet duhet te ofrojne nje monitor me ekran me te madh per te arritur numrin e formave valore te kerkuara.

Per kete arsye kerkojme qe format valore te shfaqura ne ekran te kerkohen ne proporcion me madhesine ekranit te ofruar.

Gjithashtu Intervali i ulet i respirimit eshte kerkuar ne nje diapazon te krahasueshem me nivelin e larte, ndaj mendojme se eshte lapsus, ndaj sugjerojme te ndryshohet si me poshte.

Alarmi Apnea : Fikur, 5 deri 40 s ne 5 hapa

Tipi i matjes: sistolik, Interval dhe mesatar: Sistolik: 40 deri 280 mmHg; Diastolik: 10 to 235 mmHg;

(MAP): 10 deri 280 mmHg;

Neonate: Sistolik: 30 deri 140 mmHg; Diastolic: 10 deri 110 mmHg; (MAP): 10 deri 140 mmHg

Pediatrik: Systolic 40 deri 280 mmHg, Diastolic: 10 deri 235 mmHg, MAP: 10 deri 280 mmHg

Duke qene se intervalet e ketyre parametrave plotesohen vetem nga modeli i siperpermendur I monitorit te Nihon Kohden, kerkojme qe ato te modifikohen si me poshte, per te qene ne nje



diapazon me gjithëperfshires, pa cenuar funksionalitetin dhe rendesine klinike te pajisjes, pasi keto diferenca te vogla minimale sherbejne vetem per kufizim gare dhe nuk ndikojne aspak ne performancen e pajisjes.

Gjithashtu "kontrolli me butona fizike" eshte nje nderfaqe e cila perdoret me se shumti ne rastet kur pajisja nuk disponon nje nderfaqe tjeter ekuivalente per operatorin. Pajisjet e teknologjise se fundit (vit prodhimi 2019-2021) kane tashme si nderfaqe kryesore vete ekranin e tyre i cili eshte me funksion "touch screen" (me prekje). Ne kete ekran paraqiten te gjithë parametrat monitorues apo kontrollues/komandues nepermjet te cileve operatori navigon ne menu-ne e pajisjes duke kontrolluar apo konfiguruar cdo parameter apo funksion te saj. Vete AK e ka pranuar ndryshimin e pikes se ngjashme ne artikullin Makine Anestezie te kesaj procedure, pasi ai nuk e cenon pajisjen nga ana funksionale. Menyra e ndryshme e arsyetimit per artikullin ne fjale tregon nje anshmeri ne gjykim dhe tendence ne kufizimin e gares.

Ne baze te Nenit 23, pika 3 (b) ku specifikimet teknike duhet t'iu referohen kerkesave ne terma funksionale, kur nje gje e tille kerkon t'u referohesh standardeve kombetare ose nderkombetare, si menyre qe nenkupton pajtueshmeri me kerkesat funksionale, del qarte se, nese pajisja kontrollohet totalisht nepermjet ekranit me prekje, i cili kerkohet ne kete procedure, nuk ka nevojë per butona fizike. Kujtojmë se specifikimet e mesiperme jane pranuar te ndryshohen ne proceduren e AK S.U. "Shefqet Ndroqi" (pasqyruar ne vendimin e KPP 165/2020) ku eshte kerkuar e njejta pajisje, pasi ato jane karakteristike vetem e modelit Life Scope VS Series 3763.

Ne menyre qe me perpilimin e specifikimeve te mesiperme te mos favorizohet vetem nje operator i caktuar, per te mundesuar nje gare te hapur e korrekte dhe ne menyre qe te krijohet mundesia e ofrimit te produkteve alternative te njevlershme ose me te avancuara kerkojme qe keto specifikime te ndryshohen si me poshte, ne diapazone dhe ne vlere logjike per sa i perket performances dhe qellimit funksional te pajisjes:

Ekran i sheshte TFT/LCD/LED me prekje min 12 inch me mundesi afishimi te pakten 8 te formave te vales, ose me teper per ekran mbi 12 inch. Monitori duhet te kete mundesine e bllokimit te komandimit me prekje ose te ofroje mundesi kontrolli nepermjet butonave fizike.

Interval ulet 0 deri 20

Alarmi Apnea : Fikur, 10 deri 40 s ne 5 hapa

Tipi i matjes: sistolik, Interval dhe mesatar: Sistolik: 40 deri 280 mmHg; Diastolik: 10 to 235 mmHg; (MAP): 15 deri 260 mmHg;

Neonate: Sistolik: 30 deri 140 mmHg; Diastolic: 10 deri 110 mmHg; (MAP): 15 deri 125 mmHg

Pediatric: Systolic 40 deri 240 mmHg, Diastolic: 10 deri 200 mmHg, MAP: 15 deri 215 mmHg"

Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.3.1 Në rastin konkret Operatori ekonomik ankimues pretendon se përcaktime të tilla të këtyre specifikimeve teknike të çojnë drejt një prodhuesi të vetëm ndërkohë që në treg operojnë disa prodhues të këtyre produkteve, duke ulur kështu konkurrencën dhe pjesëmarrjen në këtë procedurë prokurimi të operatorëve ekonomikë të interesuar dhe duke i bashkëngjitur si prove dokumentacionit të dorëzuar në KPP edhe katalogët përkatës për disa produkte të prodhuesve të

caktuar ku specifikimet teknike të tyre janë të njëjta me ato përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit. Konkretisht për:

- Artikullin “*makinë anestezie*” specifikimet teknike për: “*Sistem me 3 gaze mjekesore: O<sub>2</sub>, N<sub>2</sub>O dhe Ajer me autokalibrim*”
- Aparati duhet të suportoje hyrjet Ajer/O<sub>2</sub> dhe N<sub>2</sub>O 250-650 kPa dhe të suportoje standardet AGA
- DISS NIST, etj
- PEEP: 0-50 cmH<sub>2</sub>O
- Presioni i Inspirimit: 0-120 cmH<sub>2</sub>O
- Aparati duhet të përdorë sistem qarkullimi me reflektor volume
- Valvola të emergjencës APL frymemarrje e rastesishme deri në 80 cmH<sub>2</sub>O dhe për oksigjenin O<sub>2</sub> të pakten 0-10 l/min
- Alarm APNEA: 5 - 45s dhe kur është i fikur.
- Kontroll në kohë reale i qarkut të frymemarrjes, prani të ventilatorit alternativ me reflektor volume
- Koha e mbushjes së vaporizatorit afërsisht 4 ml/s” janë të njëjta me ato të aparatit Flow të prodhuesit “Maquet Getinge Group (Getinge)”.
- Artikullin “AED external me monitor” specifikimet teknike për “Nr. i gjurmimit 6 forme valesh” dhe “Shkalla e paraqitjes së ritmit të zemrës: 15 në 220 bpm” janë të njëjta me ato të modelit të defibrilatorit “Cardiolife TEC-8300” i prodhuesit Nihon Kohden.
- Artikullin “Shiringë infuzioni elektrike” specifikimet teknike për “Saktësia jo më pak se  $\pm 2\%$  me një minimum shiringash 50” dhe “Të operojë në presion 80-900 mmHg në 10-11 nivele, ose në hapa 50-80 mmHg” janë të njëjta me ato të katalogut “Agilia Connect” të prodhuesit Fresenius Kabi.
- Artikullin “Pompë infuzioni” specifikimet teknike për “Koha e infuzionit: 1s-165 ore e 59 minuta” nuk është e njëjtë me atë të katalogut “Agilia Connect” të prodhuesit Fresenius Kabi pasi në këtë katalog është përcaktuar koha e infuzionit 168 orë. Ndërkohë specifikimi teknik lidhur me “KVO e rregullueshme 1 - 20.0 ml/orë” për artikullin “pompë infuzioni është e njëjtë me ato të katalogut “Agilia Connect” të prodhuesit të sipërpërmendur.
- Artikullin “Pajisje për monitorimin e parametrave vital neonat” specifikimet teknike për “Ekran i sheshtë TFT/LCD/LED me prekje min 12 inch me mundësi afishimi të paktën 15 të formave të vales
- Monitori duhet të ketë mundësinë e bllokimit të komandimit me prekje dhe të ofrojë mundësi kontrolli ndërmjet butonave fizik
- Interval ulet 0 deri 148
- Alarmi Apnea : Fikur, 5 deri 40 s në 5 hapa”
- Tipi i matjes: sistolik, Interval dhe mesatar: Sistolik: 40 deri 280 mmHg; Diastolik: 10 to 235 mmHg; (MAP): 10 deri 280 mmHg,
- Neonate: Sistolik: 30 deri 140 mmHg, Diastolik: 10 deri 110 mmHg; (MAP): 10 deri 140 mmHg
- Pediatrik: Systolik 40 deri 280 mmHg, Diastolik: 10 deri 235 mmHg, MAP: 10 deri 280 mmHg” janë sipas katalogut “Life Scope VS, BSM 3763” të prodhuesit Nihon Kohden.

III.3.2. Sa më lart KPP thekson se, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit (parashikuar nga neni 2 gërma “b” dhe “c” e LPP-së), janë ato të transparencës dhe trajtimit të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik. Në këtë mënyrë specifikimet teknike duhet të ofrojnë akses të barabartë për ofertuesit dhe nuk duhet të kenë efektin e krijimit të pengesave të pajustificuara për hapjen e prokurimit publik ndaj konkurrencës. KPP gjykon se në asnjë rast, specifikimet teknike nuk duhet të hartohen në mënyrë që të drejtojnë drejt një produkti/malli/shërbimi që ofrohen nga një operator i vetëm ekonomik ose nga një prodhues i vetëm. Në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në vëmendje faktin se specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 23 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, parashikuar edhe nga neni 27, pika 1 e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Në rastin konkret, referuar edhe pretendimeve të ankimuesit që specifikimet teknike të mësipërme të çojnë drejt një prodhuesi të vetëm ndërkohë që në treg operojnë disa prodhues të këtyrë produkteve, KPP gjykon se autoriteti kontraktor nuk duhet të bëjë kufizime të tilla në përcaktimin e specifikimeve teknike që përjashtojnë operatorët ekonomikë të cilët operojnë në treg në këtë fushë, ndaj autoriteti kontraktor duhet të saktësojë parametrat e përmendur në pikën III.3.1 të këtij vendimi duke i modifikuar ato ose dhe duke i hequr kur është rasti nëse nuk dëmtohet funksionaliteti i pajisjes dhe nuk cënohet jeta dhe shëndeti i qytetarëve, me qëllim krijimin e një konkurrence gjithëpërfshirëse dhe jodiskriminuese.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.4. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Biometric Albania ” shpk se:

*“ 1- Ne shtojcen 10, Specifikime Teknike Lot 1 - F.V pajisje Mjekesore për Maternitetin e Beratit Në lidhje me artikullin Nr. 4 Llambe Mobile,*

*-Lartesi e rregullueshme afersisht 70 - 160cm*

*Ne menyre qe te krijohet mundesia e ofrimit te produkteve alternative te njevlershme kerkojme qe ky specifikim te ndryshohet si me poshte, pa percaktuar kufijte minimale dhe maksimale, por duke i dhene rendesi diapazonit te levizjes dhe rregullimit te lartesisë:*

*Lartesi e rregullueshme ne diapazon levizje afersisht 50-70cm*

*2- Ne shtojcen 10, Specifikime Teknike Lot 1 - F.V pajisje Mjekesore për Maternitetin e Beratit ne lidhje me artikullin Nr. 5 Llambe Ekzaminimi, kerkohen:*

*-Lartesi e rregullueshme afersisht 70-160cm*

*Ne menyre qe te krijohet mundesia e ofrimit te produkteve alternative te njevlershme kerkojme qe ky specifikim te ndryshohet si me poshte, pa percaktuar kufijte minimale dhe maksimale, por duke i dhene rendesi diapazonit te levizjes dhe rregullimit te lartesisë:*

*-Lartesi e rregullueshme ne diapazon levizjeje afersisht 50-70cm”* KPP vëren se,

III.4.1. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të depozituar në KPP konstatohet se në lidhje me artikujt “*llambë mobile*” dhe “*llambë ekzaminimi*” në ankesën drejtuar autoritetit kontraktor, operatori ekonomik ankimues ka paraqitur pretendime të ndryshme nga ato të paraqitura në KPP në lidhje me specifikimet teknike për pikën “*Lartësi e rregullueshme afërsisht 70-160cm*” të artikujve të sipërpërmendur. Konkretisht në ankesën drejtuar autoriteti kontraktor, operatori ekonomik ka kërkuar për “*llambë mobile*” dhe “*llambë ekzaminimi*” që të jetë “*Lartësi e rregullueshme afërsisht 127–160 cm*” ndërkohë në ankesën drejtuar Komisionit të Prokurimit Publik kërkon që kjo pikë të modifikohet në “*Lartësi e rregullueshme në diapazon levizje afërsisht 50-70cm*” për të dy artikujt. Akoma më tej KPP konstatoi se referuar informacionit të autoritetit kontraktor si dhe pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues, ky i fundit nuk ka arritur të provojë se në çfarë mënyre ky parametër arrin të çnojë konkurrencën. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se në rastin konkret ndodhemi në kuptimin klasik të barrës së provës referuar parimit juridik onus probandi incubit actor (barra e provës i bie kërkuarës) si edhe në përputhje me nenin 82 pika 1 të ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, në të cilin parashikohet se: “*Në procedurat administrative, të filluara me kërkesë të palës që inicion procedurën, barra e provës për faktet e pretenduara bie mbi këtë palë, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj.*” Pra, operatorët ekonomikë duhet të argumentojnë/dëshmojnë se specifikimet teknike të hartuara nga autoriteti kontraktor janë në kundërshtim me ligjin e prokurimit publik. Në rastin konkret, pesha specifike e barrës për të provuar hartimin e dokumenteve të tenderit në kundërshtim me përcaktimet ligjore në fuqi është e plotë dhe qëndron mbi pretenduesin, ndërkohë që KPP adapton një pozicion re-aktiv, në pritje të argumenteve të plotë provues se cilat kritere/specifikime teknike të hartuara nga autoriteti kontraktor janë të gabuara apo diskriminuese.

Në rastin konkret konstatohet se autoriteti kontraktor ka përcaktuar një diapazon të gjerë parametrash duke mos kufizuar konkurrencën, por duke lejuar një pjesëmarrje sa më të gjerë të operatorëve ekonomikë të interesuar për këtë procedurë prokurimi.

Sa më lart pretendimi i operatorit ekonomik nuk qëndron.

III.5. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Biometric Albania ” shpk se:

*“ Ne shtojcen 10, Specifikime Teknike Lot 1 - F.V pajisje Mjekesore për Maternitetin e Beratit ne lidhje me artikullin Nr. 21 Radiante, kerkohet:*

*-Ne modalitet Manual Intensiteti i energjise ngrohese duhet te rregullohet manualisht nga operatori ne te pakten 50 nivele energjie nga 0-100%.*

*Ju veme ne dukje se parametri i rendesishem ne kete kerkese eshte ai i diapazonit te energjise. Niveli i rrezatimit pergjate ketij diapazoni nuk eshte i nevojshem te jete ne vlera fikse (te saktesishe 2%) per te mundesuar qellimin per te cilin eshte projektuar pajisja. Per kete arsye hapi i ndryshimit me 2% apo me 5% konsiderohet difference minore dhe nuk perben asnje difference nga ana teknike apo ne procesin e trajtimit te foshnjave.*

*Ne menyre qe te krijohet mundesia e ofrimit te produkteve alternative te njevlershme dhe me diapazon me gjitheperfshires, kerkojme qe ky specifikim te ndryshohet ne:*

*-Ne modalitet Manual Intensiteti i energjise ngrohese duhet te rregullohet manualisht nga operatori ne te pakten 20 nivele energjie nga 0-100%.” KPP vëren se,*

III.5.1. Në nenin 27, pika 1 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet se *“Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 23 të LPP dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara”*.

III.5.2. Në rastin konkret, autoriteti kontraktor është përgjegjës për administrimin e fondeve publike dhe për zhvillimin e procedurave të prokurimit në përputhje me ligjin dhe rregullat e prokurimit publik, por nga ana tjetër përmes këtyre procedurave duhet të sigurojë dhe cilësinë më të lartë të mallit/punës/shërbimit me çmim sa më të ulët. Në këtë kontekst ulja e niveleve të energjisë ndikon në performancën e pajisjes duke siguruar një pajisje më pak të avancuar dhe duke rënë ndesh me objektin e përmasat e procedurës së prokurimit si dhe pasojat që kjo mund të sjellë në jetën dhe shëndetin e qytetarëve.

Sa më lart pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.6. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Biometric Albania ” shpk se:

*“Ne shtojcen 10, Specifikime Teknike Lot 1 - F.V pajisje Mjekesore për Maternitetin e Beratit ne lidhje me artikullin Nr. 22 Aparat fototerapie (llambe fototerapie), kerkohen:*

*-Te kete te pakten 20 LED dhe fuqia jo me shume se 20W*

*-Rrezatimi i sistemit LED te kete gjatesi vale 450 nm [uW/cm-/nm) ne fushe 54 - 56cm*

*-Fusha e rrezatimit ne 440 - 460 nm [uW/cm /nm) te mbuloje lartesine 43 - 45 cm*

*Se pari, ju veme ne dukje se specifikimet per kete artikull jane hartuar ne baze te modelit BilibluLight, i prodhuesit Lowenstein Medical (katalogu bashkelidhur), duke favorizuar po te njejtin distributor dhe duke kufizuar konkurrencen e hapur dhe bere te pamundur ofertimin e produkteve alternative, ne kundërshtim te plote me LPP dhe VKM.*

*Gjithashtu perpilimi i tyre eshte bere ne forme lapsusi, pasi njesia e matjes se rrezatimit nuk shprehet ne centimetra, ashtu sikurse eshte vendosur ne vlerat e mesiperme.*

*Ne pergjigjen e tij AK ka pranuar kerkesen tone per dy prej pikave te mesiperme, por ndoshta ne forme lapsusi nuk i ka ndryshuar ato respektivisht ne menyre korrekte.*

*Ne kete menyre kerkojme qe keto specifikime te korrigjohen dhe ndryshohen si me poshte:*

*-Te kete te pakten 20 LED dhe fuqi 20-50 W*

*-Fusha e rrezatimit ne 450 - 470 nm [40 - 100 W/cm<sup>2</sup>/nm] ” KPP konstaton se,*

III.6.1. Autoriteti kontraktor në kthimin e përgjigjes lidhur me specifikimin teknik *“Të ketë të paktën 20 LED dhe fuqia jo më shumë se 20W”* ka pranuar se ka një lapsus në hartimin e tij por ndërkohë në modifikim vendos sërish të njëjtin specifikim. Në lidhje me këtë pikë referuar sqarimeve të autoritetit kontraktor në informacionin e paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit

Publik konstatohet se autoriteti kontraktor ka shfaqur paqartësi në sqarimin e tij. Në këtë kupim KPP gjykon që autoriteti kontraktor të qartësojë dhe përcaktojë specifikimin teknik në lidhje me këtë pretendim.

Ndërsa për specifikim teknik *“Fusha e rrezatimit në 440-460 nm [40 - 100 W/cm<sup>2</sup>/nm] të mbulojë lartësinë 43-45 cm”* autoriteti kontraktor bazuar në kthimin e përgjigjes për operatorin ekonomik ankimues, shprehet se e ka pranuar pretendimin e tij për këtë pikë dhe në shtojcën që duhet të publikojë për modifikimin e dokumenteve të tenderit duhet ta pasqyrojë këtë ndryshim sipas pretendimeve të operatorit ekonomik për këtë pikë.

Sa më lart pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.7. Gjithashtu konstatohet se autoriteti kontraktor në kthimin e përgjigjes drejtuar ankimuesit referuar pretendimeve të këtij të fundit të paraqitura në autoritet kontraktor ka modifikuar një pjesë të kritereve, por nuk ka publikuar shtojcën përkatëse në sistemin e prokurimit elektronik.

Komisioni i Prokurimit Publik sjell në vëmendje të autoritetit kontraktor se bazuar në nenin 42 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 *“Për Prokurimin Publik”* të ndryshuar, ka detyrim që të publikojë shtojcën në sistemin e prokurimit elektronik (SPE) për modifikimin e dokumenteve të tenderit ku krahas konstatimeve të vendimmarrjes së KPP-së, duhet të pasqyrojë njëherazi ndryshimet e dhëna për dokumentet e procedurës së prokurimit për aq sa është pranuar prej autoritetit kontraktor sipas vendimit të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave, me qëllim njohjen e të gjithë operatorëve ekonomikë me sqarimet dhe modifikimet për dokumentet e tenderit, për të qenë të qarta e të sakta për të gjithë të interesuarit për këtë procedurë prokurimi.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 *“Për Prokurimin Publik”*, të ndryshuar dhe nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 *“Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*, nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 *“Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”*, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

#### **Vendos:**

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik *“Biometric Albania” sh.p.k.* për procedurën e prokurimit *“Procedurë e Hapur”*, me nr. REF-85003-01-27-2021, me objekt, *“F.V pajisje Mjekesore për Maternitetin e Beratit”* me fond limit 50,212,610 lekë (pa TVSH), parashikuar për t’u zhvilluar në datën 08.03.2021 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Spitalit Rajonal Berat.
2. Autoriteti kontraktor të kryejë modifikimet përkatëse duke publikuar shtojcën me modifikimet dhe sqarimet në përputhje me arsyetimet dhe konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi, duke dokumentuar veprimet e kryera.

4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “Biometric Albania” sh.p.k.
5. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Numër 246 protokoli, Datë 15.02.2021**

#### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Anëtar**  
**Vilma Zhupaj**

**Anëtar**  
**Lindita Skeja**

**Anëtar**  
**Merita Zeqaj**

**Kryetar**  
**Jonaïd Myzyri**